

Radmila Kuculovska

Viktorija Sotiroska

Vladimir Grnčarevski

E DREJTA DHE RREGULLIMI SHTETËROR

PËR VITIN E PARË
të arsimit të mesëm profesional



**E DREJTA DHE
RREGULLIMI SHTETËROR
PËR VITIN E PARË
të arsimit të mesëm profesional**

Shkup, 2022

Autorë:

Radmila Kuculovska, ShMEJQSh "Vasil Antevski-Dren", Shkup
Viktorija Sotiroska, ShMEJQSh "Vasil Antevski-Dren", Shkup
Vladimir Grnčarevski, arsimtar në pension

Recensentë:

Prof. D-r Jadranka Dabović-Anastasovska, Fakulteti juridik - Shkup
Jagnija Angelovska, ShMEJ "Arseni Jovkov", Shkup
Lence Kuzmanova, ShMEJQSh "Vasil Antevski-Dren", Shkup

Titulli i botimit origjinal:

ПРАВО И ДРЖАВНО УРЕДУВАЊЕ ЗА ПРВА ГОДИНА НА СРЕДНОТО СТРУЧНО ОБРАЗОВАНИЕ

Botues:

Ministria për Arsim dhe Shkencë e Republikës së Maqedonisë së Veriut
Rr. "Shën Kirili dhe Metodi", nr. 54, 1000 Shkup

Përktheu nga gjuha maqedone:

Kujtim Ramadani

Lektor:

Kujtim Ramadani

Redaktor profesional i botimit në gjuhën shqipe:

Jusuf Zejneli

Radhitja kompjuterike:

Arbëria Design (Gavrilo Angeloski)

Përgatitja kompjuterike:

Viktorija Sotiroska, Radmila Kuculovska

Vendi dhe viti i botimit:

Shkup, 2022

Me Vendim për miratim dhe përdorim të tekstit mësimor nga lënda E DREJTA DHE RREGULLIMI SHTETËROR për vitin e I të profesionit ekonomiko-juridik dhe tregtar, profilet teknik ekonomik, teknik juridik dhe administrator biznesi, nr. 26-522/1 të datës 16.03.2020 të sjellë nga Komisioni kombëtar i teksteve mësimore.

CIP - Каталогизација во публикација

Национална и универзитетска библиотека "Св. Климент Охридски", Скопје

34(075.3)

KUCULOVSKA, Radmila

E drejta dhe rregullimi shtetëror për vitin e parë të arsimit të mesëm profesional [Електронски извор] / Radmila Kuculovska, Viktorija Sotiroska, Vladimir Grnčarevski ; [përktheu nga gjuha maqedone Kujtim Ramadani]. - Shkup : Ministria për arsim dhe shkencë e Republikës së Maqedonisë së Veriut, 2022

Начин на пристапување (URL):

https://www.e-ucebnici.mon.gov.mk/pdf/Pravoidrzavnoure._1_albanski.pdf.

- Превод на делото: Право и државно уредување за прва година на средното стручно образование. - Текст во ПДФ формат, содржи 197 стр., илустр. - Наслов преземен од екранот. - Опис на изворот на ден 17.08.2022. - Фусноти кон текстот. - Fjalorth: стр. 189-193. -Библиографија: стр. 194-196

ISBN 978-608-273-074-5

1. Sotiroska, Viktorija [автор] 2. Grnčarevski, Vladimir [автор]

COBISS.MK-ID 57992965

PARATHËNIE

Teksti mësimor "E drejta dhe rregullimi shtetëror" u dedikohet nxënësve të vitit të parë të arsimit të mesëm profesional në drejtimet ekonomike, juridike dhe tregtare, për profilin arsimor, teknik ekonomik, teknik juridik dhe administrator biznesi. Ai korrespondon me plan-programin e ri të marrë nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës dhe Qendra e Arsimit dhe Aftësisimit Profesional për lëndën "E drejta dhe rregullimi i shtetit".

Teksti mësimor mundëson përmbushjen e dy motiveve, pedagogjike dhe shkencore.

Motivi pedagogjik u mundëson nxënësve të arrijnë rezultate sa më të mira në përvetësimin e lëndës juridike ndërsa nxënësve të shkollave të mesme profesionale u jep shkollim praktik juridik, i cili u mundëson përfshirjen aktive në shoqëri.

Motivi shkencor u mundëson studentëve të fitojnë arsimim teorik dhe njohje më të gjerë të kuptimit dhe rolit të vetë lëndës.

Në pjesën hyrëse të tekstit jepen njohuri bazë për zhvillimin historik dhe përkufizimin konceptual të shtetit dhe të së drejtës.

Në pjesën e parë të tekstit me titull "SHTETI" trajtohen përmbajtjet që lidhen me plan-programin që u referohen mësimave të përgjithshme për shtetin dhe të drejtën, duke përcaktuar veçoritë e shtetit, organizimin shtetëror dhe format e shtetit.

Pjesa e dytë "E DREJTA" mbulon përmbajtjet që lidhen me të drejtën si bazë në shoqëritë demokratike. Ky seksion u ofron studentëve njohje themelore me elementet bazë të normave shoqërore dhe juridike dhe marrëdhëniet e tyre me rendin juridik, përkufizimin konceptual të akteve juridike, marrëdhëniet juridike, subjektet e së drejtës, të drejtën pozitive, shtetin e së drejtës dhe sundimin e së drejtës.

Autorët e tekstit u përpoqën në mënyrë të thjeshtë t'ua afrojnë nxënësve këto tema për t'i bërë ato më të kuptueshme dhe të zbatueshme në shoqëri. Teksti mësimor mundëson mësim gradual përmes të menduarit. Ai është i bollshëm me ilustrime, shembuj praktikë, veprimtari kërkimore, pyetje, ushtrime, detyra që nxisin nxënësit të mendojnë dhe të shprehin pikëpamjet dhe opinionet e tyre. Shpresojmë që teksti "E drejta dhe rregullimi shtetëror" të ofrojë një bazë referente dhe të dobishme në studimin e lëndës.

PËRMBAJTJA

HYRJE

I. MËSIM I PËRGJITHSHËM PËR SHTETIN DHE TË DREJTËN

1. LËNDA DHE METODA E BAZAVE TË SË DREJTËS

- 1.1. Nocioni dhe lënda e bazave të së drejtës 11
- 1.2. Nocioni dhe ndarja e shkencave juridike 14
- 1.3. Nocioni dhe llojet e metodave të bazave të së drejtës..... 16

2. KRIJIMI DHE NOCIONI I SHTETIT DHE SË DREJTËS

- 2.1. Komunitetet shoqërore pa shtet – komunitetet jo-shtetërore... 20
- 2.2. Teoritë për formimin e shteteve 24
- 2.3. Nocioni i shtetit dhe së drejtës..... 28
- 2.4. Nocioni i vlerave juridike..... 29
 - 2.4.1. Drejtësia.....29
 - 2.4.2. Drejtshmëria 31
- 2.5. Lidhshmëria reciproke midis shtetit dhe së drejtës.33

PJESA E PARË - SHTETI

II. VEÇORITË E SHTETIT DHE ORGANIZIMI SHTETËROR

1. VEÇORITË E SHTETIT

- 1.1. Nocioni i veçorive të shtetit..... 39
- 1.2. Territori si veçori e shtetit 41
- 1.3. Popullsia si veçori e shtetit..... 45
- 1.4. Pushteti publik si veçori e shtetit. 49

2. ORGANIZIMI SHTETËROR DHE LLOJET E ORGANEVE SHTETËRORE (INSTITUCIONET E PUSHTETIT PUBLIK)

- 2.1. Nocioni i organizimit shtetëror dhe organit shtetëror (institucionet e pushtetit publik) 52
- 2.2. Llojet e organeve shtetërore (institucionet e pushtetit publik) dhe kompetencat e tyre 53
- 2.3. Organet qendrore dhe jo-qendrore..... 54
- 2.4. Organet e pushtetit legjislativ 54
- 2.5. Organet e pushtetit ekzekutiv-politik 55
 - 2.5.1. Kreu i shtetit..... 55

2.5.2. Qeveria	56
2.6. Organet e pushtetit gjyqësor.....	56
2.7. Klasifikimi i organeve shtetërore (institucionet e pushtetit publik) sipas llojit dhe mënyrës së kryerjes së veprimtarisë.....	57
2.7.1. Organet e armatosura dhe civile	57
2.7.2. Organet vendimmarrëse dhe ekzekutive.....	58
2.7.3. Organet individuale dhe kolektive	59

III. FORMAT E SHTETIT

1. SHTETET SIPAS FORMËS SË QEVERISJES

1.1. Nocioni i formës së qeverisjes.....	64
1.2. Monarkia.....	65
1.3. Republika	67

2. SHTETET SIPAS SISTEMIT POLITIK

(MËNYRA E EKZEKUTIMIT TË PUSHTETIT PUBLIK)

2.1. Nocionet dhe llojet e sistemeve politike	71
2.2. Nocionet dhe llojet e sistemeve politike jo-demokratike	72
2.3. Nocionet dhe llojet e sistemeve politike demokratike	74
2.3.1. Demokracia jo e drejtpërdrejtë (përfaqësuese).....	76
2.3.2. Demokracia e drejtpërdrejtë.....	79

3. SHTETET SIPAS RREGULLIMIT SHTETËROR

3.1. Nocioni dhe llojet e rregullimit shtetëror	83
3.2. Shteti unitar	84
3.3. Shteti i përbërë.....	86
3.3.1. Federata.....	86
3.3.2. Konfederata	87
3.3.3. Unioni (Bashkimi).....	88

PJESA E DYTË – E DREJTA

IV. RENDI JURIDIK

1. NORMAT SHOQËRORE

1.1. Nocioni i normave shoqërore.	93
1.2. Llojet e normave shoqërore	97
1.2.1. Zakoni	97
1.2.2. Morali.....	99

1.2.3. Normat religjioze.....	100
1.2.4. Norma ligjore.....	101
1.3. Raporti ndërmjet zakonit, moralit dhe normës ligjore.....	103
 2. RENDI JURIDIK	
2.1. Nocioni i rendit juridik.	105
2.2. Elementet e rendit juridik.	105
 3. NORMA JURIDIKE	
3.1. Nocioni i normës juridike	107
3.2. Elementet e normës juridike	108
3.2.1. Hipoteza	108
3.2.2. Dispozita	109
3.2.3. Sanksioni.....	109
3.3. Llojet e normave juridike.....	113
3.3.1. Normat urdhëruese, ndaluese dhe autorizuese ligjore.	113
3.3.2. Normat e përgjithshme dhe individuale juridike	116
3.3.3. Normat imperative, dispozitive dhe alternative juridike ..	117
 4. BURIMET E SË DREJTËS	
4.1. Nocioni i burimeve të së drejtës	122
4.2. lojet e burimeve të së drejtës	122
 5. AKTI JURIDIK	
5.1. Nocioni dhe elementet e aktit juridik	124
5.2. Llojet e akteve juridike.	126
5.3. Aktet e përgjithshme juridike.	128
5.3.1. Kushtetuta.....	128
5.3.2. Ligji.....	130
5.3.3. Aktet e përgjithshme nënligjore.....	133
5.4. Aktet individuale juridike	135
5.4.1. Akti administrativ	135
5.4.2. Akti gjyqësor.....	138
5.4.3. Veprat juridike	141
 V. MARRËDHËNIA JURIDIKE	
1. NOCIONI DHE ELEMENTET E MARRËDHËNIES JURIDIKE	

1.1. Nocioni i marrëdhënies juridike	146
1.2. Elementet e marrëdhënies juridike	148
1.2.1. Autorizimi juridik (e drejtë)	148
1.2.2. Detyrimi ligjor (detyrimi).....	150
1.2.3. Objekti i marrëdhënies juridike.....	151
1.2.4. Subjekti i marrëdhënies juridike	154
 2. FAKTET LIGJORE	
2.1. Nocioni i fakteve ligjore	156
2.2. Llojet e fakteve ligjore.....	156
 3. SUBJEKTET E SË DREJTËS	
3.1. Nocioni dhe llojet e subjekteve të së drejtës.	159
3.1.1. Personi fizik si subjekt i së drejtës.	159
3.1.2. Personi juridik si subjekt i së drejtës	165
 4. PËRFAQËSIMI	
4.1. Nocioni dhe llojet e përfaqësimit	170
4.1.1. Përfaqësimi ligjor	170
4.1.2. Përfaqësimi kontraktual	171
 VI. E DREJTA POZITIVE DHE ZBATIMI I SË DREJTËS	
1. ZBATIMI I SË DREJTËS	
1.1. Nocioni i të drejtës pozitive.....	176
1.2. Vlefshmëria e normave ligjore.....	177
1.3. Forca juridike.....	179
1.4. Kushtetutshmëria dhe ligjshmëria.	181
1.5. Paligjshmëria.....	182
1.6. Plotfuqishmëria, finaliteti, ekzekutueshmëria.....	184
 2. SHTETI LIGJOR DHE SUNDIMI I LIGJIT	
2.1. Nocioni i shtetit ligjor dhe sundimit të ligjit	186
 FJALOR.....	189
 LITERATURA E SHFRYTËZUAR	194



I. MËSIM I PËRGJITHSHËM PËR SHTETIN DHE TË DREJTËN

Pas leximit të kësaj pjese, duhet të jeni në gjendje: të identifikoni lëndën e Bazave të së drejtës, të përcaktoni termin shkencat juridike, të shpjegoni ndarjen e shkencave juridike, të shpjegoni metodat e Bazave të së drejtës, të shpjegoni evolucionin historik dhe rendin shoqëror në komunitetin fillestar, me theks të veçantë te pushteti, të përshkruani krijimin e shtetit dhe ligjit, të krahasoni shtetin dhe komunitetin pa shtet, të përcaktoni nocionet shtet dhe ligj, të shpjegoni ndërlidhjen e shtetit dhe së drejtës, të përshkruani drejtësinë dhe drejtshmërinë si vlera juridike.

1. LËNDA DHE METODA E BAZAVE TË SË DREJTËS

1.1. NOCIONI DHE METODA E BAZAVE TË SË DREJTËS

Studimi i çdo shkence nënkupton studimin e lëndës së saj, dhe ajo është materia që ajo shkencë e studion, ndjek dhe shpjegon.

Sipas ndarjes më të përgjithshme të shkencave, Bazat e së drejtës si disiplinë shkencore bën pjesë në grupin e shkencave shoqërore, në interesin e studimit të së cilës është studimi i shoqërisë dhe zhvillimi i saj. Më vete dhe në mënyrë të pavarur, **Bazat e së drejtës si shkencë juridike për lëndën e studimit të saj e ka shtetin dhe ligjin.**




Fig. 1: Lënda e Bazave të së drejtës

Në teori ka disa mendime nëse shteti dhe ligji duhet të studiohen së bashku. Kjo lind nga pretendimet se problemet e shtetit ishin objekt i studimit të filozofisë, e cila si shkencë ekzistonte para shkencave që studiojnë të drejtën. Por pavarësisht nga konsideratat e mëparshme, Bazat e së drejtës si disiplinë shkencore studion njohuritë themelore dhe hyrëse teorike të shtetit dhe të së drejtës si dukuri shoqërore, midis të cilave ka lidhje të shumta dhe ndikim të ndërsjellë.

Më konkretisht, qëllimi i studimit të lëndës Bazat e së drejtës është përvetësimi i njohurive të përgjithshme të koncepteve themelore juridike, si norma ligjore, akti ligjor, personat juridikë, marrëdhëniet ligjore etj. Në fakt, duke studiuar lëndën Bazat e së drejtës, ne përvetësojmë alfabetin e së drejtës. Këto njohuri janë të rëndësishme për zbatimin e ligjit nga subjektet në praktikë, por edhe për perceptimin e së drejtës si përditshmëri në ekzistencën dhe funksionimin e njeriut në shoqëri.

Duke pasur parasysh lidhjen, por jo edhe barazinë ndërmjet shtetit dhe së drejtës, Bazat e së drejtës ofron njohuri themelore dhe hyrëse të çështjeve themelore të shtetit që lidhen me zhvillimin e tij historik - nga një gjendje pa shtetësi, përmes shfaqjes së arsyeve për përcaktimin e nocionit shtet, veçoritë dhe funksionet e tij, klasifikimi i shteteve sipas kriterëve të ndryshme, etj.

Ajo që është karakteristike është fakti se Bazat e së drejtës si disiplinë shkencore nuk studion një shtet dhe ligj specifik, por studion konceptet dhe karakteristikat thelbësore dhe të përbashkëta që gjenden në çdo shtet dhe çdo ligj, pavarësisht se kur dhe ku kanë ekzistuar, ekzistojnë ose do të ekzistojnë.



? PYETJE:

1. Cila është lënda e studimit e një shkence?
2. Cila është lënda e studimit të Bazave të së drejtës?
3. Cili është qëllimi i Bazave të së drejtës si disiplinë shkencore?
4. A i studion Bazat e së drejtës si disiplinë shkencore vendet evropiane dhe të drejtat e tyre kombëtare?

1.2. NOCIONI DHE NDARJA E SHKENCAVE JURIDIKE

Fillimet e shkencës juridike datojnë që në Romën e lashtë. Është e njohur se e drejta romake¹ ka pasur një ndikim të madh që nga lashtësia e deri në ditët e sotme në zhvillimin e shkencës juridike moderne. Rëndësia dhe kontributi i saj shihet sot në faktin se institutet e saj themelore juridike mund të njihen në sistemet e sotme juridike në formën e njëjtë ose të ndryshuar.

Shkencat juridike janë njohuri të së drejtës. Por duke qenë se e drejta e siguron ekzistencën e saj në shtet, **shkencat juridike studiojnë shtetin dhe të drejtën si dy kategori shoqërore të rëndësishme dhe të ndërlidhura.**

NDARJA E SHKENCAVE JURIDIKE

Shteti dhe e drejta si kategori shoqërore depërtojnë në të gjitha sferat e jetës shoqërore, ndaj është normale që ato shfaqen si lëndë studimi në shumë shkencë.

Në bazë të disa kriterëve shkencorë, bëhet një ndarje e shkencave juridike, të cilat objekt studimi i kanë shtetin dhe ligjin, por secila prej tyre ka një qasje të ndryshme dhe i shpjegon ato nga një aspekt tjetër. Sipas mënyrës së studimit të shtetit dhe të së drejtës, shkencat juridike ndahen në:

- **Shkenca të përgjithshme juridike** - ato e studiojnë shtetin dhe të drejtën në përgjithësi dhe në mënyrë abstrakte. Konkretisht, këto shkencë studiojnë konceptet dhe vetitë e përbashkëta dhe themelore që janë karakteristike për çdo shtet dhe çdo të drejtë, si në të kaluarën, ashtu edhe sot, dhe në të ardhmen (p.sh.: Hyrje në të drejtën etj.).
- **Shkenca pozitive juridike** - studiojnë një shtet ekzistues dhe të drejtën e tij të vlefshme, gjegjësisht një shtet që ekziston dhe normat juridike që janë në fuqi dhe zbatohen në atë shtet (p.sh.: e drejta kushtetuese, e drejta penale).

¹ E drejta romake i referohet rendit juridik që ka qenë në fuqi në shtetin romak që nga themelimi i Romës në 753 para Krishtit e deri në vdekjen e perandorit romak lindor Justinianit në vitin 565.

- **Shkencat konkrete juridike** - studiojnë një shtet specifik dhe një ligj specifik. Është karakteristikë e këtij lloji të shkencave juridike që ato studiojnë një çështje specifike të caktuar, dhe jo atë që është e përbashkët për të gjitha shtetet. Ato studiojnë një fushë të sistemit juridik të një shteti të caktuar që është specifike për të dhe e ndryshme nga një shtet tjetër (p.sh.: E drejta kushtetuese e Republikës Franceze, Ligji për trashëgiminë në ShBA).
- **Shkencat juridike historike** - studiojnë një shtet dhe ligj nga e kaluara. Është një shtet që ka ekzistuar në të kaluarën dhe një ligj që është zbatuar dhe ka vlejtur në atë shtet (p.sh. e drejta romake).

Nëse i analizojmë shkencat e mësipërme, me siguri do të na ngatërojnë shkencat konkrete juridike dhe shkencat pozitive juridike, të cilat duket se janë të ngjashme. Por ndryshimi është se shkencat juridike pozitive janë disiplina juridike më të përgjithshme. Duke qenë se objekti i tyre i interesit nuk është një shtet dhe ligj i veçantë, ato mund të ofrojnë njohuri krahasuese në fushën përkatëse ligjore në të gjitha ose në më shumë shtete dhe të drejta ekzistuese



Fig. 2: Llojet e shkencave juridike

? PYETJE:

1. Cila është lënda e studimit të shkencave juridike?
2. Si ndahen shkencat juridike?
3. Cilat janë karakteristikat themelore të shkencave të përgjithshme juridike?
4. Çfarë studiojnë shkencat pozitive juridike dhe çfarë ato historike juridike?
5. Bëni dallimin ndërmjet llojeve të shkencave juridike?
6. Vlerësoni se për cilin lloj shkence juridike do të jetë objekt studimi Kodi i ligjeve të Hamurabit

1.3. NOCIONI DHE LLOJET E METODAVE TË BAZAVE TË SË DREJTËS

Nocioni metodë e ka origjinën nga fjala latine *methodus*, që do të thotë mënyra se si studiohet lënda, më saktë rruga ose grupi i procedurave dhe mjeteve me ndihmën e të cilave merren njohuri për qëllimin e caktuar.²

Çdo disiplinë shkencore, përveç që është objekt studimi (çfarë studion), ka edhe një metodë studimi (si studion). Metoda duhet të jetë e lidhur dhe në përputhje me vetë lëndën. Kjo është krejtësisht e logjikshme, sepse çdo shkencë ka specifikat e veta që kërkojnë një metodë (mënyrë) specifike për t'iu qasur studimit të fushës përkatëse, për ta kuptuar sa më mirë atë. Kështu, për shembull, një metodë e natyrshme për shkencat natyrore është eksperimenti, i cili është i papërshtatshëm për studimin e fenomeneve shoqërore.

Ndarja e metodave të Bazave të së drejtës

Qëllimi i metodave të përdorura nga Bazat e së drejtës si disiplinë shkencore është të fitohen njohuri për shtetin dhe të drejtën. Më të rëndësishmet janë metodat e mëposhtme të veçanta të përdorura nga Bazat e së drejtës:

- Metoda juridike
- Metoda sociologjike
- Metoda historike, dhe
- Metoda krahasuese.

² Бајалџиев Д., Миџајков М., Тасковска Д., „Вовед во правото“, 2004, fq. 26.

Nga të gjitha metodat e radhitura, e vetmja metodë pastër juridike është ajo juridike, ndërsa ajo sociologjike dhe historike janë parësore për shkencat e tyre. Ajo që i bën këto metoda të rëndësishme për shkencat juridike është fakti që lëndët e tyre i përkasin grupit të shkencave shoqërore që studiojnë shtetin dhe ligjin nga këndvështrimi i tyre. Prandaj, njohuritë e tyre sigurisht që do të kenë një ndikim të madh në studimin e shtetit dhe të së drejtës. Metoda krahasuese nuk kërkon shpjegime të veçanta pse dhe nëse duhet përdorur duke pasur parasysh etimologjinë e vetë fjalës dhe zbatimin e saj në praktikë.

Metoda juridike (dogmatike) - është metoda më e vjetër dhe më e rëndësishme e shkencave juridike. Kjo metodë studion shtetin dhe të drejtën duke i studiuar normat juridike, pra i studion ashtu siç janë dhënë aktualisht në normat juridike.

Pyetja është se cilat janë normat juridike. Ato janë rregulla të shkruara të sjelljes për njerëzit të miratuara nga shteti. Duke qenë se shteti është bartës i normave juridike, ai siguron dhe garanton zbatimin e tyre. Për shembull: "Kushdo që vjedh do të dënohet me burg". "Ndalohej mbushja e alkoolit për të miturit". Në rast të shkeljes së normave ligjore, shteti zbaton një gjobë ose sanksion.

Metoda juridike studion sistemin e normave juridike në tërësi. Qëlimi i saj nuk është të përgjigjet pse shteti dhe ligji janë ashtu siç janë, nëse janë të mirë apo të këqij, por vetëm të analizojë normat juridike dhe të përcaktojë kuptimin e vërtetë të tyre.

Metoda sociologjike - është një metodë e përgjithshme e sociologjisë, por në shkencat juridike ajo studion dhe shpjegon faktorët shoqërorë që çuan në shfaqjen dhe zhvillimin e shtetit dhe së drejtës. Kjo metodë përcakton faktorët dhe marrëdhëniet dhe dukuritë reale shoqërore që ndikuan në krijimin e shtetit dhe së drejtës, si dhe ato që ndikuan në zbatimin e së drejtës. Kështu zbulojmë se përse disa shtete kanë ekzistuar prej kohësh, e disa nga e kaluara e afërt, disa janë të zhvilluara, disa janë të varfra, disa janë demokratike, disa janë autokratike etj.

Metoda historike - vetia themelore e kësaj metode është se ajo i percepton dukuritë shoqërore në lëvizje të vazhdueshme, d.m.th. beson se të gjitha dukuritë shoqërore kanë një periudhë krijimi, zhvillimi dhe zhdukjeje. Kështu, shteti dhe e drejta, nën ndikimin e faktorëve të caktuar shoqërorë, ndodhin në një periudhë të caktuar, zhvillohen në një formë të caktuar dhe përfundojnë ndryshime.

Metoda krahasuese (komparative) - studion dukuritë shoqërore duke i krahasuar me dukuri të ngjashme ose të kundërta. Kjo metodë kryen studim krahasues të të paktën dy shteteve të ndryshme ose dy të drejtave kombëtare. (p.sh., të krahasohen dispozitat e ligjeve të arsimit të mesëm të dy shteteve evropiane.)

Kjo metodë ka një rëndësi të madhe në praktikën juridike dhe politike. Ajo zbatohet kur ka nevojë për harmonizimin e rregullimeve të caktuara të shteteve anëtare të Bashkimit Evropian. Nga ky aspekt, bëhet një krahasim i sistemeve juridike të më shumë shteteve.




Fig. 3: Ndarja e metodave të Bazave të së drejtës

? PYETJE:

1. Çfarë nënkuptohet me termin metodë?
2. Numëroni metodat e veçanta të Bazave të së Drejtës.
3. Shpjegoni metodën juridike.
4. Çfarë metode do të përdornit nëse mësuesi juaj do t'ju jepte detyrën për të zbuluar ngjashmëritë dhe dallimet midis demokracisë athinase dhe demokracisë moderne? Pse?

MBANI MEND !!!

- ✚ Bazat e së drejtës si disiplinë shkencore nuk studion një shtet dhe një të drejtë specifike, por studion konceptet dhe karakteristikat thelbësore dhe të përbashkëta që gjenden në çdo shtet dhe çdo të drejtë, pavarësisht se kur dhe ku kanë ekzistuar, ekzistojnë ose do të ekzistojnë.
- ✚ Qëllimi kryesor i Bazave të së drejtës si disiplinë shkencore është të ofrojë njohuri themelore, të përgjithshme dhe hyrëse të shtetit dhe të së drejtës.
- ✚ Shkencat juridike studiojnë shtetin dhe të drejtën si dy kategori sociale të rëndësishme dhe të ndërlidhura.
- ✚ Ka shkenca juridike të përgjithshme, pozitive, konkrete dhe historike.
- ✚ Termi metodë e ka origjinën nga fjala latine *metodus*, që do të thotë mënyra se si studiohet lënda, më saktë rruga ose grupi i procedurave dhe mjeteve me ndihmën e të cilave merren njohuri për qëllimin e caktuar.
- ✚ Bazat e së drejtës si disiplinë shkencore i përdor këto metoda të veçanta: juridike, sociologjike, historike dhe krahasuese.

2. KRIJIMI DHE NOCIONI I SHTETIT DHE SË DREJTËS

2.1. KOMUNITETET SHOQËRORE PA SHTET – KOMUNITETET JO-SHTETËRORE

Ka pikëpamje të ndryshme për zhvillimin historik të shtetit, më saktë se kur dhe si u krijua shteti. Në teori ekzistojnë shprehje të ndryshme për gjendjen para shfaqjes së shtetit, respektivisht për shoqëritë që kanë ekzistuar në të kaluarën, por nuk kanë qenë të organizuara si shtet por kanë pasur forma të tjera organizimi. Këto shoqëri quhen shoqëri fillestare ose primitive, bashkësi primitive, gjendje para-shtetërore, bashkësi jo-shtetërore, bashkësi njerëzore primitive etj.

Komuniteti fillestar është një shoqëri në të cilën nuk ka shtet dhe është gjendje e pa-shtetësisë. Në vetë zhvillimin e bashkësisë fillestare nga një shoqëri pa klasa deri në shfaqjen e arsyeve për krijimin e shtetit dhe së drejtës, dallohen dy periudha: epoka e gurit dhe epoka e metalit.

Karakteristika themelore e bashkësisë fillestare është uniteti dhe barazia. Kjo kushtëzohet nga zhvillimi i ulët i aftësive mendore dhe i mjeteve të punës së njeriut. Në një situatë të tillë, njerëzit mund të ekzistojnë dhe mbijetojnë vetëm të bashkuar. Në format e hershme të zhvillimit të komunitetit, njerëzit primitivë përdornin produkte të gatshme natyrore që i ndanin me njëri-tjetrin. Ata punonin shumë për të siguruar ushqim, sepse nuk dinin as për blegtori, as për bujqësi, as nuk dinin asgjë për përpunimin e prodhimeve të marra. Gjuetia, peshkimi dhe mbledhja e frutave ishin e vetmja mënyrë për të mbijetuar.

Periudha e ardhshme në zhvillimin e bashkësisë fillestare karakterizohet si epoka e metalit e cila paraqet një shkallë më të lartë të zhvillimit të bashkësisë fillestare. Në këtë periudhë, komuniteti apo bashkësia ende luan një rol të madh në jetën e njeriut fillestar, me atë që tashmë shtrihet te mjetet që njeriu i gjen në natyrë dhe i përvetëson. Por kjo është një periudhë e zhvillimit të komunitetit kur jeta njerëzore ka evoluar vazhdimisht, duke çuar në shfaqjen e blegtorisë dhe bujqësisë dhe mjetet që njeriu ka përdorur për të mbledhur drejtpërdrejt jo vetëm fruta nga natyra, por edhe për të krijuar vetë produkte të reja. Në varësi të materialit të përdorur për të bërë veglat dhe armët, epoka e metalit ndahet në epokën e bakrit, bronzit dhe hekurit.

Gjatë kësaj periudhe rritet nevoja për prodhimin e mallrave për nevojat personale. Ata e bënë përsëri kolektivisht, duke krijuar dhe ndarë së bashku. Tani ekziston pronësia kolektive e mjeteve të punës dhe pronësia kolektive e produktit të punës. E gjithë kjo i inkurajoi ata të ndajnë punën dhe të përmirësohen në aktivitete të caktuara që ata përçuan brez pas brezi, gjeneratë pas gjenerate. Gjegjësisht, me ndarjen sociale të punës vjen deri te ndarja e bujqësisë nga blegtoria dhe zhvillimi i aktiviteteve shtesë si qeramika. Në këtë fazë njerëzit ishin të lidhur në grupe shoqërore të quajtura gjini. Parimi themelor i lidhjes në gjinitë si grupe shoqërore ishte farefisnia nga gjaku. Gjinia përbëhej nga të gjithë pasardhësit e një stërgjysheje (matriarkati) ose të gjithë pasardhësit e një stërgjyshi (patriarkati). Matriarkati ishte një organizatë e tillë shoqërore në të cilën nëna luante një rol vendimtar në jetën shoqërore dhe babai luante një rol vendimtar në patriarkat. Në gjini të gjithë anëtarët ishin të barabartë dhe të lirë. Nuk kishte ndarje klasash, as interesa të kundërta. Familja kishte organizimin e saj të brendshëm dhe rregullat e saj të pashkruara që ishin të detyrueshme për të gjithë anëtarët. Ato rregulla sjelljeje dhe rregullimi të marrëdhënieve ndër-personale ishin zakone. Këto rregulla u pranuan përgjithësisht nga të gjithë anëtarët e komunitetit, sepse mosbindja ndaj tyre zemëronte komunitetin dhe perënditë, ndaj të cilëve njerëzit fillestarë kishin nderim dhe frikë. Në krye të familjes ishte një plak, i cili zakonisht ishte anëtar i më i vjetër, më i mençur, më i zgjuar i grupit që gëzonte një reputacion të madh në mesin e anëtarëve të komunitetit. Secila prej gjinive kishte faltoren e saj, ritet fetare, emrin, varrezat e përbashkëta.

Organizimi i brendshëm i gjinisë përbëhej nga:

- a) një kryeplak i familjes, autoriteti i të cilit ishte i natyrës morale;
- b) një asamble gjinore e përbërë nga të gjithë anëtarët madhorë të gjinisë, të cilët vendosnin bashkërisht për çështjet më të rëndësishme.

Krahas gjinisë, si bashkësi shoqërore në bashkësinë fillestare krijohen vëllazëria (vëllazëria) (fraterniteti) dhe fisi. Klane të shumta formonin një vëllazëri dhe vëllazëri të shumta (3-5) formonin një fis.

Pushteti në komunitetin fillestar

Përmendëm se për shkak të zhvillimit të ulët të mjeteve të prodhimit, puna dhe prona në bashkësinë fillestare ishin kolektive. Kolektiviteti reflektoi edhe në opinionet e njerëzve. Nuk kishte interesa individuale dhe kontradiktore, por vetëm një synim i përbashkët mbijetese, i cili mund të arrihej vetëm në komunitet, pra bashkësi. Arsyet e varësisë së tyre nga komuniteti kushtëzoheshin nga frika e pasigurisë që i pret jashtë komunitetit. A do të mbijetojnë? A do të kenë sukses ata vetë?

Kjo i përcakton edhe karakteristikat e pushtetit, të cilin në një formë të caktuar e gjejmë në komunitetin fillestar.

Pushteti nënkupton një marrëdhënie midis dy subjekteve, njëri prej të cilave urdhëron dhe tjetri është i detyruar të dëgjojë.

Ai që komandon ka edhe mjetet për të zbatuar detyrimin për të imponuar vullnetin e tij. Në komunitetin fillestar, pushteti zakonisht i takonte kryeplakut të fisit, por ai nuk mund të vendoste vetë dhe të shkonte kundër dëshirave të të gjithë anëtarëve të komunitetit. Ai ishte, në fakt, i pari mes të barabartëve. Kjo është arsyeja pse nuk mund të flitet për një ushtrim formal ligjor të pushtetit në komunitetin fillestar. Pushteti në këtë kuptim nuk ekzistonte në komunitetin fillestar. Ky pushtet nuk u imponua, por lindi nga vetë njerëzit, të cilët ndiheshin të sigurt vetëm në komunitet. I gjithë populli ushtronte drejtpërdrejt pushtetin dhe merrte pjesë në vendimmarrje për të gjitha çështjet. Rregullat e sjelljes që ekzistojnë në komunitetin fillestar ishin shprehje e interesave të të gjithë anëtarëve të komunitetit dhe zbatoheshin vullnetarisht dhe bashkërisht. Këto rregulla sjelljeje, qofshin ato zakonore, morale apo fetare, pasqyronin mënyrën kolektive të jetesës. Duke pasur parasysh këtë natyrë të rregullave dhe vendimeve, të cilat zakonisht nuk shkeleshin, nuk kishte nevojë për një organ që me forcë, me ndihmën e forcës fizike do të bënte që anëtarët e komunitetit ta respektonin.

Nëse ndonjëherë ndonjë pjesëtar i komunitetit i dhunonte, gjë që ishte e rrallë, atëherë reagoonte i gjithë komuniteti dhe jo një organ i veçantë shtrëngues i ndarë nga populli me funksionin e kryerjes së shtrëngimit. Në fakt, një trup që zotëronte forcë fizike, si policia apo ushtria, as që ekzistonte në komunitetin fillestar. Detyrimi varej nga vetë komuniteti, në të cilin kishte kushte shumë të vështira jetese, të cilat impononin rregulla respekti dhe bindjeje ndaj atyre që ishin më të aftët,

më të mençurit dhe nga të cilët varej mbijetesa e komunitetit. Dënimi më i rëndë ishte përjashtimi nga komuniteti, që barazohet me dënimin me vdekje në kushtet e sotme. Nga kjo mund të konkludohet se pushteti në komunitetin fillestar ishte i një karakteri të çorganizuar (difuz)³ dhe bazohej në dy faktorë:

- opinionin e pandarë publik të të gjithë komunitetit (nëse mund të flasim fare për opinionin publik në atë periudhë të zhvillimit të shoqërisë);
- autoritetin, reputacionin e krerëve të fiseve.

? PYETJE:

1. Rendisni shprehjet e përdorura për të shpjeguar situatën para formimit të shtetit.
2. Cilat janë karakteristikat themelore të rendit shoqëror në bashkësinë fillestare?
3. Cilat grupe shoqërore ekzistojnë në bashkësinë fillestare?
4. Cili është parimi bazë mbi të cilin mbështeteshin njerëzit në komunitetin fillestar?
5. Çfarë është pushteti?
6. Shpjegoni se si ushtrohej pushteti në bashkësinë fillestare.
7. Në cilët faktorë mbështetej pushteti në komunitetin fillestar?
8. Cili ishte dënimi më i rëndë në komunitetin fillestar? Pse?
9. Shpjegoni rolin e kryeplakut të fisit.

³ Балајџиџев Д., „Вовед во правото“, 1999, fq. 74.

2.2. TEORITË E FORMIMIT TË SHETIT

Formimi i shtetit dhe së drejtës ishte një proces social relativisht i gjatë. Interesi për të studiuar origjinën e shtetit është veçanërisht i rëndësishëm pas shpërbërjes së bashkësisë origjinale, kur rritet nevoja për njohjen e strukturës shoqërore, një tërësi organizative e mishëruar në shprehjen shtet. Prandaj, nga nevoja për të njohur origjinën, thelbin, vendin, rolin dhe funksionimin e shtetit, janë zhvilluar një sërë teorish. Teoritë më të rëndësishme për formimin e shtetit janë: teoria e forcës, teoria e marrëveshjes dhe teoria e klasës.

Teoria e forcës

Sipas kësaj teorie, shteti nuk krijohet për shkak të dallimeve klasore dhe zhvillimit të shoqërisë, por arsyeja themelore e krijimit të tij qëndron në pushtimin, dhunën dhe nënshtrimin e një fisi nga një tjetër. Gjegjësisht, konsiderohet se krijimi i shtetit është në raport shkak-pasojë me dhunën, gjegjësisht dhuna dhe nënshtrimi i një fisi përfundon me pushtimin e territorit të fisit të nënshtruar dhe skllavërimin e tij.

Kështu, shteti krijohet për të ushtruar pushtet mbi të tjerët pavarësisht nga vullneti i tyre. Në shembullin konkret, kur një fis nënshtron një fis tjetër, për të vendosur kontrollin mbi popullsinë (banorët) dhe territorin e huaj, krijohet një aparat i veçantë shtrëngimi. Fituesit krijojnë pushtetin, dhe të nënshtruarit krijojnë klasën prodhuese ose të nënshtruar, pra fiset shndërrohen në klasa dhe shtresa dhe prej tyre krijohet shteti. Kështu, pushteti shtetëror është një supremaci ushtarake që rritet në një monopol të qëndrueshëm të detyrimit.

Kjo teori thekson forcën dhe detyrimin si një arsye të rëndësishme dhe vendimtare për shfaqjen e shtetit.

Teoria e marrëveshjes (kontraktuale)

Sipas kësaj teorie, formimit të shtetit i paraprin një gjendje natyrore e njeriut, por në të cilën kushtet e jetesës së njerëzve dhe marrëdhëniet e tyre të ndërsjella vendosen mbi baza të pabarabarta dhe të pasigurta. Për shkak të kësaj situatë, individët e lindur në liri duhet të krijojnë një shtet me ndihmën e të cilit duhet të arrijnë disa qëllime të përbashkëta.

Prandaj, formimi i shtetit rezulton në bashkimin e popullit në bazë të një marrëveshjeje. Sipas kësaj marrëveshjeje, njerëzit bien dakord që të drejtat e tyre ose disa prej tyre t'ia kalojnë një personi të caktuar të cilit ia dorëzojnë pushtetin dhe t'i nënshtrohen atij, me kusht që t'u garanto-hen të drejtat elementare dhe siguria që nuk e kanë në gjendjen e tyre natyrore. Praktikisht, në bazë të një marrëveshjeje të tillë, tashmë shteti është i detyruar të mbrojë pronën private dhe sigurinë e përgjithshme të të gjithë njerëzve. Nëse shteti i keqpërdor ata, populli ka të drejtën e plotë të përgjigjet me rebelim dhe kryengritje, pra ndryshim të dhunshëm të pushtetit. Njerëzit krijojnë shtetin për të shmangur një situatë në të cilën rrezikohet jeta dhe prona e tyre, ose për të mirën e përbashkët dhe për të shmangur një gjendje lufte.

Kjo teori ka luajtur një rol të madh në botë dhe një rol të madh në revolucionet civile.

Teoria e klasës

Sipas kësaj teorie, shpjegimi i origjinës së shtetit dhe ligjit perceptohet përmes zhvillimit të bashkësisë fillestare si një shoqëri pa klasa, në të cilën krijohen supozimet bazë për zhvillimin e shtetit dhe të së drejtës, duke evoluar nëpër periudha të ndryshme, të kushtëzuara nga shkalla e zhvillimit të njeriut dhe mjetet e punës.

Domethënë, vetë zhvillimi i klasave u kushtëzua nga përmirësimi i mjeteve të prodhimit, ndarja e punës dhe shfaqja e pronës private. Nën ndikimin e drejtpërdrejtë të zhvillimit të mjeteve të prodhimit, por edhe të njohurive të njeriut, si dhe të ndarjes së punës, krijohet një mundësi për të kënaqur jo vetëm nevojat ditore, por të krijohet edhe tepriçë.

Ajo tepriçë bëhet rezervë dhe fillimi i pronës private. Deri atëherë mjetet e prodhimit i përkisnin komunitetit dhe tani individët bëhen pronarë. Për shkak të shfaqjes së pronës private, një grup individësh, për shkak të pozitës së spikatur shoqërore që lind nga statusi i tyre, janë në gjendje të grumbullojnë më shumë se të tjerët. Kjo çon në ndarjen e shoqërisë në klasa dhe në dallime ndërmjet tyre. Për të parandaluar një konflikt të hapur klasor dhe për të siguruar zhvillim të mëtejshëm shoqëror, ndodh lindja e shtetit dhe e së drejtës.

Ndonëse është rregull që në një konflikt të tillë gjithmonë fiton më i forti ekonomisht, prapëseprapë është e pamundur që një shoqëri të ekzistojë në një konflikt shfarosës. Në të duhet të ketë ndonjë institucion që do ta racionalizojë këtë konflikt dhe ta zbusë deri diku. Kështu zhvillohet shteti, bashkë me të edhe ligji, pra normat juridike që do të jenë të detyrueshme për të gjithë dhe përmes të cilave klasa sunduese do të mbrojë interesat e saj.

DALLIMI SHTET – BASHKËSI FILLESTARE

Shteti ka disa veçori që e dallojnë atë nga bashkësia fillestare. Dallimet janë paraqitur në tabelën e mëposhtme

SHTETI	BASHKËSIA FILLESTARE
Lidhja e njerëzve në shtet bëhet sipas lidhjeve territoriale.	Lidhja e njerëzve në bashkësinë fillestare bëhet mbi parimin e lidhjes së gjakut.
Në shtet ka pronë private.	Në bashkësinë fillestare ekziston pronësia kolektive.
Pushteti publik ekziston dhe ushtrohet në shtet.	Në bashkësinë fillestare ekziston pushteti i të gjithëve, pra pushteti ushtrohet nga të gjithë anëtarët e bashkësisë fisnore.
Në shtet ekzistojnë norma juridike që nuk janë shprehje e vullnetit të të gjithë anëtarëve të tij, por shprehje e vullnetit të mbajtësve të pushtetit.	Në bashkësinë fillestare ekzistojnë norma zakonore që janë zbatuar nga të gjithë dhe janë shprehje e vullnetit të të gjithë anëtarëve të bashkësisë.
Për të respektuar normat ligjore në shtet, aplikohet një aparat shtrëngimi/detyrimi fizik, i cili kryhet duke përdorur forcë dhe mbështetet në ushtri, polici, burgje.	Respektimi i normave zakonore është vullnetar dhe pa detyrim nga të gjithë anëtarët e komunitetit. Këtu nuk ka asnjë aparat shtrëngimi/detyrimi fizik.

Për funksionimin dhe mirëmbajtjen e pushtetit publik dhe të aparatit të tij të shtrëngimit (ushtrisë, policisë, burgjeve, etj.), nevojiten mjete materiale që sigurohen nëpërmjet një takse të paguar nga qytetarët.

Taksat ishin të panjohura për komunitetin fillestar.

? PYETJE:

1. Cila është arsyeja themelore e shfaqjes së shtetit sipas teorisë së forcës?
2. Cili është roli i shtetit sipas teorisë së marrëveshjes?
3. Shpjegoni teorinë e klasës.
4. Shpjegoni dallimet midis shtetit dhe bashkësisë fillestare.

2.3. NOCIONI I SHTETIT DHE SË DREJTËS

Në teori, ekzistojnë përkufizime të ndryshme se çfarë është një shtet. Që termi shtet është i vështirë për t'u përcaktuar, vërtetohet edhe nga emrat e përdorur për ta treguar atë. Në gjuhën tonë fjala shtet i referohet dikujt që mban pushtetin, pra ka pushtetin në dorë. Në gjuhët e Evropës Perëndimore, fjala shtet rrjedh nga fjala latine status, që do të thotë gjendje. Grekët e lashtë përdornin termin polis, që do të thotë qytet-shtet, ndërsa romakët përdornin termin res publica, që do të thotë punë publike ⁴.

Ashtu siç ka terma të ndryshëm për termin shtet, ashtu ka edhe shumë përkufizime për të. Le të përmendim përkufizimin e Niccolo Machiavelli-t ⁵, i cili prezantoi i pari termin stato ⁶. Sipas tij, shtet nënkupton çdo formë qeverisjeje, qoftë ajo republikë apo monarki, e cila synon të rregullojë diçka, ta organizojë, ta vendosë atë në baza të përhershme dhe konstante.

Pavarësisht termave dhe përkufizimeve të ndryshme të shtetit, të gjithë vijnë në të njëjtin kuptim - **se shteti është një kategori klasore dhe shoqërore që ka një mjet shtrëngimi/detyrimi fizik.**

Shteti është diçka që është mjedisi dhe realiteti ynë. Duke qenë se shteti shfaqet si një institucion që synon të rregullojë dallimet klasore, aparati i detyrimit fizik, i cili është unik për të, është një mjet bazë për ruajtjen e rendit në shtet. Kështu, p.sh., qytetarët si tatimpagues janë të detyruar të paguajnë tatimin dhe në rast të mos-përmbushjes së këtij detyrimi ligjor nga ana e tyre, shteti e mbledh atë me forcë. Gjithashtu, nëse pjesëmarrësit në trafik nuk respektojnë rregullat e përcaktuara të komunikacionit, zyrtarët menjëherë mund të aplikojnë/shqiptojnë dënimin përkatës. Në këta shembuj shteti shfaqet si dikush që na detyron për të bërë diçka.

⁴ Civitas, regnum, imperium - држава како политичка заедница; Polis - држава како заедница на луѓе; lënd, terra, terre - држава како територијална заедница.

⁵ Балајџиев Д., Мицајков М., Тасковска Д., „Вовед во правото“, 2004, fq. 42.

⁶ Gjendje, rregullim shtetëror

Nga ana tjetër, shteti bën shumë gjëra që nuk lidhen drejtpërdrejt me detyrimin. Kështu p.sh. mund të ngrejë shkolla, kopshte, spitale, opera e teatro, të ndërtojë infrastrukturë rugore etj., dhe në një rast të tillë nuk shfaqet si një shtrëngim i organizuar ndaj popullit, por si një organizatë që kryen disa aktivitete sociale që janë pak a shumë të rëndësishme për të gjithë.

Por që shteti ta arrijë këtë, i duhet e drejta. Në terminologjinë juridike ekzistojnë terma të ndryshëm për fjalën e drejtë, si ius (e drejta romake), anglisht right etj.

E drejta është një grup rregullash juridike të miratuara nga shteti dhe shërbejnë për të rregulluar sjelljen, marrëdhëniet dhe lidhjet e ndërsjella të njerëzve në një shoqëri. Respektimi i tyre sigurohet nga shteti me sanksion të detyruar

2.4. NOCIONI I VLERAVE JURIDIKE

Në teori njihen këto vlera juridike: drejtësia, drejtshmëria, liria, dinjiteti njerëzor, siguria, barazia, rendi, paqja, etj. Vlerat juridike janë kuptimi dhe qëllimi i të gjithë ligjit, pra të gjithë elementëve të tjerë të tij. Me ndihmën e tyre përcaktohen qëllimet në rendin juridik⁷.

2.4.1. Drejtësia

Drejtësia është vlera më e lartë shoqërore dhe juridike. Ajo nënkupton proporcionalitet dhe konformitet. Drejtësia është themeli i çdo shteti, gjegjësisht qeverisjeje/pushteti dhe duhet të jetë frymëzim i të gjithë ligjvënësve, por edhe i pushtetarëve. Një simbol i njohur i drejtësisë është Justicia, e cila në mitologjinë romake është perëndeshë e drejtësisë. Ajo përshkruhet si një vajzë me sy të lidhur me një shpatë në njërën dorë dhe një peshore në tjetrën. Termi drejtësi në legjislationin tonë i referohet drejtësisë dhe drejtshmërisë si dhe gjyqësorit, gjykatës dhe sallës së gjyqit. Sipas Ulpian-it, një jurist i famshëm romak

⁷ Rendi juridik është një rend i organizuar i marrëdhënieve shoqërore i rregulluar me një normë juridike

“Drejtësia është një përpjekje e vazhdueshme dhe e pandërprerë për t'i dhënë të drejtën secilit”⁸



Fig. 4: Justicia

Nocioni i drejtësisë ka ndryshuar përmes zhvillimit historik dhe nëpër faza të ndryshme të zhvillimit të shoqërive. Por ajo që është e zakonshme është se ligji dhe drejtësia janë të lidhura ngushtë sepse arritja e shtetit të së drejtës do të thotë arritje e drejtësisë. Drejtësia absolute është e pamundur, por ajo që çdo shtet duhet të përpiqet ta bëjë është që rregullat ligjore të bazohen në drejtësi. Pra, e drejta nuk jepet një herë e mirë, por është një kategori e ndryshueshme. Gjatë çdo ndryshimi në rregulloret ligjore duhet të tentohet që të njëjtat të jenë më të qarta, më të drejta dhe t'u përshtaten sa më shumë njerëzve.

⁸ Iustitia est constans et perpetua voluntas ius suum cuique tribuendi.

Për DREJTËSINË kanë thënë

„NUK ËSHTË E VËSHITRË TË JESH I MIRË, POR I DREJTË.”
Viktor Hygo
„DREJTËSIA PA PUSHTET ËSHTË E PAMUNDUR, PUSHTETI PA DREJTËSI ËSHTË TIRANI .”
Blez Paskal
„САМО СЛАБИТЕ НЕ СЕ ОСМЕЛУВААТ ДА БИДАТ ПРАВЕДНИ.”
Рабиндранат Тагоре
„VETËM TË DOBËTIT NUK GUXOJNË TË JENË TË DREJTË.”
Rabindranat Tagore
„DREJTËSIA ËSHTË E MIRË PËR TËRË SHOQËRINË, PUNA MË E FRYTSHME NË SHOQËRI ËSHTË NDARJA E DREJTËSISË.”
Volteri

2.4.2. DREJTSHMËRIA

Drejtshmëria është drejtësi e zbatuar në praktikë.

Kur flasim për drejtësinë, flasim për zbatimin e drejtësisë në situata specifike që nuk mund të zgjidhen vetëm në bazë të ligjit. Drejtësia është udhërrëfyese bazë i gjykatësve në zbatimin e normave ligjore në raste të veçanta. Gjykatësit duhet të thërrasin drejtësinë sa herë që ka dyshime për arsyetimin dhe korrektësinë e një ligji pozitiv (ligjit në fuqi).⁹ Drejtshmëria ushtrohet në favor të atij të cilit do t'i shqiptohet sanksioni.

⁹ Neni 10 i Ligjit për Gjykatat, “Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë nr. 07 e 05.05.2006: “Procedura para gjykatës rregullohet me ligj dhe bazohet në këto parime: ligjshmëria dhe legjitimiteti, barazia e palëve, gjykimi brenda një afati të arsyeshëm, **drejtshmëria**, publiciteti, kontradikta, dy-shkallëshmëria, verbaliteti, oraliteti, menjëhershëmëria, e drejta e mbrojtjes ose përfaqësimit, vlerësimi i lirë i provave dhe economiciteti.”

? PYETJE:

1. Çfarë është shteti?
2. Shpjegoni dy funksionet e shtetit.
3. Çfarë është e drejta?
4. Përshkruani Justicia-n si simbol të drejtësisë.
5. Eksploroni kuptimin e syve të lidhur, shpatës dhe peshores.
6. Shpjegoni se çfarë është drejtshmëria.

DETYRË:

1. Shkruani një ese mbi "Vizioni im për një shoqëri të drejtë".

PROJEKT:

1. Tema për debat "Cila është më afër drejtshmërisë - nëse i trajtojmë të gjithë në mënyrë të barabartë ose kur u qasemi të gjithëve ashtu siç kanë nevojë?"

2.5. LIDHSHMËRIA E NDËRSJELLË E SHTETIT DHE SË DREJTËS

Ekziston një lidhje shumë e ngushtë dhe e pandashme midis shtetit dhe ligjit. Kjo lidhje fillon që nga krijimi i tyre, sepse ato janë pasojë e së njëjtës arsye, pra shfaqjes së klasave, dhe vazhdon në ekzistencën dhe funksionimin e tyre të mëtejshëm. Si të tilla, ato janë dukuri të ndërlidhura. Ndikimi i shtetit në të drejtën më së miri shihet në sferën e krijimit dhe zbatimit të ligjit.

- **Krijimi i së drejtës.** Organet shtetërore krijojnë rendin juridik, përkatësisht përgatisin dhe miratojnë normat juridike dhe aktet juridike (kushtetutën, ligjet, aktet nënligjore). Ato janë gjithmonë shprehje e vullnetit të pushtetarëve, të cilët me akte ligjore imponojnë dhe zbatojnë politikën e tyre.
- **Zbatimi i së drejtës.** Shteti kujdeset që të sigurojë kushte në të cilat do të zbatoheshin rregullat ligjore për zbatimin e tyre pa probleme në jetën e përditshme. Shteti ka autoritetin t'i zbatojë ato norma, nëse është e nevojshme me përdorimin e forcës fizike. Në rast të shkeljes nga qytetarët dhe mosrespektimit të rregullave të përcaktuara, autoritetet shtetërore aplikojnë shtrëngim dhe sanksione për zbatimin e tyre.

Shteti kujdeset për të drejtën dhe përdor potencialin e tij për të arritur qëllimet e politikës shtetërore.

Megjithatë, e drejta prek drejtpërdrejt edhe shtetin, kryesisht në:

- **Organizimin e brendshëm të shtetit.** E drejta krijon strukturën e shtetit, gjegjësisht përmes normave juridike përcaktohet organizimi i brendshëm i shtetit, organet e tij dhe marrëdhëniet e tyre të ndërsjella. Gjithashtu, normat juridike përcaktojnë formën e qeverisjes (nëse do të jetë republikë apo monarki), sistemin politik (demokratik apo jodemokratik), si dhe sistemin shtetëror (shtet unitar apo i përbërë).

- **Aktivitetin e organeve shtetërore.** E drejta përcakton vendin, funksionin dhe punën e organeve shtetërore, pra çfarë dhe si do të punojnë (qeveria, ushtria, policia, ministrinë, gjykatat etj.).
- E drejta mundëson **kontroll efektiv në punën e aparatit shtetëror**, gjegjësisht e drejta e kufizon pushtetin shtetëror. Kjo arrihet nëpërmjet mundësisë së të drejtës për të përcaktuar organizatën dhe për të rregulluar në detaje veprimtarinë e organeve shtetërore. Normat juridike përcaktojnë kufijtë e veprimit të pushtetit shtetëror dhe parandalojnë veprimin arbitrar (vullnetar) të bartësve të pushtetit. Në këtë mënyrë pushteti shtetëror bëhet subjekt i kontrollit, pra ushtrimi i pushtetit të bëhet nga prizmi i ligjit. Pushteti shtetëror duhet të ushtrohet në përputhje me rregullat e njohura paraprakisht dhe të jetë konsistent në zbatimin e tyre. Kjo do të thotë se normat ligjore janë njësoj të rëndësishme si për ata që janë në pushtet ashtu edhe për qytetarët e zakonshëm.

Përvoja na tregon se mosrespektimi i ligjit mund të shkaktojë pasoja të rënda ekonomike dhe politike, mund të dobësojë fuqinë e pushtetit shtetëror dhe kështu të krijojë kushte për një ndryshim revolucionar të qeverisë. Një pushtet që nuk bazohet në ligj është dëshmitar i një krize në të gjithë shoqërinë.

Ndikimi i ndërsjellë i shtetit dhe së drejtës nuk duhet kuptuar si absolutist. Megjithatë, ato janë dy kategori të veçanta shoqërore dhe secila ka karakteristikat e veta.

Përfundim: **Shteti e krijon ligjin, por është edhe vetë produkt i ligjit.**¹⁰

? PYETJE:

1. Shpjegoni ndikimin e së drejtës në shtet.
2. Shpjegoni ndikimin e shtetit në të drejtën.

¹⁰ Лилиќ С., Драшкиќ М., „Основи права“, 2006, fq.17.

MBANI MEND !!!

- ✚ Komuniteti fillestar është një shoqëri në të cilën nuk ka shtet dhe është shprehje e pa-shtetësisë.
- ✚ Karakteristika themelore e bashkësisë origjinale është uniteti dhe barazia.
- ✚ Grupet sociale në komunitetin origjinal janë gjinia, vëllazëria dhe fisi.
- ✚ Lidhja e personave të së njëjtës gjini është bërë me lidhje gjaku.
- ✚ Pushteti nënkupton një marrëdhënie midis dy subjekteve, njëri prej të cilave urdhëron dhe tjetri është i detyruar të dëgjojë.
- ✚ Pushteti në komunitetin fillestar bazohej në dy faktorë: opinionin e pandarë publik të të gjithë komunitetit dhe autoritetin, reputacionin e udhëheqësve të fiseve.
- ✚ Teoritë më të rëndësishme për formimin e shtetit janë: teoria e forcës, teoria e marrëveshjes dhe teoria e klasës.
- ✚ Shteti është një kategori klasore dhe shoqërore që ka një mjet shtrëngimi/detyrimi fizik.
- ✚ E drejta është një grup rregullash juridike të miratuara nga shteti dhe shërbejnë për të rregulluar sjelljen, marrëdhëniet dhe lidhjet e ndërsjella të njerëzve në një shoqëri. Respektimi i tyre sigurohet nga shteti me sanksion të detyruar.
- ✚ Në teori, drejtësia dhe drejtshmëria njihen si vlera ligjore.
- ✚ Ekziston një lidhje shumë e ngushtë dhe e pandashme ndërmjet së drejtës dhe shtetit.
- ✚ Ndikimi i shtetit në të drejtën konsiston në krijimin dhe zbatimin e së drejtës.
- ✚ E drejta ndikon në shtet në lidhje me organizimin e brendshëm të shtetit, veprimtarinë e organeve shtetërore dhe kontrollin e aparatit shtetëror.



II. VEÇORITË E SHTETIT DHE ORGANIZIM-IT SHTETËROR

Pasi të keni lexuar këtë pjesë, duhet të jeni në gjendje të: të identifikoni veçoritë e shtetit, të shpjegoni kuptimin e territorit si veçori e shtetit, të shpjegoni popullsinë si veçori e shtetit, të interpretoni kuptimin e shtetësisë, të shpjegoni pushtetin publik si veçorinë më të rëndësishme të shtetit, të përcaktoni termat organizatë shtetërore dhe organ shtetëror, të kategorizoni organet shtetërore (institucionet e pushtetit publik) dhe të identifikoni kompetencat e tyre, si dhe të llogarisni shumicën.

1. VEÇORITË E SHTETIT

1.1. NOCIONI I VEÇORIVE TË SHTETIT

“Kushdo që pa mjete mbrojtëse (maskë, etj.), pa mbikëqyrje dhe pa kujdes mban qen dhe kafshë të tjera të rrezikshme që mund të trembin ose lëndojnë tjetrin, do të dënohet me gjobë prej 100 deri në 400 euro në kundërvlerë në denarë.”³³

“Asnjë fëmijë nuk duhet t'i nënshtrohet torturës ose trajtimit ose dënimit mizor, çnjerëzor ose poshtërues.”³⁴

³¹ Neni 20 i Ligjit të Pastërtisë Publike, „Gazeta zyrtare e RM“ nr.130/2010.

³² Neni 204 Par.1 i kodit penal, „Gazeta zyrtare e RM“ nr. 37/1996.

³³ Neni 29 i Ligjit të kundërvajtjeve ndaj rendit dhe qetësisë publike, „Gazeta zyrtare e RM“ nr.66/2007 dhe 152/2015.

³⁴ Neni 9 i Ligjit për të drejtat e fëmijëve, „Gazeta zyrtare e RM“ nr.148/2013.

3.2. ELEMENTET E NORMËS JURIDIKE

Norma juridike përbëhet nga tre elemente:

- **Hipoteza**
- **Dispozita**
- **Sanksioni.**

3.2.1. HIPOTEZA (supozimi)

Hipoteza është pjesë e normës juridike e cila parashikon kushtet dhe rrethanat që duhet të plotësohen për të zbatuar dispozitën ose sanksionin e normës juridike.

Prandaj hipoteza përmban kushtet për arritjen e një norme juridike. Duke pasur parasysh natyrën e tyre, hipotezat mund të jenë:

- Hipotezë e dispozitës
- Hipotezë e sanksionit.

Shembuj të hipotezës së dispozitës

„Kushdo që ka pronë është i detyruar të paguajë tatimin.” „Kushdo që është 18 vjeç është i detyruar të marrë letërnjoftim.”
--

Në rastin e parë, nëse dikush nuk ka pronë, nuk do të paguajë tatim dhe në atë rast nuk do të zbatohet norma ligjore. Por nëse ka pronë dhe nuk përmbush detyrimin për të paguar taksën, shteti do ta ndëshkojë.

Në rastin e fundit, nëse nuk jeni 18 vjeç, nuk keni asnjë detyrim ligjor për të marrë letërnjoftim.

Shembull i një hipoteze (supozimi) të sanksionit:

„ Kush vjedh , do të dënohet.”

Në këtë shembull, nëse dikush nuk vjedh, ai nuk do të dënohet. Kushdo që i shkakton dëm tjetrit me veprim, do të dënohet.

3.2.2. DISPOZITA

Dispozita është ajo pjesë e normës juridike në të cilën jepet vetë rregulli i sjelljes.

Ajo është pjesa qendrore dhe më e rëndësishme e normës juridike për të cilën realisht ekzistojnë pjesët e tjera, d.m.th. hipoteza dhe sanksioni. Dispozita mund të urdhërojë një sjellje të caktuar, të ndalojë ose autorizojë dikë të bëjë diçka. Varësisht nga natyra e sjelljes që formulohet me to, dispozitat mund të jenë urdhëruese, ndaluese dhe autorizuese.

Shembull dispozite:

"Qytetari ka të drejtë të ndryshojë emrin e tij/saj personal, pra vetëm emrin ose mbiemrin."³⁵

3.2.3. SANKSIONI

Sanksioni është pjesa e normës juridike që synon të sigurojë zbatimin e dispozitës. Është pjesë e normës juridike e cila përcakton pasojat (sanksionet) që do të ndodhnin për subjektin për shkak të shkeljes së normës juridike. (Shembull, dënim me burg, gjobë, kthim gjësendi, qortim, etj.)

Vetë sanksioni është një dispozitë dytësore, sepse përmban një rregull sjelljeje që do të zbatohet kur nuk përmbushet dispozita e shkallës së parë. Shkelja e normave ligjore duhet të pasohet nga ndërhyrja e shtetit nëpërmjet organeve përkatëse. Delikti është prezumim për zbatimin e sanksionit.

Delikti nënkupton sjelljen e caktuar të kundërligjshme të një personi që cenon dispozitën e normës juridike.

Sjellja me të cilën kryhet krimi, duhet të jetë veprim njerëzor dhe si rregull është i vullnetshëm dhe i vetëdijshëm. Që autori të jetë fajtor, ai duhet të jetë në gjendje të gjykojë, që do të thotë të mundet ta kuptojë se çfarë po bën, si dhe pasojat që mund të vijnë prej saj.

³⁵ Neni 5 i Ligjit për emrin personal, „Gazeta zyrtare e RM“ nr.8/1995.

Kryerja e deliktit mund të jetë me:

Veprim aktiv, pra duke vepruar, duke kryer - p.sh. prishjen e rendit dhe qetësisë publike, dëmtimin trupor, vjedhjen, dhunimin, grabitjen, falsifikimin e parave, terrorizmin, ndërtimin pa leje ndërtimi, etj.

Veprim pasiv, d.m.th. mosveprim, lëshim, do të thotë se personi e ka humbur veprën që ligjërisht ka qenë i detyruar ta kryejë dhe mosveprimi ka të njëjtin kuptim si shkaktimi i pasojave të veprës duke vepruar. Shembuj të veprimit pasiv janë: mos-shlyerja e borxhit, mospagimi i tatimit, mospagimi i ndihmës, mospagimi i alimentacionit, mospagimi i ndihmës mjekësore.

Cilësia dhe sasia e sanksionit janë në përpjesëtim me shkallën e veprës penale. Se cilat do të jenë pasojat varet nga pesha e krimit, pra nga vlera shoqërore që cenohet nga krimi. Sa më e madhe të jetë vepra, aq më i rëndë është sanksioni ligjor. Sanksionet përcaktohen nga shteti dhe zbatohen përmes organeve dhe mjeteve përkatëse.

Qëllimi i sanksionit është të parandalojë kryerjen e krimit dhe riedukimin e tij, por edhe të ndikojë që të tjerët të mos kryejnë krime, pra të veprojnë në mënyrë parandaluese.

Sipas llojit të vlerave shoqërore që cenohen nga krimi, ato ndahen në:

- Juridike-penale (krimet kundër vlerave më të rëndësishme shoqërore);
- Juridike-civile (krimet e natyrës pasurore);
- Administrative-juridike (krimet kundër vlerave më të vogla shoqërore), etj.

Sipas llojit të krimit dallohen këto lloje të sanksioneve:

- Juridike-penale (gjobë, burgim, dënim me vdekje);
- Juridike-civile (kompensim, rikthim në gjendjen e mëparshme);
- Administrative-juridike (disiplinore, gjoba, etj.).

!!! Me rëndësi

Si rregull, çdo norme juridike duhet t'i ketë të tre elementet, por mund të ndodhë që t'i mungojë një element, ose hipoteza ose sanksioni (p.sh. normat kushtetuese nuk përmbajnë hipotezë ose sanksion), ose mund të jenë dhënë në nene të tjera.

? PYETJE:

1. Cilat janë elementet e normës juridike?
2. Çfarë është dispozita e një norme juridike?
3. Çfarë parashikon sanksioni i normës juridike?
4. Pse është i rëndësishëm sanksioni?
5. Çfarë është delikti?
6. Si mund të kryhet delikti?
7. Shpjegoni lidhjen ndërmjet sanksionit dhe deliktit.
8. Çfarë sanksionesh ekzistojnë?

DETYRË:

1. Në shembujt e mëposhtëm vlerësoni se çfarë është delikti dhe si bëhet ai:
 - a) Sonja punon si mjeke në një institucion shëndetësor. Gjatë detyrës së saj, ajo refuzoi t'i ofronte kujdes mjekësor urgjent një pacienti të lënduar.
 - b) Personi P.P. e ka sulmuar personin T.T. dhe i ka shkaktuar lëndime të rënda trupore në kokë.
 - c) Darko me vendim gjykate është i obliguar të paguajë alimentacion në shumë prej 6.000 denarë në muaj, por nuk ka paguar për tre vjet.

2. Imagjinoni që jeni ligjvënës. Cilën nga procedurat e mëposhtme do ta ndalonit me ligj? Renditni procedurat e mëposhtme sipas peshës së tyre dhe shënojin me numrat nga 1 deri në 12 përpara shenjës:

- Zorani shet kokainë për të mbajtur nënën e tij e cila është e papunë dhe e sëmurë.
- Natasha është duke vozitur në një makinë që ajo e di se është vjedhur, por nuk ka marrë pjesë në vjedhjen e saj.
- Lila gjen një portofol dhe merr 1000 denarë prej tij.
- Kemali është shitës i makinave të përdorura dhe kthen kilometrazhin e çdo makine përpara se ta shesë.
- Boshko kryen vjedhje me armë në dyqan.
- Elena del nga dyqani me 500 denarë të kthyer, edhe pse i ka dhënë vetëm 100 denarë shitësit.
- Jana kapet me 5 gramë marihuanë.
- Kalina merret me prostitucion.
- Fikreti nuk mban helmetë kur nget motoçikletën.
- Shkritorja ndot lumin me mbetjet toksike që derdh në të.
- Anita vozit me shpejtësi në gjendje të dehur dhe godet një fëmijë.
- Esma sheh shogën e saj duke vjedhur në një dyqan dhe nuk e denoncon³⁶.

³⁶ „Учиме право”, Фондација Институт Отворено општество, 2002, fq.72-73.

3.3. LLOJET E NORMAVE JURIDIKE

3.3.1. NORMAT JURIDIKE URDHËRORE, NDALUESE, DHE AUTORIZUESE

Varësisht nëse dispozita e normës juridike përmban urdhër, ndalim apo autorizim, ekzistojnë norma juridike urdhërore, ndaluese dhe autorizuese.

Normat juridike urdhërore përmbajnë një dispozitë me të cilën subjekti urdhërohet të bëjë diçka.

Shembuj:

“Të gjithë **janë të detyruar** të respektojnë Kushtetutën dhe ligjet.”³⁷

“Tregtari **duhet** t'i lëshojë konsumatorit faturë fiskale për produktin e shitur, përkatësisht shërbimin e kryer, gjegjësisht faturë të dukshme dhe të lexueshme të shkruar, nëse me rregullore tjetër nuk përcaktohet ndryshe.”³⁸

„Çdo person fizik dhe juridik **është i detyruar** të kujdeset për ruajtjen e pastërtisë publike.”³⁹

„Punëdhënësi **duhet** të bëjë kontrolle shëndetësore për punonjësit të paktën çdo 24 muaj.”⁴⁰

„Kur vizitojnë zonat e piknikut, vizitorët **janë të detyruar** që gjatë daljes nga vendi i piknikut të mbledhin mbeturinat dhe t'i lënë ato në një vend të caktuar të parashikuar për këtë qëllim.”⁴¹

³⁷ Neni 51 Paragrafi 2 i Kushtetutës së RMV, „Gazeta zyrtare e RM” nr.8/1991.

³⁸ Neni 20 i Ligjit për mbrojtjen e konsumatorëve, „Gazeta zyrtare e RM” nr.38/2004

³⁹ Neni 13 i Ligjit për pastërtinë publike, „Gazeta zyrtare e RM” nr.130/2010.

⁴⁰ Neni 22 i Ligjit për Sigurinë dhe Shëndetin në Punë, „Gazeta zyrtare e RM” nr.92/2007.

⁴¹ Neni 20 Paragrafi 2 i Ligjit për pastërtinë publike, „Gazeta zyrtare e RM” nr.130/2010.

Normat juridike ndaluese përmbajnë një dispozitë që e ndalon subjektin të bëjë diçka, pra ndalon sjelljen e caktuar.

Shembuj:

Në objektet publike dhe ndërtesat kolektive dhe individuale të banimit dhe ato tregtare, **ndalohet** vendosja e mbishkrimeve, reklamave ndriçuese dhe video-tabelave, si dhe ngjitja e posterave.⁴²

„**Ndalohet** ekspozimi i simboleve partiake dhe fetare në shkollë të mesme.”⁴³

„Kushdo që shkakton zjarr në pyll dhe për rrjedhojë shkakton dëme të mëdha, dënohet me të paktën 8 vjet burg.”⁴⁴

„Drejtuesi i mjetit motorik, gjatë drejtimit të mjetit **nuk guxon** të përdorë celular ose pajisje të tjera në mënyrë që të zvogëlojë mundësinë e reagimit dhe drejtimit të sigurt të mjetit.”⁴⁵

„**Ndalohet** instalimi, zhvendosja, heqja dhe dëmtimi i paautorizuar i shenjave të trafikut dhe pajisjeve rrugore ose ndryshimi i kuptimit të shenjave të trafikut.”⁴⁶

„Në rrugë publike me qarkullim të njëanshëm për automjete, drejtuesi i mjetit **nuk guxon** ta ngasë mjetin në drejtimin e ndaluar.”⁴⁷

⁴² Neni 17 i Ligjit për pastërtinë publike, „Gazeta zyrtare e RM” nr.130/2010.

⁴³ Neni 7 paragrafi 3 i Ligjit për arsimin e mesëm, „Gazeta zyrtare e RM” nr.44/1995.

⁴⁴ Neni 227 paragrafi 1 i kodit penal, „Gazeta zyrtare e RM” nr. 37/1996.

⁴⁵ Neni 24 paragrafi 1 i Ligjit për sigurinë në komunikacionin rrugor, „Gazeta zyrtare e RM” nr.169/2015.

⁴⁶ Neni 190 i Ligjit për sigurinë në komunikacionin rrugor, „Gazeta zyrtare e RM” nr.169/2015.

⁴⁷ Neni 30 paragrafi 4 i Ligjit për sigurinë në komunikacionin rrugor, „Gazeta zyrtare e RM” nr.169/2015.

Normat juridike autorizuese përmbajnë një dispozitë me të cilën subjekti autorizohet për një sjellje të caktuar.

Subjekteve u jepen disa kompetenca që mund t'i përdorin, por nuk janë të detyruar t'i përdorin. Nëse ata do ta bëjnë këtë varet nga vlerësimi i tyre për situatën specifike.

Shembuj:

"Nëse nxënësi nuk është i kënaqur me disa nga notat vjetore që i janë komunikuar, brenda 3 ditëve nga shpallja e notave **ka të drejtë** të bëjë ankesë në këshillin mësimor të shkollës publike."⁴⁸

"Nxënësi i cili gjatë shkollimit në shkollat publike shquhet për aftësi, njohuri dhe shprehi të punës dhe ka sukses të shkëlqyeshëm, **mund** të përparojë më shpejt, pra të kryejë dy vite në një vit shkollor."⁴⁹

"Nëse pala kontraktuese ose pala e tretë me kërcënim të paautorizuar ka shkaktuar frikë të arsyeshme tek pala tjetër me lidhjen e marrëveshjes, pala tjetër **mund** të kërkojë anulimin e marrëveshjes."⁵⁰

"Çdo shtetas mbi moshën 18 vjeçare fiton **të drejtën e votës**."⁵¹

"Qytetarët **kanë të drejtë** të formojnë shoqata të qytetarëve dhe parti politike, të anëtarësohen dhe të tërhiqen prej tyre."⁵²

⁴⁸ Neni 47 paragrafi 1 i Ligjit për shkollim të mesëm, „Gazeta zyrtare e RM“ nr.44/1995.

⁴⁹ Neni 52 paragrafi 1 i Ligjit për shkollim të mesëm, „Gazeta zyrtare e RM“ nr.44/1995.

⁵⁰ Neni 52 paragrafi 1 i Ligjit për detyrimet, „Gazeta zyrtare e RM“ nr.18/2001.

⁵¹ Neni 22 paragrafi 1 i Kushtetutës së RMV, „Gazeta zyrtare e RM“ nr.8/1991.

⁵² Neni 20 paragrafi 2 i Kushtetutës së RMV, „Gazeta zyrtare e RM“ nr.8/1991.

3.3.2. NORMAT E PËRGJITHSHME DHE INDIVIDUALE JURIDIKE

Ekzistojnë edhe ndarje të tjera të normave juridike. Sipas fushëveprimit të normës juridike dhe subjekteve që synojnë, normat juridike ndahen në të përgjithshme dhe individuale.

Normat e përgjithshme juridike janë ato norma që i drejtohen një numri të pakufizuar subjektësh dhe situatash, d.m.th. ato norma juridike që çdo subjekt është i detyruar t'i respektojë. Ato nuk përcaktohen me emër apo me rast.

Shembuj:

„**Ai** që krijon ose shkarkon nga dikush tjetër një virus kompjuterik me qëllim të depërtimit në një kompjuter tjetër ose rrjet kompjuterik, dënohet me gjobë ose me burgim deri në një vit.”⁵³

„**Secili** është i detyruar të paguajë taksa dhe detyrime të tjera publike dhe të marrë pjesë në shlyerjen e shpenzimeve publike në mënyrën e përcaktuar me ligj.”⁵⁴

Normat juridike individuale janë ato norma që u drejtohen subjekteve të përcaktuara saktë, d.m.th. ato, dispozita e të cilave i referohet një subjekti ose një grupi të caktuar subjektësh.

Shembuj:

„Personi **M.N.** obligohet të paguajë tatim në pronë në shumë prej 10.000 denarësh.”

„ Personat **M.N. dhe G.V.** dënohen me 3 vjet burg.”

Normat juridike individuale burojnë nga ato të përgjithshme dhe duhet të jenë në përputhje me to. Normat individuale miratohen në përputhje me normat e përgjithshme dhe brenda kufijve të përcaktuar prej tyre.

⁵³ Neni 251 paragrafi 1 i Kodit penal, „Gazeta zyrtare e RM” nr.37/1996.

⁵⁴ Neni 33 i Kushtetutës së RMV, „Gazeta zyrtare e RM” nr.8/1991.

Shembull:

Neni 235 paragrafi 1 i Kodit Penal parasheh veprën e vjedhjes. "Kushdo që i merr tjetrit sendin e luajtshtëm me qëllim për ta përvetësuar, dënohet me gjobë ose me burgim deri në 3 vjet", që është normë e përgjithshme. Kjo normë mund të përfshijë shumë subjekte individuale në të ardhmen në krimin e vjedhjes, sepse "kushdo" u referohet të gjithë personave. Në rast se personi XX kryen vjedhje, gjykata kompetente për shqyrtimin e kësaj vepre do të dënojë XX sipas nenit 235 të Kodit Penal, për të cilin krim, p.sh., parashikohet dënim me burg deri në 3 vjet. Nga kjo rezulton se norma e nenit 235 të Kodit Penal është një normë juridike e përgjithshme, ndërsa sanksioni që përmban aktgjykimi i dhënë ndaj XX është një normë juridike individuale.

3.3.3. NORMAT IMPERATIVE, DISPOZITIVE DHE ALTERNATIVE JURIDIKE

Sipas shkallës së përcaktimit, normat juridike ndahen në absolutisht të përcaktuara dhe relativisht të përcaktuara.

Absolutisht të përcaktuarat janë, në fakt, normat imperative juridike.

Normat juridike imperative janë ato norma juridike në të cilat jepen rregullat e sjelljes, sipas të cilave subjekti duhet të veprojë nëse dëshiron të shkaktojë efektin e caktuar juridik, gjegjësisht nëse dëshiron të shmangë zbatimin e sanksionit përkatës. Normat juridike imperative gjenden në kushtetutë, në të drejtën penale e të ngjashme. Ato kryhen sipas detyrës zyrtare, nuk lënë lirinë e ndryshimit nga subjektet të cilave u referohen dhe janë të detyrueshme për të gjitha subjektet e sistemit juridik.

Shembuj:

"Kushdo që i merr tjetrit sendin e luajtshtëm me qëllim përvetësimin e tij, dënohet me gjobë ose me burgim deri në 3 vjet".⁵⁵

"Secili është i detyruar të përmbahet nga çdo veprim që mund t'i shkaktojë dëm tjetrit".⁵⁶

⁵⁵ Neni 235 paragrafi 1 i Kodit penal, "Gazeta zyrtare e RM" nr.37/1996.

⁵⁶ Neni 9 i Ligjit për detyrimet, "Gazeta zyrtare e RM" nr.18/2001.

Normat juridike relativisht të përcaktuara paraqiten si **norma juridike dispozitive dhe alternative**.

Normat juridike dispozitive janë ato që u lejojnë subjekteve edhe sjellje të tjera nga ajo që është përcaktuar në normën dispozitive.

Këtu lihen vetë subjektet që të krijojnë dispozitën, pra në vend të dispozitës së dhënë, të krijojnë vetë një dispozitë tjetër. Gjegjësisht, subjektet mund të zgjedhin sjelljen e përcaktuar në normën juridike dispozitive ose të krijojnë një sjellje tjetër. Nëse nuk e shfrytëzojnë mundësinë për të krijuar dispozitën e tyre, atëherë për zgjidhjen e rastit konkret do të zbatohet ajo që është e paraparë në normën juridike dispozitive. Nga kjo mund të konstatohet se normat juridike dispozitive kanë karakter subsidiar.

Shembull:

„Kur vendi i dorëzimit nuk është përcaktuar me kontratë, dorëzimi i sendit bëhet në vendin ku shitësi në momentin e lidhjes së kontratës ka pasur vendbanimin e tij ose në mungesë të këtij vendbanimi ndërsa nëse shitësi e ka lidhur kontratën në kryerjen e veprimtarisë së tij të rregullt tregtare, atëherë në vendin e selisë së tij.”⁵⁷

„Në mungesë të një dispozite kontraktuale ose të zakoneve tjera, pagesa bëhet në momentin dhe në vendin ku bëhet dorëzimi i sendit.”⁵⁸

Nga shembulli i parë shihet se palët kontraktuese mund të caktojnë një vend tjetër për dorëzimin e sendit, por nëse nuk e bëjnë, atëherë do të konsiderohet se sendi duhet të dorëzohet në vendin ku shitësi ka pasur vendbanimin ose qëndrimin e tij në momentin e lidhjes së kontratës.

⁵⁷ Neni 459 paragrafi 1 i Ligjit për detyrimet, "Gazeta zyrtare e RM" nr.18/2001.

⁵⁸ Neni 504 paragrafi 2 i Ligjit për detyrimet, "Gazeta zyrtare e RM" nr.18/2001.

Shembuj të normave dispozitive:

„ **Nëse nuk është rënë dakord ndryshe**, pala që ka paguar depozitën nuk mund ta anulojë kontratën duke ia lënë depozitën palës tjetër dhe as pala tjetër nuk mund ta bëjë këtë duke e kthyer depozitën e dyfishtë.”⁵⁹

„Nëse artikulli shitet me kredi, blerësi detyrohet edhe me interes **përveç nëse nuk është rënë dakord ndryshe.**”⁶⁰

„E drejta e blerjes së parë përfundon pas pesë vjetësh nga lidhja e kontratës, **përveç rasteve kur është rënë dakord** që ajo të përfundojë më herët.”⁶¹

„**Nëse nuk është rënë dakord** ndryshe, ose në vendin e dorëzimit të sendit zakonisht, qiraja paguhet çdo gjashtë muaj kur sendi jepet me qira për një ose më shumë vite dhe nëse jepet për një periudhë më të shkurtër, atëherë pas skadimit të asaj periudhe.”⁶²

Norma dispozitive më së shpeshti paraqitet në ato fusha ku konsiderohet se marrëdhëniet e ndërsjella më së miri do t'i rregullojnë vetë subjektet me dispozitat e tyre. Fusha të tilla janë p.sh., e drejta pronësore dhe civile, ku shprehet parimi i autonomisë së vullnetit të palëve, pra parimi që vetë subjektet e marrëdhënies, sipas dëshirës së tyre, i rregullojnë marrëdhëniet.

Ndryshe nga normat juridike dispozitive, të ashtuquajturat **norma juridike alternative përmbajnë dy ose më shumë dispozita, gjegjësisht sjellje dhe subjekti është i autorizuar të përcaktohet dhe të zgjedhë vetëm njërën prej tyre dhe nuk është i autorizuar që vetë të krijojë dispozitë.**

Subjekti nuk mund të zgjedhë përtej mundësive të dhëna.

E drejta e zgjedhjes i përket subjektit të detyrimit.

⁵⁹ Neni 71 paragrafi 3 i Ligjit për detyrimet, "Gazeta zyrtare e RM" nr.18/2001.

⁶⁰ Neni 505 i Ligjit për detyrimet, "Gazeta zyrtare e RM" nr.18/2001.

⁶¹ Neni 519 i Ligjit për detyrimet, "Gazeta zyrtare e RM" nr.18/2001.

⁶² Neni 586 paragrafi 2 i Ligjit për detyrimet, "Gazeta zyrtare e RM" nr.18/2001.

Shembuj:

"Gjatë martesës, secili nga bashkëshortët mund të mbajë mbiemrin e mëparshëm, **ose** të shtojë mbiemrin e bashkëshortit të ardhshëm, **ose** si mbiemër të përbashkët, të dy mund të marrin mbiemrin e burrit të ardhshëm, **ose** si mbiemër i zakonshëm të shërbejë mbiemri i bashkëshortes së ardhshme."⁶³

"Në rast se kontrata përmbushet, depozita duhet të kthehet **ose** të llogaritet në përmbushjen e detyrimit."⁶⁴

"Konsumatori të cilit i është shitur një produkt me defekt ka të drejtë të kërkojë:

1. eliminimin falas të defekteve të produktit ose rimbursimin e kostove të bëra për eliminimin e defektit
2. ulje proporcionale të çmimit të shitjes
3. zëvendësimin e produktit me një produkt të përshtatshëm me të njëjtën markë tregtare, lloj, dizajn industrial ose emërtim të origjinës dhe tregues gjeografik të produktit
4. zëvendësimin e produktit me një produkt të përshtatshëm me një tjetër markë tregtare, lloj, dizajn industrial ose emërtim të origjinës dhe tregues gjeografik të produktit, me uljen ose rritjen e duhur të çmimit të produktit; dhe
5. ndërprerjen e kontratës, rimbursimin e shumës së paguar dhe kompensimin e dëmit të pësuar."⁶⁵

Më shpesh, ky lloj i normave juridike është i pranishëm në të drejtën pronësore, civile etj.

⁶³ Neni 30 i Ligjit për familjen, "Gazeta zyrtare e RM" nr.153/2014.

⁶⁴ Neni 71 paragrafi 2 i Ligjit për detyrimet, "Gazeta zyrtare e RM" nr.18/2001.

⁶⁵ Neni 43 i Ligjit për mbrojtjen e konsumatorëve, "Gazeta zyrtare e RM" nr.38/2004.

? PYETJE:

1. Numëroni llojet e normave juridike.
2. Shpjegoni normat juridike urdhërore, ndaluese dhe autorizuese.
3. Bëni dallimin ndërmjet normave juridike të përgjithshme dhe individuale.
4. Bëni dallimin ndërmjet normave juridike alternative dhe dispozitive.

DETYRË:

1. Hartoni nga dy norma juridike që përmbajnë dispozitë urdhërore, ndaluese dhe autorizuese.
2. Hartoni një kod sjelljeje për nxënësit në klasën tuaj duke përdorur një sërë normash juridike

4. BURIMET E SË DREJTËS

4.1. NOCIONI I BURIMEVE TË SË DREJTËS

Me termin burim i së drejtës nënkuptohet krijuesi i ligjit, d.m.th. vendi nga ku merret e drejta.

4.2. LLOJET E BURIMEVE TË SË DREJTËS

Në teori, ekzistojnë dy burime të së drejtës, edhe atë burimet materiale dhe formale:

Burimet materiale të së drejtës janë faktorët dhe arsyet shoqërore që krijojnë të drejtën. Arsyeja e drejtpërdrejtë e shfaqjes së ligjit është nevoja për të rregulluar marrëdhëniet shoqërore ndërmjet njerëzve në shoqëri me interesa të njëjta ose të kundërta. Krijues themelor i ligjit është vullneti i bartësve të pushtetit, të cilët me ndihmën e shtetit dhe organeve të tij kanë fuqinë politike, morale dhe ekonomike të miratojnë rregulla juridike përmes të cilave shprehin vullnetin dhe mbrojnë interesat e tyre. Vullneti i mbajtësve të pushtetit është arsyeja imediate, d.m.th. burimi i krijimit të së drejtës.

Burimet formale të së drejtës janë format në të cilat shfaqet dhe shprehet e drejta, si shprehje e vullnetit të bartësve të pushtetit në vend. Lloji më i zakonshëm i burimeve formale të së drejtës janë aktet e përgjithshme juridike (kushtetuta, ligji) si mjete me të cilat shprehet burimi material i së drejtës.

Burimet materiale dhe formale të së drejtës janë të ndërlidhura. Burimet materiale shkaktojnë krijimin e së drejtës, e kjo krijohet përmes akteve të përgjithshme juridike, nga të cilat dalin aktet juridike individuale. Meqenëse aktet juridike individuale nuk do të ekzistonin pa aktet e përgjithshme juridike (sepse nuk kanë nga çfarë të burojnë), rrjedh se aktet juridike të përgjithshme janë burimi formal kryesor i ligjit. Burimet formale të ligjit janë të vlefshme pa marrë parasysh sa herë zbatohen (asnjëherë, një herë ose shumë herë), derisa të shfuqizohen.

Pa burimet e së drejtës nuk mund të imagjinohet as ligji dhe as ekzistenca e shtetit.

? PYETJE:

1. Çka nënkuptohet me termin burim i së drejtës?
2. Cilat burime të së drejtës ekzistojnë?
3. Shpjegoni burimet materiale dhe formale të së drejtës.

MBANI MEND !!!

- ✚ Rendi juridik është një rend i organizuar i marrëdhënieve shoqërore i rregulluar me një normë juridike.
- ✚ Elementet e rendit juridik janë normative dhe faktike.
- ✚ Elementin normativ e përbëjnë normat juridike dhe aktet juridike, ndërsa ai faktik mbulon veprimet materiale (trupore) njerëzore.
- ✚ Norma juridike është një rregull i shkruar i sjelljes i miratuar dhe sanksionuar nga shteti.
- ✚ Elemente të normës juridike janë hipoteza, dispozita dhe sanksioni.
- ✚ Hipoteza është pjesa e normës juridike e cila parashikon kushtet dhe rrethanat që duhet të plotësohen për të zbatuar dispozitën ose sanksionin.
- ✚ Dispozita është pjesa qendrore dhe më e rëndësishme e normës juridike e cila përmban rregullin e sjelljes.
- ✚ Sanksioni është pjesa e normës juridike e cila përcakton pasojat që do të ndodhnin për subjektin për shkak të shkeljes së normës juridike.
- ✚ Delikti nënkupton sjelljen e caktuar të kundërligjshme të një personi që cenon dispozitën e normës juridike.
- ✚ Norma juridike mund të jetë urdhërore, ndaluese, autorizuese, e përgjithshme, individuale, imperative, alternative dhe dispozitive.
- ✚ Burimi i së drejtës është krijuesi i së drejtës, gjegjësisht vendi nga është marrë e drejta.
- ✚ Llojet e burimeve të së drejtës janë: materiale dhe formale.

5. AKTI JURIDIK

5.1. NOCIONI DHE ELEMENTET E AKTIT JURIDIK

Akti juridik është pjesë e elementit normativ të rendit juridik. **Akti juridik është një mjet për krijimin dhe zbatimin e ligjit.**

Normat juridike janë të lidhura ngushtë dhe pandashëm me aktet juridike. Domethënë, ato e bëjnë përmbajtjen e aktit juridik. Pa akt juridik nuk mund të ketë normë juridike, sepse përmbajtja e normës juridike përcaktohet nga vetë akti juridik. Marrëdhënia e tyre korrespondon me marrëdhënien midis përmbajtjes dhe formës. Për shembull, nëse kemi një ligj për kujdesin shëndetësor si akt juridik, atëherë normat juridike që përmban ai do të jenë në fushën e kujdesit shëndetësor.

Elementet e aktit juridik mund të ndahen në formale dhe materiale.

Elementet formale janë: kompetenca (pra organi që miraton aktin), procedura e miratimit të aktit dhe forma e aktit juridik.

- **Kompetenca** si element formal tregon autorizimin me të cilin organi i caktuar ka të drejtë të miratojë akt juridik. Varësisht se cili subjekt apo organ e miraton aktin juridik, ekzistojnë akte të ndryshme juridike të miratuara nga kuvendi, qeveria, gjykatat, etj. Prandaj kompetencat e organeve shtetërore në rendin juridik gjithmonë duhet të përcaktohen paraprakisht me ligj. Aktet e miratuara nga organi jo-kompetent nuk do të kenë fuqi juridike, përkatësisht vlefshmëri.
- Çdo akt juridik miratohet në procedurë të paracaktuar të parashikuar për atë akt juridik. Kjo quhet **procedurë e sjelljes së aktit**. Kjo në praktikë do të thotë se autoriteti kompetent duhet të ndërmarrë të gjitha aktivitetet dhe veprimet e parapara për miratimin e aktit përkatës në procedurën përkatëse. Pasi që akti juridik nuk do të jetë i vlefshëm nëse nuk është miratuar nga organi kompetent, ai nuk do të jetë i vlefshëm edhe nëse nuk sillet me procedurë përkatëse, si p.sh. akti administrativ të jetë sjellë me procedurë administrative, akti gjyqësor me procedurë gjyqësore, etj.

- Kur flasim për **formën e aktit juridik** duhet të përmendim se çdo akt juridik ka pjesë të caktuara të qenësishme në atë akt juridik, si dhe formën se si duhet të duket ai akt juridik. Këto pjesë që përbëjnë aktin paraprakisht janë të parashkruara, kështu që krijuesi i aktit juridik, përkatësisht organi kompetent duhet t'u përmbahet atyre. Forma e aktit juridik është e përcaktuar me ligj dhe është kusht për vlefshmërinë e vetë aktit.

Elementet materiale kanë të bëjnë me përmbajtjen e aktit juridik dhe shfaqen si element kryesor dhe dytësor.

- **Elementi kryesor** i referohet normës juridike që përmban akti juridik, përmbajtja e së cilës varet nëse akti juridik krijon një situatë të re juridike, ndryshon apo shfuqizon situatën tashmë ekzistuese juridike.
- **Elementi dytësor** i referohet vetë emrit të aktit, i cili duhet të jetë i saktë, i qartë dhe preciz, për të përcaktuar vendin dhe rolin e aktit juridik në sistemin juridik. Për shembull, Ligji për Arsimin e Mesëm, Rregullorja për mënyrën dhe procedurën e regjistrimit të automjeteve, Marrëveshja për dhënien me qira të lokaleve afariste etj. Gjithashtu, akti juridik duhet të tregojë miratuesin e aktit juridik, bazën ligjore për miratimin e aktit, si dhe të ketë nënshkrimin dhe vulën e personit të autorizuar.




Fig. 9: Elementët e aktit juridik

5.2. LLOJET E AKTEVE JURIDIKE

Ekzistojnë disa kritere për ndarjen e akteve juridike:

Sipas normës juridike në akt, aktet juridike ndahen në:

- **Akte të përgjithshme juridike** - përmbajnë norma të përgjithshme juridike dhe paraqiten në formën e kushtetutës, ligjit dhe akteve nënligjore të përgjithshme juridike. Këto akte juridike si të përgjithshme u referohen të gjithë qytetarëve të një shteti dhe janë bazë për shfaqjen e akteve juridike individuale.
- **Akte individuale juridike** - përmbajnë norma juridike individuale. Ato nuk mund të miratohen nëse nuk bazohen në një akt të përgjithshëm juridik të miratuar më parë. Aktet individuale burojnë nga ato të përgjithshme dhe duhet të jenë në përputhje me to. Pra, një akt juridik individual nuk mund të miratohet nëse një sjellje e caktuar nuk është rregulluar më parë me një akt të përgjithshëm juridik, përkatësisht me një normë të përgjithshme juridike. Aktet juridike individuale zgjidhin një situatë specifike jetësore dhe i referohen gjithmonë një personi ose grupi personash të caktuar.

Marrëdhënia ndërmjet aktit juridik të përgjithshëm dhe atij individual mund të shpjegohet përmes shembullit të mëposhtëm:

- | |
|--|
| <ul style="list-style-type: none">▪ Ndalohet vrasja - është një normë e përgjithshme juridike e përfshirë në Kodin Penal si akt i përgjithshëm juridik. Kjo do të thotë se të gjithë qytetarët në vend janë të detyruar ta respektojnë, sepse është e përgjithshme dhe vlen për të gjithë. Kushdo që shkel normën juridike do të gjykohet dhe do të dënohet përmes aktit juridik individual. Aktgjykimi do të përmbajë një normë juridike individuale në të cilën kryesit të caktuar për veprën e caktuar do t'i jepet sanksion i caktuar. |
|--|

Sipas asaj se cili subjekt i sjell aktet juridike, ata ndahen në:

- Aktet e miratuara nga organet shtetërore, të cilat më së shpeshti paraqiten në formë të kushtetutës, ligjit, aktgjykimit, etj.

- Aktet e miratuara nga organizatat shoqërore, si statutet dhe vendimet.
- Aktet e miratuara nga personat privatë, të cilat në formën e tyre më së shpeshti shfaqen si marrëveshje, teste, testament, etj.

Sipas llojit të marrëdhënies shoqërore të cilën e rregullojnë, aktet juridike mund të jenë ekonomike, sociale, kulturore, etj.

? PYETJE:

1. Çka nënkuptohet me termin akt juridik?
2. Cilat janë elementet e një akti juridik?
3. Shpjegoni elementet formale të aktit juridik.
4. Shpjegoni marrëdhëniet ndërmjet normës juridike dhe aktit juridik.
5. Sipas normave që përmbajnë, çfarë lloje të akteve juridike ekzistojnë?
6. Cilat subjekte mund të miratojnë akte juridike?
7. Çfarë natyre mund të kenë marrëdhëniet shoqërore që rregullohen me akte juridike?




Fig. 10: Paraqitja skematike e renditjes hierarkike të akteve juridike

5.3. AKTET E PËRGJITHSHME JURIDIKE

Aktet e përgjithshme juridike, siç e kemi përmendur tashmë, përbajnë një normë të përgjithshme juridike dhe paraqiten në formën e kushtetutës, ligjit dhe akteve nënligjore. Ato janë baza nga e cila rrjedhin aktet juridike individuale dhe zakonisht janë burime formale të së drejtës. Aktet e përgjithshme juridike duhet të jenë të disponueshme për të gjithë qytetarët e një vendi, në mënyrë që ata të njihen me to dhe të jenë në gjendje t'i zbatojnë ato. Për këtë arsye aktet e përgjithshme juridike publikohen në të ashtuquajturat fletore publike siç është "Gazeta Zyrtare".

5.3.1. KUSHTETUTA

Ashtu siç marrim informacione për individin nga biografia, ashtu mund të marrim informacion për gjendjen e vendit nga kushtetuta e vendit. Përkatësisht, nga konstituimi i një shteti mund të shihet nëse dhe çfarë të drejtash dhe lirish kanë qytetarët e tij, si është e organizuar qeverisja në vend, cilat organe ekzistojnë dhe cilat janë kompetencat e tyre, cilat janë parimet në të cilat bazohet forma shoqërore, ekonomike, politike e rregullimit, etj.

Ndryshe nga ligjet, të cilat janë të shumta në vend, kushtetuta është një. Ai është akti i përgjithshëm juridik më i lartë dhe më i rëndësishëm. Kushtetuta është baza mbi të cilën vendosen themelet e shtetit dhe të së drejtës. Është një "ligj mbi ligjet", sepse rregullon çështjet më të rëndësishme në vend dhe të gjitha aktet e tjera ligjore dalin prej tij dhe duhet të jenë në përputhje me të. Pra, kushtetuta nuk i rregullon në mënyrë të detajuar të gjitha çështjet me rëndësi për një shtet, por vetëm ato themelore, dhe gjithçka tjetër rregullohet me ligj.

Kushtetuta zakonisht miratohet nga një organ legjislativ (kuvendi, parlamenti, kongresi), dhe ndonjëherë në disa vende formohet një asamble (organ) e posaçme kushtetuese për të miratuar kushtetutën e cila shpërndahet me miratimin e saj.

Në thelb, ekzistojnë disa lloje të kushtetutave. Sipas karakterit, kushtetuta mund të jetë: e shkruar, e cila shprehet në një dokument të shkruar;

kushtetutë e pashkruar, e njohur si kushtetutë zakonore; kushtetuta e fortë ose e ngurtë, e cila është e vështirë të ndryshohet; dhe një kushtetuta e butë ose e lehtë që ndryshon lehtësisht.

Ndonjëherë kushtetuta përmbahet në një dokument të shkruar, por ndonjëherë përmbajtja e kushtetutës mund të jepet në disa dokumente - deklarata, secila prej të cilave ka të njëjtën rëndësi si kushtetuta. I tillë është shembulli i Anglisë ku në zhvillimin historik u shfaqën disa deklarata me rregullore kushtetuese, si p.sh.:

- Magna Carta Libertatum
- Habeas Corpus Act
- Bill of Rights

Sa i përket strukturës së kushtetutës, megjithëse nuk është e detyrueshme, shumica e kushtetutave kanë një pjesë hyrëse që quhet preambulë. Preambula në thelb përmban qëllimin e kushtetutës dhe zhvillimin historik të vendit. Ai seksion është narrativ dhe nuk përmban nene. Ndryshe nga preambula, pjesa normative e kushtetutës përmban nene dhe është pjesë e domosdoshme për ekzistencën e kushtetutës (pa pjesën normative kushtetuta nuk mund të ekzistojë). Për ndryshimin, plotësimin dhe shfuqizimin e dispozitave kushtetuese ekzistuese, miratohen ndryshime kushtetuese. Ato janë pjesë përbërëse e kushtetutës⁶⁶. Sa dhe çfarë lloj ndryshimesh kushtetuese do të ketë një kushtetutë, varet nëse ajo është një kushtetutë e butë apo e ashpër.

? PYETJE:

1. Çfarë është kushtetuta?
2. Pse kushtetuta është e rëndësishme për një shtet?
3. Çfarë lloj kushtetutash ekzistojnë?

⁶⁶ Kushtetuta e Republikës së Maqedonisë së Veriut përmban një preambulë, një pjesë normative dhe amendamente kushtetuese.

5.3.2. LIGJI

Ligji është një akt juridik i përgjithshëm që vjen menjëherë pas kushtetutës në shkallën hierarkike të akteve juridike. Ligji shtjellon dispozitat kushtetuese dhe duhet të jetë në përputhje me kushtetutën. Përndryshe, nuk do të zbatohet. E miraton organi legjislativ i shtetit. Ligji mund të konsiderohet si ligj në kuptimin material dhe formal të fjalës.

Me ligj në **kuptimin material** të fjalës nënkuptohet çdo akt juridik që përmban një normë të përgjithshme juridike.

Me ligj në **kuptimin formal** të fjalës nënkuptohet çdo akt juridik i miratuar nga organi ligjvënës në procedurë legjislative dhe në formë të shkruar.

Ekzistojnë këto lloje të ligjeve:

Sipas llojit të marrëdhënieve shoqërore që i rregullojnë, ekzistojnë ligje në fushën e së drejtës penale (p.sh. Ligji i procedurës penale, Kodi penal), e drejta familjare (Ligji për familjen), e drejta trashëgimore (Ligji për trashëgiminë), e drejta civile (Ligji për detyrimet).

Sipas shumicës së nevojshme për miratim, ka ligje që sillen me:

- Shumicë relative
- Shumicë absolute
- shumicë të kualifikuar (ligjet e miratuara nga kjo shumicë quhen edhe ligje organike, sepse janë thelbësore për shtetin. Shembull, Ligji për stemën, flamurin dhe himnin, Ligji për gjykatat, Ligji për mbrojtjen etj.).

Sipas kohëzgjatjes së veprimit të ligjeve, ato mund të jenë:

- të përhershme, d.m.th. veprojnë dhe janë të vlefshme për një kohë të pacaktuar në të ardhmen, dhe kjo është shumica e ligjeve që miratohen;
- Ligjet latente janë ato që nuk zbatohen në baza ditore, por vetëm kur ndodhin rrethana të caktuara, pra në rrethana të veçanta. Ligji ekziston dhe është pjesë e së drejtës pozitive, por zbatohet vetëm në një situatë të caktuar (p.sh. Ligji për mbrojtjen dhe shpëtimin i cili zbatohet në kushte të katastrofave natyrore, etj.).

Procesi i sjelljes së ligjeve është kompleks, i përcaktuar në mënyrë strikte dhe në diskrecionin e çdo shteti, por në thelb zhvillohet në disa faza, përkatësisht: **Iniciativa për miratimin e një ligji, propozimi për miratimin e një ligji, debati për një projektligj, votimi, shpallja e një ligji (promulgacioni) dhe shpallja e ligjit dhe hyrja në fuqi e tij.**

Çdokush mund të iniciojë miratimin e një ligji – qytetari, institucionet, deputetët, etj., që varet nga sistemi politik i vendit. Projektligji mund të paraqitet nga subjekte të ndryshme (qeveria, deputetë, qytetarë, kreu i shtetit). Debati ose analiza e një projektligji mund të jetë e thjeshtë dhe komplekse. Si rregull, ligji shqyrtohet në organet dhe komisionet e organit ligjvënës, si dhe në seancën plenare të tij. Votimi i tekstit të ligjit mund të jetë i ndryshëm dhe me shumicë të ndryshme, në varësi të llojit të ligjit. Çdo ligj që miratohet duhet të konfirmohet nga kreu i shtetit, i cili mund ta konfirmojë me firmën e tij ose të përdorë të drejtën e vetos. Pas nënshkrimit të ligjit nga kreu i shtetit, ai botohet në gazetën zyrtare për ta vënë në dispozicion të qytetarëve në të gjithë vendin. Koha nga shpallja e ligjit deri në hyrjen në fuqi quhet *vacatio legis*. Pas kësaj periudhe ligji hyn në fuqi dhe qytetarët janë të detyruar të veprojnë sipas tij dhe askush nuk mund të justifikohet se nuk e ka ditur për ligjin.

? PYETJE:

1. Çfarë është ligji?
2. Si ndahen ligjet?
3. Renditni fazat e procedurës së sjelljes së ligjit.




Fig. 11: Skema e pjesëmarrësve në procedurën e sjelljes së ligjeve

5.3.3. AKTET E PËRGJITHSHME NËNLIGJORE JURIDIKE

Aktet nënligjore juridike miratohen nga organe, të cilat në hierarkinë e organeve shtetërore janë më të ulëta se organi legjislativ dhe për këtë arsye duhet të jenë në përputhje me ligjin, pra me Kushtetutën. Aktet e përgjithshme nënligjore juridike nuk mund të vendosin të drejta dhe detyrime të reja për qytetarët dhe personat juridikë, por vetëm specifikojnë dhe shtjellojnë më tej ligjet, përkatësisht ato miratohen në bazë të autorizimit të dhënë në ligj. Aktet nënligjore lidhen me normat e përgjithshme juridike që përmban ligji dhe nuk mund të krijojnë situata juridike të reja dhe të kundërta me ato në ligj.

Ekzistojnë llojet e mëposhtme të akteve nënligjore:

Dekreti është akti nënligjor më i rëndësishëm. Ai miratohet nga organet ekzekutive ose administrative në vend. Zakonisht miratohet në një seancë të Qeverisë. Ai i përpunon normat juridike.

Dallohen dy lloje dekretesh:

- **Dekreti për ekzekutimin e ligjit** që miratohet për qëllime të zbatimit të ligjit. Baza e miratimit të tij është një klauzolë (dispozitë) ekzekutive sipas së cilës ligjvënësi autorizon Qeverinë, ose e udhëzon në mënyrë eksplicite që të miratojë një dekret që do të rregullojë më nga afër një fushë të caktuar të marrëdhënieve të rreguluara me ligj. Ky dekret është i vlefshëm për aq kohë sa ekziston ligji (shembull, Dekreti për shpenzimet për udhëtime biznesi dhe emigracion jashtë shtetit).
- **Dekreti me fuqi ligjore** i rregullon marrëdhëniet që duhet të rregullohen me ligj. Ai miratohet në kushte lufte dhe gjendje të jashtëzakonshme dhe është i vlefshëm për aq kohë sa zgjat ajo gjendje.

Urdhri është akt nënligjor i miratuar nga ministritë. Ai i drejtohet një numri të pacaktuar njerëzish që janë në një situatë të caktuar. Urdhëron ose ndalon veprime të caktuara në një situatë të caktuar, dhe ka karakter përgjithësisht të detyrueshëm. (Për shembull, urdhri për heqjen e borës, evakuimin e popullsisë, orën policore, mobilizimin).

Rregullorja është akt i miratuar nga organet administrative me qëllim të zbatimit dhe përpunimit të dispozitave të caktuara të ligjit ose të rregullores tjetër të përgjithshme të Kuvendit dhe të Qeverisë. Ajo rregullon çështje të rëndësishme brenda kompetencës së organit. (P.sh. Rregullorja për mbajtjen, kohëzgjatjen dhe shpërndarjen e uniformës dhe shenjat në uniformën e policisë, Rregullorja për hapësirën e nevojshme, pajisjet dhe personelin profesional për themelimin, fillimin e punës dhe kryerjen e veprimtarisë shëndetësore në institucionet shëndetësore). Me rregullore mund të rregullohet edhe organizimi i brendshëm i punës së një organi apo shërbimi të caktuar.

Udhëzimi është akt i miratuar nga organet administrative. Ai ka fuqinë juridike më të ulët dhe nuk përmban norma të reja juridike, por vetëm zhvillon mënyrën e zbatimit të normave juridike të miratuara tashmë. (Për shembull, Udhëzimet për menaxhimin e sigurt të mbetjeve mjekësore).

Dekreti është akt i kreut të shtetit dhe zakonisht përdoret për shpalljen e ligjeve, emërimin e diplomatëve, dhënien e dekoratave etj.

Vendimi është akt nënligjor i përgjithshëm juridik që zakonisht miratohet në nivel të vetëqeverisjes lokale në komunë dhe rregullon çështje me rëndësi lokale. Ai miratohet nga Këshilli Komunal dhe duhet të jetë në përputhje me statutin e komunës. Pra, statuti i komunës, që është akti më i lartë dhe themelor i komunës, është një kushtetutë e vogël për komunën dhe vendimi është një lloj ligji në nivel lokal.

? PYETJE:

1. Cilat janë aktet e përgjithshme nënligjore juridike?
2. Numëroni aktet e përgjithshme nënligjore juridike.
3. Shpjegoni dekretin me fuqi ligjore.
4. Shpjegoni urdhrin.
5. Pse miratohen rregulloret?
6. Shpjegoni dekretin.
7. Me cilin akt juridik nga hierarkia e akteve juridike barazohet vendimi?

5.4. AKTET INDIVIDUALE JURIDIKE

Aktet juridike individuale përmbajnë norma juridike individuale. Ato rregullojnë dhe zgjidhin një situatë specifike. Baza e tyre janë aktet e përgjithshme juridike dhe me to konkretizohen aktet e përgjithshme juridike.

Sipas asaj se kush i miraton aktet juridike individuale, ato ndahen në:

- **akte individuale të miratuara nga organet shtetërore** (aktgjykim, vendim),
- **akte individuale të miratuara nga persona privatë** dhe shfaqen në formën e akteve juridike (testamentit, marrëveshjes).

Aktet individuale të miratuara nga organet shtetërore, varësisht nga ajo se cili organ shtetëror i miraton, ndahen në akte **administrative** dhe **akte gjyqësore**.

5.4.1. AKTI ADMINISTRATIV

Akti administrativ është akt individual administrativ i miratuar nga një organ administrativ, për shembull, ministritë, inspektoratet, drejtoritë dhe të tjerët, në një procedurë të përcaktuar posaçërisht. Veç organeve administrative, aktin administrativ mund ta miratojnë edhe institucionet publike që janë të autorizuara me ligj për miratimin e akteve administrative. Ndryshe nga proceset gjyqësore, procedurat administrative janë më të shpejta dhe më të thjeshta. Organet drejtuese veprojnë drejtpërdrejt. Kjo do të thotë se ato mund të miratojnë aktin administrativ pa pritur që dikush të kërkojë miratimin e tij.

Shembull:

Nëse dikush kalon në një rrugë ku është e ndaluar, punonjësi i policisë mund ta ndëshkojë në vendngjarje.

Shembull:

Drejtoria e të ardhurave publike mund të marrë vendim si akt individual administrativ me të cilin personi detyrohet të paguajë tatimin në një shumë të caktuar dhe ta sjellë atë pa e kërkuar dikush veprimin e tij.

Shembull:

Inspektori mund të kryejë inspektimin pa thirrur dikë, përkatësisht të kontrollojë nëse kompanitë, institucionet dhe qytetarët në kryerjen e veprimtarisë së tyre i respektojnë ligjet dhe rregulloret e tjera apo i shkelin ato dhe devijojnë nga funksionimi ligjor.

Nga kjo mund të konstatohet se marrëdhënia administrative ndodh me vullnet më të fortë të organit shtetëror vetëm nëse bëhet fjalë për përcaktimin e detyrimit të palës. Ka edhe raste kur autoritetet duhet të kundërshtohen për të miratuar një akt të caktuar administrativ. Kjo ndodh, para së gjithash, kur personi dëshiron të ushtrojë një të drejtë ose interes të caktuar dhe atëherë duhet të ketë një kërkesë prej tij.

Shembull:

Nëse një person dëshiron të marrë një leje për të mbajtur një armë ose për të ndërtuar, ai duhet të aplikojë për një vendim. E njëjta gjë vlen edhe në rastet kur kërkojmë pasaportë, letërnjoftim, bursë, hapje dyqani, ndihmë sociale, etj.

Aktet administrative zakonisht shfaqen në formën e vendimeve, për shembull, vendim për pension, për pagesën e taksës, për shtesë fëmijërore.

Pjesë të vendimit janë: hyrja, dispozitivi, sqarimi dhe udhëzimet për mjetin juridik (këshilla juridike). Por akti administrativ mund të shfaqet edhe në formën e një lejeje, siç është leja për të mbajtur armë zjarri. Akti administrativ mund të ndryshohet më lehtë, ndryshe nga akti gjyqësor.

Shembull:

Nëse personi nuk ka marrë leje për mbajtjen e armës, nuk përjashtohet mundësia e marrjes së saj në të ardhmen, nëse i plotëson kushtet e parashikuara me ligj.

Shembull:

Personi ka paraqitur kërkesë për marrjen e lejes (miratim) për ndërtimin e një objekti, por organi administrativ e ka refuzuar për mosplotësim të kushteve të parashikuara me ligj. Nëse pas një periudhe të caktuar ai i plotëson kushtet, mund të paraqesë sërish kërkesë dhe të marrë miratimin në fjalë.

Shembull i një akti administrativ:

Neni ____paragrafi ____LPPA	

Emri i selisë	
Numri _____	
Data _____	

(Emri i organit që merr vendimin)	
Me kërkesë të _____	
(Emri dhe mbiemri i palës)	

(Vendi, rruga dhe numri)	
Sipas nenit _____	
(Rregullore sipas së cilës vendos organi kompetent)	
sjell	
VENDIM	
MIRATOHET _____	

SQARIM	
_____ është parashtruar	
(Emri dhe mbiemri)	
Kërkesë me të cilën kërkohet _____	

(Përmbajtje e shkurtër e kërkesës)	
Kërkesa arsyetohet dhe pranohet në bazë të nenit _____	

(ligji në bazë të të cilit u la në fuqi kërkesa)	
KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankesë _____	
_____brenda 15 ditëve nga dita e marrjes së vendimit.	
(Organi të cilit i drejtohet)	
(V)	NËNSHKRIMI

5.4.2. AKTI GJYQËSOR

Aktet gjyqësore miratohen nga gjykatat, si për procedurën civile ashtu edhe për atë penale. Autoritetet gjyqësore veprojnë vetëm kur veprimi i tyre kundërshtohet, me padi në mosmarrëveshje civile ose me aktakuzë në procedurë penale. Pa një akt të tillë, gjykatat nuk mund të veprojnë me iniciativë edhe për krimet më të rënda. Shkeljet e rregullave dhe mosmarrëveshjet mes njerëzve kanë ekzistuar gjithmonë dhe do të ekzistojnë dhe gjykata është organi që vendos për drejtësinë në situata të tilla. Zbatimi i ligjeve nga gjykatat në një rast të caktuar nënkupton vendosjen e një ligji.



Aktet individuale të gjykatave miratohen në formë të aktgjykimit ose vendimit. Aktet gjyqësore synojnë zgjidhjen e një mosmarrëveshjeje të caktuar dhe vendosjen e disa marrëdhënieve normale, të cilat në një farë mënyre janë të trazuar. Vendimi si akt gjyqësor zakonisht zgjidh diçka që paraqitet si problem gjatë procedurës dhe me aktgjykim ndërpritet procedura dhe me të gjy-

kohet kontesti. Me **aktgjykim** vendoset se çfarë është objekti i procedurës. Kështu, për shembull, nëse objekti i procedurës është shkurorëzimi, aktgjykimi vendos se martesë nuk ekziston më. Pjesët e aktgjykimit janë: hyrja, dispozitivi, arsyetimi dhe këshilla juridike.

Procedura gjyqësore është më e ndërlikuar, më e ngadaltë dhe më e rreptë se ajo administrative. Akti gjyqësor karakterizohet me pandryshueshmëri, pra këtu zbatohet parimi i res judicata (send i gjykuar). Mirëpo, si përjashtim, në raste të caktuara, akti gjyqësor mund të ndryshohet, p.sh. me rastin e rinovimit të procedurës.

Në rast të pakënaqësisë me aktet e miratuara individuale, palët kanë të drejtën e mjetit të rregullt juridik – ANKESËS.

F.nr. ____/____

**NË EMËR TË QYTETARËVE TË
REPUBLIKËS SË MAQEDONISË SË VERIUT**

Gjykata Themelore në Manastir, në këshill të përbërë nga gjykatësi i kësaj gjykate _____, si kryetar i këshillit të gjykatësve të jurisë _____ dhe _____, si anëtarë të këshillit, pas punës juridike të XX nga Manastiri rr. _____ nr. _____, i cili përfaqësohet nga përfaqësuesi _____, avokat nga Manastiri kundër të pandehurit UU nga Manastiri i përfaqësuar nga _____ rr. _____ nr. _____ avokat nga Manastiri, për shkak të shkurorëzimit të lidhur më _____, pas shqyrtimit kryesor, të përfunduar në prani të paditësit personalisht dhe avokatit të tij _____, dhe të të pandehurës, personalisht, së bashku me avokatin e saj _____, e solli këtë

VENDIM

Martesa e lidhur mes paditësit XX dhe te paditurës UU, te dy nga Manastiri, më datë _____ në Manastir, e regjistruar në librin amzë në Manastir me nr _____ / SHKURORËZOHET, konform nenit _____ nga _____.

I mituri HU, i lindur në vitin _____ i jepet në përkujdesje dhe edukim nënës së tij UU nga Manastiri.

XX babai i të miturit HU është i detyruar që në emër të kontributit të tij për mbajtjen e të miturit HU, nëpërmjet përfaqësuesit të tij ligjor, t'i paguajë HU një shumë prej _____ denarë në muaj, duke filluar nga viti _____ derisa i mituri të jetë në gjendje të vetë-mbahet.

Paditësi është i obliguar që shumën e mbështetjes prej _____ t'ia japë përfaqësuesit ligjor të HU-së jo më vonë se në ditën e tretë të muajit.

Paditësi është i detyruar t'i sigurojë të paditurit një shumë prej _____ denarë duke filluar nga viti _____, jo më vonë se në ditën e tretë të muajit.

SQARIM

Në bazë të një ekstrakti nga libri amzë i të martuarve, Manastir, është konstatuar se paditësi XX dhe i padituri UU, të dy nga Manastiri, më _____ kanë lidhur martesën me nr _____.

Paditësi kërkon divorcin sepse gjatë martesës ka pasur dallime të mëdha në perceptime, të cilat kanë ardhur nga mosmarrëveshjet mes personaliteteve të tyre që kanë sjellë mosmarrëveshje të përhershme dhe intolerancë reciproke,

me çka jeta e përbashkët e paditësit dhe paditëses është bërë e padurueshme, për shkak të së cilës praktikisht ka pushuar së funksionuari bashkësia martesore dhe nuk ka kushte për rinovim.

Pas provave të paraqitura, duke dëgjuar palët dhe dëshmitarët _____ dhe _____ në mënyrë të pakontestueshme është vërtetuar se marrëdhëniet martesore ndërmjet bashkëshortëve janë të prishura përgjithmonë, për shkak të së cilës bashkësia martesore e tyre nuk ekziston në fakt prej më shumë se _____ muajsh, për të cilën është lëshuar vendimi për shkurorëzim.

E paditura është e detyruar t'ia paguajë të paditurit shpenzimet kontestimore paditësit brenda _____ ditëve nga dita e dorëzimit të këtij aktgjykimi.

Gjykata themelore Manastir

.....

Kryetari i Gjykatës

Këshilla ligjore: Kundër këtij aktgjykimi lejohet ankesë në Gjykatën e Apelit Manastir, përmes kësaj gjykate në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimit të vendimit.

? PYETJE:

1. Çka nënkuptohet me akt juridik individual?
2. Cilat lloje të akteve juridike individuale ekzistojnë?
3. Shpjegoni aktin administrativ dhe gjyqësor.
4. Cila procedurë është më e ndërlikuar, administrative apo gjyqësore? Pse?
5. Numëroni aktet gjyqësore.

5.4.3. VEPRAT JURIDIKE

Shprehja vepër juridike nënkupton deklaratën e vullnetit të një ose më shumë subjekteve të së drejtës që synon shfaqjen, ndryshimin ose përfundimin e një marrëdhënieje juridike.

Një faktor kyç në krijimin e veprave juridike është deklarata e vullnetit, e cila mund të shprehet në mënyrë eksplicite, me veprime përfundimtare dhe heshtje. Çdo vepër juridike është e përbërë nga pjesë të veçanta, të ashtuquajturat elementet e veprës juridike. Sipas rëndësisë së elementeve, ekzistojnë elementë të rëndësishëm pa të cilët nuk do të ekzistonte vepra juridike, elemente natyrore që janë të pashmangshme në kryerjen e veprës penale dhe elemente të rastësishme që vlejnë vetëm nëse palët i kanë parashikuar shprehimisht.

Sa i përket numrit të vullneteve të deklaruara, gjegjësisht numrit të palëve pjesëmarrëse në krijimin e veprës, veprat juridike mund të jenë:

- **Vepra të njëanshme juridike** janë ato për shfaqjen e të cilave mjafton deklarata e vullnetit të njërës palë. Një shembull për këtë është testamenti.
- **Vepra të dyanshme juridike** janë akte juridike për shfaqjen e të cilave është e nevojshme të ketë dy vullnete të shprehura për ushtrimin e të drejtave dhe detyrimeve. Një shembull është kontrata e shitblerjes.
- **Vepra të shumanshme juridike** ndodhin me pëlqimin e disa palëve.

Varësisht nga natyra e detyrimeve, gjegjësisht nëse ka reciprocitet të detyrimeve që përmban akti juridik, aktet juridike mund të jenë:

- **Ngarkuese ose dyanshëm obligative** janë ato kur të dyja palët kanë të drejtë dhe detyrim, pra e drejta e njërit lidhet me detyrimin e tjetrit. Atyre u jepet kompensim adekuat për atë që marrin. Për shembull, kontrata e shitblerjes është një vepër tipike ngarkuese nga e cila lindin të drejta dhe detyrime ekuivalente për të dyja palët. Shitësi është i detyruar të dorëzojë sendin dhe ka të drejtë të kërkojë çmimin.

Nga ana tjetër, blerësi është i detyruar të paguajë çmimin, dhe ka të drejtë të kërkojë që sendi i blerë t'i dorëzohet.

- **Dhuruese ose njëanshëm obligative** - Karakteristikë e dhuratave është se nuk jepet kompensim për atë që merret. Njëra palë ka vetëm të drejtë dhe tjetra vetëm detyrim. Një shembull i këtyre veprave është marrëveshja e dhuratës.

Sipas fillimit kohor të veprimit juridik, veprat juridike mund të jenë:

- **Vepra juridike në mes të të gjallëve** janë vepra juridike që kanë fuqi sa janë gjallë palët. Një shembull i kësaj është një marrëveshje.
- **Vepra juridike pas vdekjes** janë ato vepra juridike që kanë efekt juridik pas vdekjes së palës p.sh testamenti.



Si shembull do ta konsiderojmë MARRËVESHJEN si një lloj vepre juridike. Secili prej jush e ka përdorur fjalën marrëveshje në jetën e përditshme. Edhe pse ndoshta në mënyrë të pavetëdijshme, blerja e një artikulli në tregun vendas është lidhja dhe realizimi i një kontrate të personave të përfshirë në këtë marrëdhënie.

Në këtë rast, janë dy palët në kontratë, personi që punon në treg (shitësi) dhe personi që blen produktin nga tregu (blerësi). Në këtë transaksion shitësi është i gatshëm të shesë dhe të lëshojë produktin të cilin blerësi është i gatshëm ta paguajë dhe ta marrë në mënyrë që të plotësojë nevojën e tij specifike. Në çdo kontratë ka dy ose më shumë palë për të cilat lindin të drejta dhe detyrime të caktuara. Në këtë rast, të dy palët në kontratë, si shitësi ashtu edhe blerësi, kanë të drejta, por edhe përmbushin detyrimet. Shitësi ka të drejtë të marrë para, por detyrim për të dhënë produktin e duhur, ndërsa blerësi ka të drejtë të blejë produktin dhe të fitojë pronësinë, por edhe detyrimin për të paguar shitësin.

Shembull kontrate:

KONTRATË PËR SHITBLERJE PRONE TË PALUAJTSHME - BANESË

E lidhur më _____ në Shkup ndërmjet

1. _____ Shkup, rruga _____ me nr. amze _____
me letërnjoftim nr. _____ lëshuar nga _____

nga njëra anë si shitës

2. _____ Shkup, rruga _____ me nr. amze _____
me letërnjoftim nr. _____ lëshuar nga _____

nga ana tjetër si blerës

Neni 1

Shitësi është pronar i pronës së paluajtshme - një apartament me sipërfaqe prej _____ m² në Shkup _____ në rrugën _____.

Neni 2

Shitësi e shet patundshmërinë e përshkruar në nenin e mëparshëm me çmim të përgjithshëm prej _____ denarë, i cili çmim do të dorëzohet në ditën e noterizimit të kontratës para noterit kompetent kur banesa do të dorëzohet në posedim nga shitësi te blerësi.

Neni 3

Taksa e shitjes paguhet nga shitësi, dhe kostot e kontratës përballohen nga kontraktorët, në gjysmë.

Neni 4

Shitësi i përgjigjet blerësit për mangësitë ligjore dhe është i detyruar të paraqitet në mbrojtjen e tij (mbrojtja nga dëbimi), dhe thirrjen e tij, nëse një i tretë pretendon të drejtën e sendit dhe të mbajë pasojat juridike në rast se sendi i hiqet blerësit ose i kufizohet ose pakësohet e drejta e tij.

Neni 5

Në rast të kontestit nga kjo marrëveshje, kompetente është Gjykata Themelore Shkup 2 – Shkup.

Neni 6

Kontrata është bërë në gjashtë (6) kopje identike.

PALËT KONTRAKTUESE

Shitësi

Blerësi

? PYETJE:

1. Çfarë është vepra juridike?
2. Cili është faktori kyç në krijimin e një vepre juridike?
3. Në çfarë mënyrash mund të shprehet vullneti?
4. Cilat lloje të akteve juridike ekzistojnë?

DETYRË:⁶⁷

Merrni parasysh situatat e mëposhtme dhe vendosni nëse është arritur një marrëveshje në secilën prej tyre dhe shpjegoni pozicionin tuaj.

Drejtuesi i ankandit pyet: "Sa marr për këtë divan antik?" Dikush nga audienca përgjigjet: "30.000 denarë!"

Radica i thotë Nadicës: "Dëshiroj ta shes biçikletën për 10 mijë denarë". Nadica përgjigjet: "Në rregull, ja ku i ke paratë. "Do ta blej."
--

Duke qëndruar në një skaj të një ure të gjatë, Ivana i thotë Pjetrit: "Nëse kalon urën, do të të jap 500 denarë". Pjetri nuk thotë asgjë, por fillon të kalojë urën.
--

⁶⁷ „Учиме право“, 2006, Фондација Институт отворено општество – Македонија.

MBANI MEND !!!

- ✚ Akti juridik është një mjet për krijimin dhe zbatimin e ligjit.
- ✚ Elementet e aktit juridik mund të ndahen në formale dhe materiale. Elementet formale janë: kompetenca (d.m.th. organi që e miraton aktin), procedura e miratimit të aktit dhe forma në të cilën është miratuar akti.
- ✚ Elementet materiale i referohen përmbajtjes së aktit juridik dhe shfaqen si element kryesor dhe dytësor.
- ✚ Sipas normës juridike në akt, aktet juridike ndahen në akte juridike të përgjithshme dhe individuale.
- ✚ Aktet e përgjithshme juridike përmbajnë norma të përgjithshme juridike dhe zbatohen për të gjithë qytetarët e një vendi.
- ✚ Aktet e përgjithshme juridike janë kushtetuta, ligjet dhe aktet nënligjore.
- ✚ Aktet e përgjithshme nënligjore janë dekreti, urdhri, rregullorja, udhëzimi, dhe vendimi.
- ✚ Aktet juridike individuale përmbajnë një normë juridike individuale dhe zgjidhin situata specifike jetësore.
- ✚ Aktet juridike individuale ndahen në: akte individuale të miratuara nga organet shtetërore dhe akte individuale të miratuara nga persona privatë.
- ✚ Aktin administrativ e nxjerrin organet administrative në procedurë administrative dhe zakonisht paraqitet në formë vendimi, lejeje, etj.
- ✚ Akti gjyqësor sillet nga gjykatat në procedurë gjyqësore dhe zakonisht shfaqet në formë të aktgjykimit dhe vendimit.
- ✚ Me termin vepër juridike nënkuptohet deklarata e vullnetit të një ose më shumë subjekteve të së drejtës që synon hartimin, ndryshimin ose përfundimin e një marrëdhënieje juridike.
- ✚ Lloji më i zakonshëm i veprës juridike është kontrata.

V. MARRËDHËNIA JURIDIKE

Pas leximit të kësaj pjese, duhet të jeni në gjendje: të përkufizoni termin marrëdhënie juridike, të dalloni marrëdhënien juridike nga ajo shoqërore, të identifikoni elementet e marrëdhënies juridike, të shpjegoni autoritetin juridik (ligjin) dhe detyrimin juridik (detyrimin), të dalloni termat e drejtë subjektive dhe e drejtë objektive, të shpjegoni dhe të klasifikoni objektet e së drejtës, të analizoni marrëdhëniet juridike, të klasifikoni faktet juridike, të përkufizoni termin subjekt i së drejtës, të dalloni llojet e subjekteve të së drejtës, të shpjegoni aftësinë juridike, afariste dhe deliktore, të shpjegoni kushtet për fitimin dhe humbjen e aftësisë juridike, afariste dhe deliktore të personit fizik dhe juridik, të përkufizoni termin përfaqësim, të dalloni llojet e përfaqësimit.

1. NOCIONI DHE ELEMENTET E MARRËDHËNIES JURIDIKE

1.1. NOCIONI I MARRËDHËNIES JURIDIKE

E gjithë jeta shoqërore nuk mund të imagjinohej pa marrëdhënie të ndërsjella midis njerëzve. Çdo ditë, si individë ose të organizuar në grupe në kërkim të ekzistencës dhe socializimit të tyre në shoqëri, njerëzit hyjnë në marrëdhënie të ndryshme ekonomike, pune, familjare, miqësore e të tjera.

Të gjitha këto marrëdhënie rregullohen me rregulla të caktuara dhe quhen marrëdhënie shoqërore. Por siç e kemi theksuar edhe në temat e mëparshme, të gjitha marrëdhëniet ndërmjet njerëzve nuk janë të rregulluara nga shteti me norma juridike dhe nuk garantojnë zbatimin e tyre. Kjo është plotësisht e justifikuar duke pasur parasysh se shteti si institucion i fuqishëm nuk është i interesuar që të gjitha marrëdhëniet shoqërore t'i rregullojë me një normë juridike. Nëse shteti ndërhyr në të gjitha sferat e jetës shoqërore, p.sh. në atë se çfarë besojmë, si vishemi, me kë shoqërohemi, çfarë opsioni politik do të zgjedhim, atëherë do të ndodhte kaos në shoqëri.

Madje është shumë keq që shteti të përfshihet në këto sfera të jetës shoqërore, sepse kjo mënyrë e rregullimit të marrëdhënieve do të ishte shkatërruese për zhvillimin e shtetit, dhe marrëdhëniet e tjera, p.sh., marrëdhëniet intime nuk mund të jenë subjekt i rregullimit juridik.

Ajo që është e rëndësishme në marrëdhënie të tilla është që shteti duhet të jetë gjithmonë këtu me normat e tij për të ofruar kushte dhe mënyrë për realizimin e interesave të qytetarëve në ato sfera të komunitetit të ndërsjellë dhe jo përmes tyre të imponojë mënyrën se si duhet të realizohen ato interesa.

Shembull:

- Shteti ka të drejtë të miratojë një ligj për bashkësitë fetare dhe grupet fetare, i cili u tregon qytetarëve se si mund ta ushtrojnë të drejtën e tyre për të besuar, për të zgjedhur fenë, etj. Ligji i miratuar nga shteti nuk synon të vendosë një rregull që do të na tregojë se në çfarë të besojmë ose që duhet t'i përkasim një komuniteti fetar

Nga e gjithë kjo mund të konstatojmë se marrëdhënia juridike është marrëdhënie shoqërore e rregulluar me normë juridike.

Marrëdhënia juridike praktikisht mundëson funksionimin e rendit juridik, pra mundëson realizimin e elementit normativ nga subjektet e së drejtës. Gjegjësisht, subjektet e së drejtës, si pjesë e elementit faktik të rendit juridik, përmes sjelljes së tyre të përditshme dhe ndërmarrjes së veprimeve konkrete, i realizojnë normat juridike që përmbajnë aktet juridike.

? PYETJE:

1. Çfarë është marrëdhënia shoqërore?
2. Çfarë është marrëdhënia juridike?

1.2. ELEMENTET E MARRËDHËNIES JURIDIKE

Që të ekzistojë një marrëdhënie juridike, duhet të jenë të paktën dy palë ndërmjet të cilave do të zhvillohet ajo marrëdhënie. Të drejtat dhe detyrimet burojnë nga marrëdhënia juridike dhe bartës të tyre janë njerëzit. Pa persona si palë në marrëdhënien juridike, ajo nuk mund të arrihet si e tillë. Ata paraqiten si subjekte të së drejtës dhe si bartës të të drejtave dhe detyrimeve që rrjedhin nga marrëdhënia juridike. Të drejtat dhe detyrimet jepen gjithmonë në lidhje me një send të caktuar për të cilin është krijuar marrëdhënia juridike.

Mund të konkludojmë se marrëdhënia juridike përbëhet nga katër elemente:

- Autorizimi juridik (e drejta)
- Detyrimi juridik (detyrimi)
- Objekti, dhe
- Subjekti i së drejtës

1.2.1 AUTORIZIMI JURIDIK (E DREJTA)

Autorizimi juridik është një mundësi për sjellje të caktuar të subjektit të së drejtës në raport me një subjekt tjetër, e bazuar në rregulla juridike, në bazë të të cilave subjekti i autorizimit juridik mund të kërkojë diçka nga dikush.

Është e drejtë e subjektit që të mund t'i kërkojë dikujt t'i japë diçka, të bëjë diçka në interes të tij ose të durojë.

Shembull:

- | |
|--|
| <ul style="list-style-type: none">▪ Në marrëveshjen e shitblerjes, blerësi ka të drejtë të kërkojë që sendi i blerë t'i dorëzohet.▪ Në marrëveshjen e shitblerjes, shitësi ka të drejtë të kërkojë pagesën e çmimit, pra të arkëtojë sendin e blerë.▪ Qiramarrësi që ka marrë një apartament me qira, ka të drejtë t'i kërkojë pronarit të banesës që të përmbahet nga ardhja në banesë dhe të mos ndërhyjë në përdorimin e banesës. |
|--|

Subjekti i së drejtës në çdo kohë mund të heqë dorë nga ajo që kërkon dhe në të njëjtën kohë nuk mbarat asnjë pasojë. Gjegjësisht, subjekti që është titullar i së drejtës mundet, por nuk është patjetër, të kërkojë ushtrimin e së drejtës së tij.

Subjekti që është titullar i autorizimit ligjor në rast se nuk mund të ushtrojë të drejtën e tij, dhe jo për fajin e tij, mund të bëjë padi ose ankesë dhe në këtë mënyrë të kërkojë mbrojtje nga shteti, i cili në fakt garanton realizimin e marrëdhënieve juridike.

Për shembull:

- Nëse blerësi nuk i ka paguar shitësit çmimin e rënë dakord, shitësi ka të drejtë të ngrejë padi për realizimin e kësaj të drejte të tijen.

E drejta subjektive është një lloj autoriteti juridik që konsiston në aftësinë e subjekteve të së drejtës për të mbrojtur të drejtat dhe interesat e tyre në përputhje me normat juridike ekzistuese (e drejta objektive) në një vend.

Shembuj:

- E drejta për mbrojtje nga shpifja.
- E drejta për mbrojtje të pronës nga vjedhja

Një nga ndarjet më të rëndësishme të të drejtave subjektive është në të drejta absolute (reale) dhe relative (detyrimore).

Të drejtat subjektive absolute janë ato që vlejnë për të gjitha subjektet (erga omnes). Kjo do të thotë se të gjitha subjektet e tjera kanë detyrimin për të respektuar të drejtën e një personi të caktuar.

Shembuj:

- E drejta absolute është e drejta për të pasur një send, shtëpi, makinë, biçikletë, etj. Pronësia që ka subjekti mbi njërën prej këtyre gjërave i jep të drejtën ta shesë, ta japë me qira, ta përdorë ose ta dhurojë dhe njëkohësisht nuk duhet të shqetësohet dhe pengohet nga askush.

Të drejtat relative zbatohen vetëm për një numër personash të njohur paraprakisht (inter partes).

Shembuj:

- Subjekti i së drejtës (shitësi) kur shet një kompjuter ka të drejtë t'i kërkojë blerësit t'i paguajë shumën e parave të rënë dakord.

1.2.2. DETYRIMI JURIDIK (DETYRIMI)

Detyrimi ligjor është detyrimi me të cilin një person juridik detyrohet me dispozita ligjore t'i japë diçka tjetrit, të pësojë ose të veprjë në interes të një personi tjetër juridik.

Subjekti i detyrimit detyrohet ta përmbushë detyrimin e tij duke vepruar (veprim aktiv), gjegjësisht të japë diçka, ose të bëjë diçka në interes të një personi tjetër juridik, ose të përmbahet nga veprimet e caktuara (veprimi pasiv).

Shembuj të veprimit aktiv:

- Në marrëveshjen e shitblerjes, blerësi është i detyruar të paguajë çmimin e sendit të blerë.
- Në marrëveshjen e shitblerjes, shitësi detyrohet ta dorëzojë sendin e blerë.
- Detyrim i bojaxhiut është lyerja e banesës.
- Është përgjegjësi e mekanikut të riparojë makinën.

Shembuj të veprimit pasiv:

- Pronari i banesës së dhënë me qira duhet të përmbahet nga ardhja në banesë për kohën që e ka dhënë me qira dhe të mos e pengojë atë që e ka marrë banesën për qëndrim të përkohshëm.

Ndryshe nga titullari i autorizimit ligjor, i cili mund por nuk është i detyruar të ushtrojë të drejtën e tij, realizimi i detyrimit nuk varet nga vullneti i titullarit të tij. Ai duhet të përmbushë detyrimin ligjor, pra detyrimin deri në fund dhe në tërësi ose, në të kundërt, pason sanksioni. Me fjalë të tjera, në ligj nuk ka pandëshkueshmëri për heqjen dorë nga detyrimet e bazuara në ligj.

Autoriteti juridik (e drejta) dhe detyrimi juridik (detyrimi) nuk mund të paramendohen pa njëri-tjetrin. Më shpesh, ato janë aq të lidhur ngushtë, sa që i vendosin subjektet e tyre në një situatë që të jenë mbajtës të të drejtave dhe detyrimeve në të njëjtën kohë. Një shembull i një situate të tillë është kontrata e shitblerjes, ku të dyja palët kanë të drejta dhe detyrime. Shitësi është i detyruar të dorëzojë sendin, dhe ka të drejtë të arkëtojë çmimin, ndërsa blerësi është i detyruar të paguajë çmimin, dhe ka të drejtë të kërkojë që sendi i blerë t'i dorëzohet.

Shtrohet pyetja nëse të drejtat, përkatësisht detyrimet, në vend të titullarit të tyre, mund t'i përmbushë një person tjetër. Praktikisht, a janë të transferueshme këto të drejta dhe detyrime?

Të drejtat dhe detyrimet që kanë karakter pasuror, gjegjësisht nuk kanë lidhje me personalitetin e subjektit, mund t'u kalohen personave të tjerë.

Shembull:

- Detyrimi për të paguar një borxh të caktuar, ose e drejta e pronësisë mund t'i kalojnë dikujt tjetër.

Të drejtat dhe detyrimet që janë të lidhura fort me tiparet personale të subjektit nuk janë të transferueshme.

Shembull:

- E drejta e votës nuk mund t'i bartet një tjetri, sepse askush nuk mund të votojë në emrin tonë.
- Nëse ne kemi porositur një artist të njohur të bëjë një pikturë, nëse artisti pengohet ose vdes, ky detyrim nuk u kalon trashëgimtarëve të tij.
- Kemi blerë një biletë për një koncert të një ylli të njohur të muzikës, por në rast se ai/ajo nuk mund ta mbajë koncertin, detyrimin nuk mund ta përmbushë dikush tjetër.

1.2.3. OBJEKTI I MARRËDHËNIES JURIDIKE

Objekt i së drejtës është gjësendi, veprimtaria njerëzore (puna, aktiviteti) ose pasiviteti, cilësia dhe vetia, mbi të cilat bazohet marrëdhënia juridike.

Në shkencë ekzistojnë ndarje të ndryshme të lëndës (objektit) të marrëdhënies juridike.

Ne do ta pranojmë ndarjen në pesë grupet e mëposhtme:

- Objekte fizike
- Aktivitet njerëzor
- Pasivitet njerëzor
- Virtyti njerëzor
- Veti specifike subjektive njerëzore.

Objektet fizike

Sendet fizike janë objekti më i zakonshëm i marrëdhënies juridike. Ato janë pjesë e natyrës materiale që është nën kontrollin e njeriut. Këtu përfshihen sendet që njeriu i merr nga natyra (mineralet, energjia, frutat për të ushqyerit e tij), por edhe sendet që ai personalisht i formëson dhe u jep vlerë të gjerë përdorimi (mallrat e konsumit).

Secili shtet në të drejtën kombëtare ka parashikuar se cilat raste mund t'u nënshtrohen marrëdhënieve juridike dhe për cilat raste nuk mund të vendoset një marrëdhënie juridike sepse ato janë në pronësi të shtetit.

Shembuj:

- kontratë për shitblerje të shtëpisë - objekt është shtëpia;
- kontratë për shitblerje të truallit - objekt është trualli;
- kontratë për shitblerje të veturës - objekt është vetura;
- kontratë për shitblerje të kompjuterit - objekt është kompjuteri;
- shitblerja e bukës - objekt është buka;
- shitblerja e mollëve - objekt janë mollët.

Aktiviteti njerëzor

Subjekt i marrëdhënies juridike është një veprim që duhet kuptuar si një veprimtari njerëzore që njëra palë e kërkon dhe pala tjetër e marrëdhënies juridike e jep për një kompensim të caktuar.

Shembuj:

- kontrata për ndërtimin e shtëpisë - objekt është ndërtimi i shtëpisë;
- qepja e një kostumi - objekti është qepja;
- riparimi i veturës - objekti është riparimi;
- prodhimi i lëngjeve – objekti është prodhimi.

Pasiviteti njerëzor

Pasiviteti njerëzor si objekt insiston që subjekti i së drejtës të heqë dorë nga një veprim i caktuar, ose të përmbahet nga kryerja e një veprimi të caktuar që ai do ta bënte normalisht.

Shembull:

- Dy fqinjë pajtohen që njëri duhet të përdorë rrugën nëpër oborr të tjetrit derisa të bëhet rruga në mënyrë që fqinji të mund t'i afrohet lirisht shtëpisë së tij.

Virtyti njerëzor

Virtyti njerëzor si objekt i marrëdhënieve juridike është një përfitim i jetesës moderne. Njeriu nuk mund të jetë objekt i marrëdhënies juridike, por disa nga cilësitë, vertytet (vlerat) e tij si liria, dinjiteti, nderi, integriteti fizik, reputacioni, mund të jenë objekt i marrëdhënies juridike.

Shembuj:

- Pretendimi i shumave enorme të dëmshpërblimit për dëmtimin e nderit dhe reputacionit të individëve në jetën publike dhe artistike (politikanë, artistë, etj.).
- Sipas Ligjit për Detyrimet, personi ka të drejtë të kërkojë kompensim në të holla për dhimbjen fizike të pësuar, për dhimbjen mendore të pësuar për shkak të zvogëlimit të aktivitetit jetësor, turpit, cenimit të reputacionit, nderit, lirisë ose të drejtave të personit, si dhe për frikën e pësuar.

Vetitë specifike subjektive njerëzore

Objekti i marrëdhënies juridike janë aftësitë intelektuale dhe krijuese të njeriut, të mbrojtura nga e drejta e autorit, e drejta e patentuar dhe e licencuar.

Në këtë kuptim, mbrohen cilësitë individuale dhe intelektuale të individëve të shfaqura në piktura, vepra shkencore, vepra letrare, vepra muzikore, shpikje dhe vepra të tjera përkatëse. Këto vepra mund t'i posedojnë krijuesit e tyre, gjegjësisht t'i japin kundrejt një tarife të përshtatshme.

Shembuj:

- çdo autor, krijues i diçkaje të re, ka të drejtën e mbrojtjes së punës së tij mendore.
- është e drejtë morale që emri i autorit të shfaqet gjithmonë në një libër ose një vepër tjetër artistike.

1.2.4. SUBJEKTI I MARRËDHËNIES JURIDIKE

Subjektet e së drejtës janë pjesëmarrës të detyrueshëm në marrëdhëniet juridike.

Subjekt i së drejtës është një person (fizik) dhe një person juridik, të cilët janë të autorizuar ligjërisht të jenë bartës të autorizimeve ligjore dhe detyrimeve ligjore.

Nga vetë përkufizimi rezulton se subjektet e së drejtës janë të mishëruara në dy lloje subjektesh, përkatësisht në person fizik dhe juridik.




Fig. 12: Paraqitja skematike e elementeve të marrëdhënies juridike

? PYETJE:

1. Çfarë është marrëdhënia juridike?
2. Numëroni elementet e marrëdhënies juridike.
3. Çfarë është autorizimi ligjor?
4. Çfarë është detyrimi ligjor?
5. Çfarë është e drejta subjektive?
6. Çfarë është e drejta objektive?
7. Shpjegoni dallimin midis të drejtës absolute dhe relative subjektive.
8. Numëroni objektet e marrëdhënies juridike.
9. Cili është ndryshimi midis aktivitetit dhe pasivitetit njerëzor?
10. Çfarë nënkupton virtyti njerëzor?
11. A mund të jetë një kompakt disk (CD) muzikor lëndë e marrëdhënies juridike?

DETYRË:

1. Analizoni elementet e marrëdhënies juridike në shembujt e mëposhtëm:

PERSONI A.A. KA LIDHUR KONTRATË ME FIRMËN E NDËRTIMIT "HU" PËR SHITJE TË BANESËS.

PERSONI B.B. KA LIDHUR KONTRATË ME FIRMËN E TRANSPORTIT "XX" PËR BARTJEN E MATERIALEVE TË TIJ DERI NË MANASTIR.

PERSONI M.M. ËSHTË MARRË VESH ME KUSHËRIRIN E TIJ F.F. TË VIJË DY HERË NË JAVË PËR T'IA MIRËMBAJTUR BANESËN, PËR TË LARË E HEKUROSUR DHE PËR T'I GATUAR.

GAZETARI H.U. KA NXJERRË NË GAZETËN E TIJ TË PAVËRTETA NË LIDHJE ME NJË FUNKSIONAR TË LARTË TË SHTETIT.

PEROSNI D.D. KA SHKUAR NË ORDINANCËN STOMATOLOGJIKE "XY" PËR NJË INTERVENIM STOMATOLOGJIK.

2. FAKTET LIGJORE

2.1. NOCIONI I FAKTEVE LIGJORE

Faktet ligjore përfshijnë situata të tilla në jetën e njerëzve nën veprimet e menjëhershme të të cilave krijon marrëdhënie të reja juridike, ose ndryshojnë ose hiqen marrëdhëniet juridike ekzistuese.

Faktet ligjore konsiderohen të jenë një arsye themelore që ndikon në një marrëdhënie juridike që nuk ka ekzistuar, ose të shfuqizojë ose të ndryshojë marrëdhëniet juridike që kanë ekzistuar deri atëherë.

2.2. LLOJET E FAKTEVE LIGJORE

Faktet ligjore mund të ndahen në mënyrën e mëposhtme:

Faktet ligjore që varen nga vullneti i ligjvënësit, por nuk varen nga vullneti i subjektit, sjellja e të cilit rregullohet. (Shembull, ligjvënësi mund të miratojë ligje të reja për të krijuar marrëdhënie të reja ligjore ose për të ndryshuar dhe shfuqizuar ato ekzistuese.)

Fakte ligjore që varen nga vullneti i subjekteve të ligjit dhe janë në përputhje me normat e rendit juridik.

Shfaqja, ndryshimi dhe ndërprerja e marrëdhënieve juridike varen nga vullneti i personit juridik dhe bazohen në ligj. (Shembull, nëse personi dëshiron të blejë një apartament, të lidhë një marrëveshje për shitblerjen e një apartamenti, me çka manifestohet vullneti personal i subjektit, i cili me vetëdije, merr pjesë në krijimin e një marrëdhënieje juridike duke ushtruar të drejtën e pronës.)

Faktet ligjore që varen nga vullneti i subjekteve të ligjit, dhe janë në kundërshtim me vullnetin e ligjvënësit. (Shembulli i kësaj janë sjelljet e qëllimshme, të tilla si ngasje shumë e shpejtë, vrasje, vjedhje, mashtrime, evazion fiskal, etj.). Ekzekutimi i deliktit varet nga vullneti personal i subjektit që shfaqet si ekzekutues i veprimeve në kundërshtim me normat e rendit juridik.

Ngjarja natyrore është fakt ligjor që nuk varet nga vullneti i një njeriu, domethënë, nuk është rezultat i aktivitetit të tij. (Shembull, tërmetet, vdekja, zjarri, përmytjet, epidemitë, breshëri, vetëtimat, etj.). Por duhet të theksojmë se ato në vetvete nuk janë fakte ligjore. Për shembull, përmytja si një ngjarje natyrore nuk është një fakt ligjor, do të prodhojë një pasojë ligjore, domethënë, do të jetë një fakt ligjor nëse shtëpia e përmytur është siguruar, dhe tani kompania e sigurimeve do të ketë një detyrim që të kompensojë dëmet.

Koha është një fakt ligjor që shënon një periudhë në të cilën parashikohet të ndodhë një marrëdhënie juridike ose një periudhë që duhet të kalojë për të ndodhur ose për t'u ndërprerë një marrëdhënie juridike. (Shembull, ligji hyn në fuqi pas një periudhe të caktuar kohore, vacatio legis, dhe vetëm pastaj prodhon pasojë ligjore; ose një qytetar i pakënaqur nuk mund të apelojë në një gjykatë të shkallës së dytë nëse e humbet afatin e caktuar për paraqitjen e ankesës.)




Fig. 13: Paraqitja skematike e elementeve të marrëdhënies juridike

? PYETJE:

1. Çfarë nënkuptohet me nocionin e fakteve ligjore?
2. Numëroni faktet ligjore.
3. Shpjegoni ngjarjet si fakte ligjore.
4. Si mund të jenë veprimet njerëzore si fakte ligjore?

MBANI MEND !!!

- ✚ Marrëdhënia juridike është një marrëdhënie shoqërore e rregulluar me normë ligjore.
- ✚ Elementet e marrëdhënieve juridike janë e drejta, detyrimi, objekti dhe subjekti i së drejtës.
- ✚ Subjekti i së drejtës është personi fizik dhe një personi juridik, të cilët me të drejtën janë të autorizuar të jenë bartës të autorizimeve ligjore dhe përgjegjësi ligjore.
- ✚ Autorizimi ligjor është një mundësi për sjellje të caktuar të subjektit të ligjit në lidhje me një subjekt tjetër, bazuar në rregulloret ligjore, në bazë të të cilit subjekti i autorizimit ligjor mund të kërkojë diçka.
- ✚ E drejta subjektive është një lloj autorizimi ligjor i përbërë nga mundësia e subjekteve të së drejtës për të mbrojtur të drejtat dhe interesat e tyre në përputhje me normat ekzistuese ligjore (ligji objektiv) në një shtet.
- ✚ Të drejtat absolute subjektive janë ato që veprojnë drejt të gjitha lëndëve (erga omnes).
- ✚ Të drejtat relative zbatohen vetëm për një numër të caktuar të personave paraprakisht të njohur (inter partes).
- ✚ Detyrimi ligjor është një situatë e tillë në të cilën një subjekt i caktuar, në bazë të rregulloreve ligjore, është përgjegjës të durojë, të japë diçka ose të bëjë diçka në interes të një subjekti tjetër.
- ✚ Objekti i së drejtës është gjësend, aktivitet njerëzor (puna, aktiviteti) ose pasivitet, cilësi dhe veti në të cilat bazohet marrëdhënia ligjore.
- ✚ Faktet ligjore përfshijnë situata të tilla në jetën e njerëzve nën veprimet direkte të të cilave krijohen marrëdhënie të reja ligjore, apo ndryshojnë ose hiqen marrëdhëniet juridike ekzistuese.
- ✚ Faktet ligjore ndahen në veprime njerëzore dhe ngjarje natyrore.

3. SUBJEKTET E SË DREJTËS

3.1. NOCIONI DHE LLOJET E SUBJEKTEVE TË SË DREJTËS

⁶⁸Subjekt i së drejtës është njeriu (person fizik) dhe personi juridik, të cilët me rregulloret ligjore janë të autorizuar të jenë bartës të autorizimeve ligjore dhe përgjegjësi ligjore.

Nga vetë përkufizimi, mund të kategorizohen dy lloje të subjekteve të së drejtës, edhe atë personi fizik dhe personi juridik. Dallimi është se në rastin e parë bëhet fjalë për njeriun si individ, ndërsa në rastin e dytë bëhet fjalë për më shumë njerëz që, përmes një rruge të përbashkët, duan të vijnë në qëllimin e dëshiruar.

Por me një përkufizim të tillë, ne duhet të kujtojmë faktin se në periudhën e skllavërisë dhe feudalizmit, njerëzit nuk ishin vetëm subjekte, por edhe objekte të së drejtës (skllëvërit, për shembull, ishin gjithashtu subjekte dhe objekte të marrëdhënieve juridike, sepse ata konsideroheshin "vegla që flasin").

? PYETJE:

1. Çfarë nënkuptohet nga nocioni i subjekteve të së drejtës?
2. Cilat subjekte të së drejtës ekzistojnë?

3.1.1. PERSONI FIZIK SI SUBJEKT I SË DREJTËS

Njeriu si individ është person fizik i cili bëhet subjekt i së drejtës nga lindja dhe mbetet i tillë deri në vdekjen e tij.⁶⁹

Person fizik është çdo person i lindur, pavarësisht nga gjinia, moshë, raca, kombësia, gjendja shëndetësore, etj. Çdo person, nga lindja i fiton të drejtat dhe detyrimet. Këto të drejta dhe detyrime njeriu nuk i merr me meritë gjatë rrjedhës së jetës, por ato janë të lindura, dhe çdo person i posedon në mënyrë të barabartë. Por mundësia e fitimit të drejtave dhe detyrimeve dhe praktikimi i tyre në të drejtën, lidhet me aftësi dhe attribute të caktuara që duhet t'i kenë subjektet e së drejtës.

⁶⁸Проф. д-р Миодраг Мицајков, проф. д-р Димитар Балаџијев, доц. д-р Донгинка Таскова, „Право“, 1999.

⁶⁹ „Граѓанско право (општ дел)“, д-р Асен Групче, Скопје, 1986.

Personat fizikë karakterizohen nga **tre aftësi**, edhe atë:

- juridike
- afariste dhe
- deliktore, dhe

me tre **atribute** ose të njohura si:

- emri
- vendbanimi
- shtetësia.

Aftësitë janë vetitë themelore të subjekteve, ndërsa atributet kanë një rol dytësor.

AFTËSIA JURIDIKE E PERSONAVE FIZIKË

Aftësia juridike është një mundësi për çdo person që të jetë subjekt i të drejtave dhe detyrimeve, pra të fitojë të drejta dhe detyrime.

Përftimi i aftësisë juridike

Aftësi juridike ka çdo person i lindur i gjallë i llojit njerëzor. Në parim, për përftimin e aftësisë juridike, nuk nevojiten kushte të veçanta përsa i përket moshës ose gjendjes mendore, mjafton që personi të lindë i gjallë. Kjo aftësi përfitohet nga lindja e personit dhe mbetet deri në fund të jetës së tij. Pra, që nga momenti kur personi bëhet subjekt i së drejtës, ai në të njëjtën kohë fiton aftësinë juridike. Nuk ka nevojë që personi të jetë i aftë për të jetuar. Ky rregull ka edhe përjashtim, dhe ky është fikcioni juridik.

Fikcioni juridik është një situatë e së drejtës kur diçka e pavërtetë, e rreme ose inekzistente konsiderohet e vërtetë, e saktë apo ekzistente, dhe anasjelltas.

Është e qartë se në një rrethanë të veçantë diçka nuk ekziston, ndërsa konsiderohet sikur të ekzistojë.

Shembull:

- Fëmija i ngjizur supozohet të jetë i gjallë (që nuk do të thotë domosdoshmërisht se do të lind i gjallë), në mënyrë që foshnjës së palindur t'i njihet aftësia juridike.

Ky fikcion është i domosdoshëm në mënyrë që fëmija i palindur të paraqitet si pasardhësi i babait të tij, sepse ligji i trashëgimisë fillon nga parimi që trashëgimtarë mund të jenë persona që janë të gjallë në kohën e hapjes së trashëgimisë ndërsa trashëgimia hapet në kohën e vdekjes së atij që lë trashëgiminë.

Ndërprerja e aftësisë juridike

Aftësia juridike zgjat gjatë gjithë jetës së subjektit dhe ndalon së ekzistuari me vdekjen e tij.

AFTËSIA AFARISTE E PERSONAVE FIZIKË

Aftësia afariste është aftësia e personit fizik (njeriut) që të mund në mënyrë të pavarur, me veprimet e tij personale, të vendosë marrëdhënie juridike, ose të ndryshojë ose të shfuqizojë marrëdhëniet ekzistuese ligjore.

Aftësia afariste nënkupton mundësinë e një personi për të realizuar aftësinë e tij juridike. Ndryshe nga aftësia juridike që është statike, aftësia afariste është aktive, sepse subjekti merr pjesë në mënyrë të pavarur në qarkullimin juridik, duke realizuar të drejtat, detyrimet dhe interesat e tij.

Përftimi i aftësisë afariste

Përftimi i aftësisë afariste varet nga dy faktorë:

- Nga mosha dhe
- Nga shëndeti shpirtëror (mendor) i subjektit.

Aftësia afariste fitohet pas arritjes së një moshe të caktuar, e cila konsiderohet madhore (me 18 vjet ose moshë tjetër, e cila konsiderohet madhore në një shtet të caktuar). Nga rregulli që aftësia afariste të fitohet me pjekurinë, ekziston edhe përjashtimi nëpërmjet të të ashtuquajturit emancipim.

Emancipimi do të thotë që personi mund të përftojë aftësi afariste edhe para moshës 18 vjeçare.

Shembull:

- Ligji për familjen përcakton se martesë mund të lidhë një person i cili ka mbushur 16 vjet nëse gjykata kompetente konstaton se ai person ka arritur pjekurinë fizike dhe mendore të nevojshme për ushtrimin dhe detyrat që lindin në martesë. Kjo do të thotë se me martesë, personi do të fitojë aftësi afariste edhe para moshës madhore.

Më tej:

- Ligji për Marrëdhëniet e Punës parashikon që një person që është 15 vjeç mund të themelojë një marrëdhënie pune. Pra, përsëri personi fiton aftësinë afariste para arritjes së moshës 18-vjeçare. Ky person mund të ndërmarrë vetëm të drejta dhe detyrime në qarkullimin juridik. Shembull, për të pasur në dispozicion paratë e fituara, etj.

Lidhur me faktorin e dytë, njerëzit që kanë moshën 18 vjeç, por nuk janë ët shëndoshë mendërisht, nuk kanë aftësi afariste. Te ata vazhdohet e drejta prindërore.

Marrja dhe kufizimi, ndërprerja e aftësisë afariste

Rregulli është se aftësia e biznesit humbet me vdekjen. Por aftësia e fituar afariste njëherë mund të humbasë ose të kufizohet nëse reduktohet, nëse kufizohet ose nëse humbet supozimi psikofizik për të. Kështu, nëse shëndeti mendor i personit dëmtohet, aftësia afariste do të reduktohet ose do të merret. Kjo varet nga shkalla e çrregullimit. Pavarësisht nga çrregullimi, nëse shkalla e aftësisë për gjykim mbetet, aftësia afariste do t'i *kufizohet*. Nëse, megjithatë, aftësia e tij për të arsyetuar humbet plotësisht, aftësia afariste do t'i merret. Nëse personi të cilit i është marrë aftësia afariste shërohet, në atë rast ajo do t'i kthehet përsëri. Personat që janë të paaftë në aspekt afarist, kanë përfaqësues.

Personat që nuk kanë mbushur 18 vjet, janë të mitur dhe trajtohen ndryshe nga të rriturit. Por të gjithë personat që nuk kanë mbushur 18 vjet nuk kanë të njëjtin trajtim. Sipas moshës, ekziston një gradim i caktuar i të miturve. Personat deri në 14 vjet quhen fëmijë. Personat ndërmjet 14 dhe 16 vjeç janë të mitur të rinj. Personat nga 16 deri në 18 vjet janë të mitur më të moshuar.

AFTËSIA DELIKTORE

Aftësia deliktore është një supozim i përgjegjësisë. Disa autorë e përcaktojnë atë si aftësinë për të qenë përgjegjës për dëmin. Disa, megjithatë, e përkufizojnë aftësinë deliktore si aftësi e personit për të vlerësuar veprimet e tij, por jo në aspektin e asaj nëse ato korrespondojnë me interesat e tij që do të ishin përmbushur me hyrjen në disa marrëdhënie kontraktuale. Pyetja është nëse këto procedura janë në kundërshtim me ligjin, domethënë a dëmtohet me to ndonjë person tjetër.

Aftësia deliktore mund të humbasë. Si aftësia afariste, nëse personi humbet aftësinë për të arsyetuar, për shkak të sëmundjes dhe arsyeve të tjera, nuk do të konsiderohet i aftë në aspekt deliktor. Për praktikën është e rëndësishme çështja e humbjes së përkohshme të aftësisë për të gjykuar për shkak të alkoolizmit dhe situatave të ngjashme. Përgjigjet janë të ndryshme. Gjegjësisht, nëse personi përkohësisht humbet aftësinë për të arsyetuar për shkak të fajit të tij (nëse dehet vetë), dhe ai e di se duke qenë i dehur mund të kryejë akte të paligjshme, ai do të konsiderohet si i aftë në aspekt delikti.

Por nëse në një situatë të tillë e sjell një person tjetër, atëherë ai nuk do të përgjigjet vetë. Pyetja është nëse gjatë *lucida intervala* (momenteve të ndritshme) si gjendje të përkohshme të aftësisë për të arsyetuar - personi mbart përgjegjësi. Në thelb, mban pikëpamja se në situata të tilla ekziston aftësia deliktore.

Aftësia deliktore ka trajtim të ndryshëm në individë të ndryshëm, në varësi të moshës. Nga kjo do të varet edhe lloji i sanksioneve që mund të vendosen. Për shembull, sipas Kodit Penal, fëmijët nuk kanë asnjë përgjegjësi dhe nuk mund t'u shqiptohet sanksion. Prindërit/kujdestarët e tyre përgjigjen për veprimet e tyre. Të miturve më të rinj mund t'u vendosen dënime të buta, ndërsa të miturve më të moshuar, dënime më të rrepta, ndërsa me përjashtime, mund t'u shqiptohen edhe dënime me burg.

ATRIBUTET

Përveç aftësive, të cilat janë një tipar i subjektivitetit juridik, personat kanë edhe tre veti speciale ose attribute.

Emrin. Emri në të drejtën nënkupton emrin dhe mbiemrin e personit. Emri jepet nga prindërit, kujdestarët dhe regjistrohet në regjistrin e lindjeve. Emri mund të ndryshohet, përveç në situatat ku ndryshimi i emrit bëhet për të shmangur disa përgjegjësi. Sipas emrit të vlefshëm, personi figuron në të gjitha dokumentet zyrtare. Funkzioni i emrit është të sigurojë identifikimin e subjektit.

Vendbanimi/vendqëndrimi. Çdo person jeton në një vend të caktuar. Vendi ku një person jeton vazhdimisht quhet vendbanim, ndërsa vendi ku personi jeton përkohësisht quhet vendqëndrim. Vendbanimi dhe vendqëndrimi janë zgjedhje e lirë e njeriut, i cili ka të drejtën e lirisë së lëvizjes.

Funksioni i vendbanimit gjegjësisht vendqëndrimit, është të plotësojë identitetin e personit. Vendbanimi është me rëndësi të madhe për karakterin material-juridik dhe procesor-juridik. Kjo ndikon në juridiksionin lokal të gjykatave, të cilat zgjidhin mosmarrëveshjet civile, ose është i rëndësishëm në funksion të përmbushjes së një detyrimi kontraktual, pastaj për përftimin e aftësive juridike, respektivisht përftimit të të drejtave dhe detyrimeve, etj.

Shtetësia. Shtetësia si pjesë e një personi fizik në rendin juridik dhe politik të një vendi ka rëndësinë e vet juridike, sepse të drejtat dhe detyrimet e shtetasve dhe të huajve në një shtet nuk janë të njëjta.

? PYETJE:

1. Çfarë do të thotë person fizik si subjekt i së drejtës?
2. Kur bëhet personi fizik subjekt i së drejtës?
3. Numëroni aftësitë e personit fizik si subjekt i së drejtës.
4. Shpjegoni aftësinë juridike.
5. Cilat kushte nevojiten për përftimin e aftësisë afariste të personit fizik?
6. Çfarë është aftësia deliktore?
7. Numëroni atributet e një personi fizik.
8. Çfarë është emancipimi?

3.1.2. PERSONI JURIDIK SI SUBJEKT I SË DREJTËS

Ndonjëherë njeriu, në mënyrë që të realizojë interesa të caktuara, duhet të bashkohet me njerëz të tjerë.

Shoqërimi i personave fizikë në bazë të rregulloreve ligjore me qëllim të ushtrimit të interesave të përbashkëta të lejuara nga ligji paraqet person juridik.

Këto janë organizata të personave dhe pronës së përbashkët që realizojnë qëllime të caktuara të lejueshme, me ç'rast rendi juridik i njeh si subjekte të së drejtës.

I dallojmë këto lloje të personave juridikë:

- Shoqata të themeluara për realizimin e një objekti ekonomik në interes të anëtarëve të shoqatës (për shembull, kompanitë tregtare);
- Shoqata të themeluara për të përmbushur një objektiv të natyrës jo-materiale si qëllime kulturore, sportive, arsimore (për shembull shoqatat e qytetarëve, fondacionet);
- Institucione të themeluara për kryerjen e aktiviteteve dhe shërbimeve me interes publik (për shembull, muze, kinema, shkolla, spitale, fakultete).

Personi juridik lind duke miratuar një akt të themelimit, i sjellë në bazë të ligjit. Ai shndërrohet subjekt i së drejtës që nga themelimi, domethënë nga momenti i regjistrimit në regjistrin e autoritetit kompetent.

Personi juridik ekziston nëse plotësohen kushtet e mëposhtme:

1. personi juridik duhet të jetë një tërësi e caktuar organizative;
2. të ketë një pronë të caktuar në mënyrë që të mund të përgjigjet për detyrimet dhe të drejtat e tij;
3. qëllimi për të cilin është krijuar të jetë i lejuar me ligj;
4. të njihet nga shteti dhe të jetë i regjistruar në regjistrin e autoritetit kompetent.

Është e vështirë të ndahet aftësia juridike dhe afariste e personit juridik, ndryshe nga personi fizik, për arsye që të dy llojet e aftësive fitohen njëkohësisht, e që ndodh nga momenti i themelimit të personit juridik. Personi juridik mund të jetë bartës vetëm i atyre të drejtave dhe detyrimeve të përcaktuara në qëllimin për shkak të të cilit është themeluar.

Aftësia afariste e një personi juridik vendor

1. Personi juridik mund të lidhë marrëveshje në qarkullimin juridik vetëm brenda aftësive të tij juridike;
2. Marrëveshja e lidhur në kundërshtim me dispozitën e përmendur në paragrafin 1 të këtij neni nuk ka efekt juridik, përveç nëse pala tjetër nuk e ka ditur ose nuk ka mundur të dijë për tejkalimin.
3. Ligji për marrëdhëniet detyrimore, neni 46.

Ndërprerja e aftësisë juridike dhe afariste të personit juridik

Personi juridik e humbet aftësinë e tij juridike dhe afariste kur pushon së ekzistuari. (Për shembull, kur personi juridik do të arrijë qëllimin për të cilin është themeluar, me dëshirën e themeluesit, me fshirje nga regjistri, falimentim, për shkak të ndalimit të kryerjes së një aktiviteti, etj.)

AFTËSIA DELIKTORE

Me aftësinë deliktore të personit juridik, nënkuptohet përgjegjësia e personave juridikë para subjekteve të treta për dëmet e kryera nga organet ose punëtorët e tyre, d.m.th. anëtarët e personit juridik. ⁷⁰

Aftësia deliktore

1. Personi juridik është përgjegjës për dëmin e shkaktuar nga **organi i tij një pale të tretë në kryerjen ose në lidhje me kryerjen e funksioneve të tij;**
2. Nëse për një rast të caktuar nuk ka diçka tjetër të përcaktuar me ligj, **personi juridik ka të drejtën e kompensimit nga personi që ka shkaktuar dëmin me dashje ose me neglizhencë të skajshme.**

Ligji për të marrëdhëniet detyrimore, neni 158.

⁷⁰ „Општ дел на граѓанско право“, Практикум, 2006, проф. д-р Родна Живковска.

Personat juridikë kanë një përfaqësues ligjor përmes të cilit i kryejnë punët juridike, e që është organi udhëheqës i personit juridik, për shembull drejtor, dekan, etj.

TIPARET DALLUESE TË PERSONIT JURIDIK

Personat fizikë kanë attribute, ndërsa personat juridikë kanë karakteristika që ndryshojnë.

Tiparet dalluese të personave juridikë janë:

- emri ose firma, domethënë, emri sipas të cilit punon personi juridik;
- selia, vendi ku veprojnë organet kryesore të personit juridik;
- veprimtaria ose lënda e punës (personi juridik mund të lidhë marrëveshje vetëm brenda veprimtarisë për të cilën është e regjistruar).

? PYETJE:

1. Çfarë paraqet personi juridik si subjekt i së drejtës?
2. Kur bëhet personi juridik subjekt i së drejtës?
3. Kur fiton personi juridik aftësi juridike dhe afariste?
4. Shpjegoni aftësinë deliktore të personit juridik.
5. Kur pushon personi juridik së qeni subjekt i së drejtës?
6. Numëroni tiparet dalluese të personit juridik.

KARAKTERISTIKAT E PERSONIT FIZIK DHE JURIDIK

PERSONI FIZIK	PERSONI JURIDIK
Bëhet subjekt me lindjen dhe pushon së qeni me vdekjen e tij.	Shfaqet me regjistrimin, dhe përfundon me arritjen e qëllimit për të cilin është themeluar, me vullnetin e themeluesve, me Fshirjen nga regjistri, falimentim, për shkak të ndalimit të kryerjes së aktivitetit, etj.
Aftësia juridike fitohet nga lindja, ajo afariste fitohet më vonë gjatë jetës.	Fiton aftësi juridike dhe afariste në të njëjtën kohë me regjistrimin e tij.
Aftësia juridike humbet me vdekjen, ajo afariste mund të humbasë edhe para vdekjes.	Edhe aftësia juridike edhe ajo afariste humben në të njëjtën kohë – me pushimin e të ekzistuarit të tij.
E fiton dhe e humb aftësinë juridike pavarësisht vullnetit të tij/saj (lindje, vdekje).	E fiton aftësinë juridike me aktin e miratimit, e humbet kur shteti do të shfuqizojë miratimin.
Mund të bëjë gjithçka që nuk e ka të ndaluar në mënyrë të prerë	Përmes organeve të tij mund të bëjë vetëm atë që i lejohet në mënyrë eksplicite.
Është identik me vetveten (person fizik si subjekt).	Është një subjekt i veçantë, i pavarur nga subjektiviteti i anëtarëve të saj (personat fizikë janë subjekte të pavarura me të drejtat dhe detyrimet e tyre pavarësisht nga të drejtat dhe detyrimet e personit juridik).

MBANI MEND !!!

- ✚ Subjekt i së drejtës është njeriu (person fizik) dhe personi juridik, të cilët me rregulloret ligjore janë të autorizuar të jenë bartës të autorizimeve dhe përgjegjësive ligjore.
- ✚ Njeriu si individ është person fizik i cili bëhet subjekt i së drejtës nga lindja dhe mbetet i tillë deri në vdekjen e tij.
- ✚ Aftësia juridike është një mundësi për çdo person që të jetë subjekt i të drejtave dhe detyrimeve, pra të fitojë të drejta dhe detyrime.
- ✚ Fiksioni juridik është një situatë në ligj kur diçka e pavërtetë, e pasaktë ose inekzistente konsiderohet e vërtetë, e saktë ose ekzistente dhe anasjelltas.
- ✚ Aftësia juridike zgjat gjatë gjithë jetës së subjektit dhe ndërpritet me vdekjen e personit.
- ✚ Aftësia afariste është aftësia e personit fizik (njeriut) që në mënyrë të pavarur, me veprimet e tij personale, të vendosë marrëdhënie juridike, ose të ndryshojë ose të shfuqizojë marrëdhëniet ekzistuese juridike.
- ✚ Aftësia afariste fitohet me pjekurinë e moshës dhe atë mendore.
- ✚ Emancipimi do të thotë që personi mund të firojë aftësi afariste edhe para moshës 18 vjeçare.
- ✚ Aftësia deliktore është një supozim i përgjegjësisë.
- ✚ Shoqërimi i personave fizikë në bazë të rregulloreve ligjore me qëllim të realizimit të interesave të përbashkëta të lejuara me ligj paraqesin person juridik.
- ✚ Personi juridik fiton aftësinë afariste në kohën e themelimit të tij.

4. PËRFAQËSIMI

4.1. NOCIONI DHE LLOJET E PËRFAQËSIMIT

Me përfaqësim nënkuptojmë marrjen e të drejtave dhe detyrimeve në emër të dhe për llogarinë e një personi tjetër.

Sipas bazës së përfaqësimit, dallojmë përfaqësim ligjor dhe kontraktual.

4.1.1. PËRFAQËSIMI LIGJOR

Personat fizikë që nuk kanë aftësi afariste (të mitur, të mitur pa prindër, persona me zhvillim të prapambetur mendor) duhet të përfaqësohen nga prindërit e tyre, kujdestarët. Gjegjësisht, përfaqësimi i tillë i këtyre personave është siguruar me ligj ose me një akt të një organi kompetent shtetëror (Qendra për punë sociale për fëmijët pa prindër). Në këto raste, kemi të bëjmë me përfaqësim ligjor. Përfaqësimi ligjor nuk është vetëm e drejtë e prindërve, por edhe një detyrim për të përfaqësuar fëmijët e tyre deri në moshën madhore⁷¹.

Gjithashtu, personat juridikë nuk përjashtohen nga mundësia e përfaqësimit ligjor. Ata përfaqësohen nga ata që i udhëheqin (personat fizikë) dhe kompetencat e tyre janë të bazuara në ligj⁷².

Shembull:

- Drejtori është i detyruar të përfaqësojë personin juridik para palëve të treta. Është obligim ligjor dhe statutor, i cili vjen me marrjen e funksionit/pozitës nga ana e tij.

⁷¹ „Prindërit kanë të drejtën dhe detyrën për të përfaqësuar fëmijët e tyre të mitur. Fëmija ka të drejtë të përfaqësohet nga prindërit ose kujdestarët e tij” – neni 51 i Ligjit për familjen, „Gazeta zyrtare e RM” nr.153/2014.

⁷² „Dekani e përfaqëson fakultetin në vend dhe jashtë tij.” – neni 41 i Statutit të Fakultetit Juridik „Justiniani I” – Shkup

4.1.2. PËRFAQËSIMI KONTRAKTUAL

Në disa situata, nevojë përfaqësimi kanë personat që janë të aftë në aspekt afarist, për shembull, nëse nuk janë në vendin ku duhet të kryhet puna ligjore ose konsiderojnë se një palë e tretë, për shkak të ekspertizës së tyre, do të përfundojë më mirë punën e tyre. Në këto situata në të cilat përfaqësimi shprehet në vullnetin e subjekteve të së drejtës, kemi të bëjmë me përfaqësim kontraktual, i cili quhet autorizim.

Autorizimi përfaqëson vullnetin e shkruar të një subjekti që autorizon një subjekt tjetër në emër të tij dhe për llogarinë e tij për të ndërmarrë të drejtat dhe detyrimet në qarkullimin juridik.

Dallimi midis përfaqësimit ligjor dhe kontraktual është në faktin se përfaqësuesit ligjorë i cakton ligji, ndërsa ata kontraktualë i emëron vetë personi fizik ose juridik. Palët në autorizim janë: autorizuesi (personi që jep autorizimin) dhe i autorizuari (personi i autorizuar). Kushti që dikush të jetë autorizues dhe i autorizuar është aftësia e tyre afariste. Lënda e autorizimit si një lloj përfaqësimi mund të jetë e natyrës së shumëllojshme. Por ende ka edhe gjëra për të cilat nuk mund të autorizojmë.

Shembull:

Ne nuk mund të autorizojmë dikë që të votojë për ne, të dëshmojë për ne, të vuajë dënimin me burg për ne, të shkojë në punë për ne, etj.

Autorizimi i përmban elementet e mëposhtme:

- Emrin e aktit;
- Të dhënat personale të atij që e lëshon;
- Të dhënat personale të atij që autorizohet;
- Arsytet për lëshimin e autorizimit;
- Punën ligjore për të cilën autorizohet;
- Afatin për të cilin lëshohet;
- Nënshkrimin e personit që jep autorizimin dhe
- vulën, nëse atë e lëshon një person juridik.

Autorizimi mund të jepet me shkrim ose me gojë në procesverbal. Sipas kompetencave të dhëna me autorizimin, ai mund të jetë i përgjithshëm dhe i veçantë (specifik), i kufizuar dhe i pakufizuar.

Autorizimi i përgjithshëm është ai me të cilin i autorizuari autorizohet për të kryer të gjitha punët juridike ose një sërë punësh juridike në emër të dhe për llogari të autorizuesit.

Shembull i një autorizimi të përgjithshëm

Unë, i poshtë-nënshkruari, D.P. nga Shkupi, me banim në rr. _____ nr. _____ me letërnjoftim nr. _____ NA _____ lëshuar nga MPB, e autorizoj (vëllain, babanë, mbesën, shokun, etj.) tim O.C. nga Shkupi, me banim në rr. _____ nr. _____ me letërnjoftim nr. _____ NA _____ lëshuar nga MPB që të mundet, në emrin tim dhe për llogarinë time, t'i ndërmarrë të gjitha veprimet ligjore në lidhje me përdorimin e gjithë pronës sime në Republikën e Maqedonisë së Veriut, në të gjitha procedurat gjyqësore dhe procedurat tjera para gjykatave, para organeve administrative, në komuna, në qytet dhe në republikë.

Shkup, më _____ 2018

Autorizuesi

Autorizimi i veçantë do të thotë se i autorizuari autorizohet të kryejë një punë të përcaktuar në mënyrë specifike.

Shembull i një autorizimi të veçantë

Unë, i poshtë-nënshkruari, D.P. nga Shkupi, me banim në rr. _____ nr. _____ me letërnjoftim nr. _____ NA _____ lëshuar nga MPB, e autorizoj A.F. nga Shkupi, me banim në rr. _____ nr. _____ me letërnjoftim nr. _____ NA _____ lëshuar nga MPB të mund të blejë një automjet motorik pasagjerësh Fiat Punto, me numër motori _____, numër shasje _____ dhe të njëjtin ta regjistrojë.

Shkup, më _____ 2018

Autorizuesi

Autorizimi i përgjithshëm dhe i veçantë mund të jetë i kufizuar ose i pakufizuar.

Nëse me autorizimin të autorizuarit i jepen udhëzime lidhur me lëndën, personat, kohën dhe rrethanat e tjera që lidhen me punën juridike, atëherë bëhet fjalë për autorizim të kufizuar.

Shembull:

Personi A e autorizon personin B për të blerë një apartament në Shkup, por gjithashtu e përcakton më për së afërmi rajonin në të cilin dëshiron të jetë ai apartament, katin, madhësinë e banesës, nga çka varret edhe çmimi e kështu me radhë.

Me autorizimin e pakufizuar nuk i jepet ndonjë udhëzim të autorizuarit se si të veprojë në lidhjen e kontratës, përkatësisht ndërmarrjes së ndonjë pune tjetër juridike.

Autorizuesi mund në çdo moment të revokojë të autorizuarin, por edhe i autorizuari mund të heqë dorë nga autorizimi. Arsyet e tjera për ndërprerjen e autorizimit janë vdekja e të palëve, përmbushja e detyrimit për të cilin është dhënë autorizimi, si dhe skadimi i afatit për të cilin është lëshuar autorizimi.

!!! Me rëndësi

Veprimet e ndërmarra dhe punët e kryera nga i autorizuari brenda autorizimit të dhënë kanë të njëjtën peshë sikur të njëjtat t'i ketë kryer personi që jep autorizimin.

? PYETJE:

1. Çfarë është përfaqësimi?
2. Cilat janë bazat e përfaqësimit?
3. Si mund të jetë përfaqësimi?
4. Çfarë është autorizimi?
5. Kush mund të jetë autorizues?
6. Si mund të jetë autorizimi?
7. Në cilat mënyra ndërpritet autorizimi?

DETYRË:

1. Hartoni një autorizim të veçantë.
2. Në shembujt e mëposhtëm përcaktoni llojin e autorizimit dhe palët në marrëdhënie

“Personi B.D. të moshës 65 vjeç, për shkak të sëmundjes mendore - skizofrenisë, për shkak të së cilës nuk mund të kuptojë rëndësinë e veprimeve të tij dhe vetëm të kujdeset për të drejtat dhe interesat e tij, me vendim të Gjykatës themelore Shkupi II – Shkup, është privuar nga aftësia afariste. Pasuritë e paluajtshme udhëhiqen në emër të tij. Me vendim të Qendrës për punë sociale, i caktohet një kujdestar, i cili do të përfaqësojë të drejtat dhe interesat e tij.”

“Personi B.B. më 30 prill 2019, për shkak të krimit të kryer, vrasje, u arrestua. Procedura është iniciuar kundër tij para Gjykatës themelore Manastir. Personi ka angazhuar një avokat për të përgatitur mbrojtjen e tij.”

“Personi N.M. do të qëndrojë për 6 muaj në Japoni. Ai zotëron një apartament, makinë dhe shtëpi pushimi. Ky person e autorizoi vëllain e tij për të ndërmarrë në emër të tij të gjitha veprimet në lidhje me menaxhimin dhe përdorimin e pronës gjatë mungesës së tij.”

“Agjencia për e përfaqësuar nga drejtori, dhe fakulteti i” i përfaqësuar nga dekani, më 12.03.2019 nënshkruan marrëveshje bashkëpunimi.”

“Personi A.P. posedon një apartament dhe një garazh dhe dëshiron t’i shesë. Kjo është arsyeja pse ai autorizoi personin D.K. për të lidhur dhe nënshkruar një marrëveshje shitblerjeje.”

“Aksionari U. M. me një autorizim ka autorizuar personin O.J. si përfaqësues të tijin në një takim të aksionarëve.”

“Drejtori i firmës "XXXH", e autorizon sekretarin të shkojë te Fondi për dhe t’i marrë kartelat elektronike të prodhuara për punonjësit e firmës.”

MBANI MEND !!!

- ✚ Përfaqësimi nënkupton marrjen e të drejtave dhe detyrimeve në emër të dhe për llogarinë e një personi tjetër.
- ✚ Përfaqësimi mund të jetë ligjor dhe kontraktual.
- ✚ Autorizimi përfaqëson një vullnet të shkruar të një subjekti që autorizon një subjekt tjetër në emër të tij dhe për llogarinë e tij për të ndërmarrë të drejtat dhe detyrimet në qarkullimin juridik.
- ✚ Autorizimi i përgjithshëm është ai kur autorizuesi e autorizon të autorizuarin të kryejë të gjitha punët juridike ose një grup punësh juridike në emër të dhe për llogari të autorizuesit.
- ✚ Autorizimi i veçantë do të thotë se i autorizuari është i autorizuar për të kryer punën e përcaktuar saktësisht.
- ✚ Me autorizimin e pakufizuar nuk i jepet ndonjë udhëzim të autorizuarit se si të veprojë në lidhjen e kontratës, përkatësisht ndërmarrjes së ndonjë pune tjetër juridike.
- ✚ Autorizuesi mund në çdo moment të revokojë të autorizuarin, por edhe i autorizuari mund të heqë dorë nga autorizimi. Arsyet e tjera për ndërprerjen e autorizimit janë vdekja e të palëve, përmbushja e detyrimit për të cilin është dhënë autorizimi, si dhe skadimi i afatit për të cilin është lëshuar autorizimi.

VI. E DREJTA POZITIVE DHE ZBATIMI I SË DREJTËS

Pas leximit të kësaj pjese, duhet të jeni në gjendje: të përkufizoni termin e drejtë pozitive, të dalloni vlefshmërinë hapësinore dhe kohore të normave juridike, të shpjegoni termat fuqi juridike, kushtetutshmëri, ligjshmëri, paligjshmëri, plotfuqishmëri, finalitet dhe ekzekutueshmëri, të shpjegoni konceptin e shtetit të së drejtës, të numëroni postulatet themelore të sundimit të së drejtës.

1. ZBATIMI I SË DREJTËS

1.1. NOCIONI I TË DREJTËS POZITIVE

Në temat e mëparshme folëm për të drejtën dhe normat juridike si pjesë e elementit normativ të rendit juridik. Është e një rëndësie të veçantë trajtimi i zbatimit dhe vlefshmërisë së rregullave ligjore në një vend të caktuar. **E drejta pozitive është një e drejtë që vlen dhe zbatohet në një vend të caktuar.** Pra, praktikisht kur bëhet fjalë për të drejtën pozitive në një vend, bëhet fjalë për rregulla ligjore që janë të vlefshme, të detyrueshme, të ligjshme, të miratuara me procedurë përkatëse, me fuqinë e duhur ligjore dhe që zbatohen dhe realizohen në një shtet të caktuar.

Me rëndësi të veçantë për funksionimin e rendit juridik është e drejta pozitive e qëndrueshme dhe stabile. Kjo do të thotë se nëse rregullat aktuale ligjore në një vend pësojnë ndryshime të shpeshta, kjo shkakton paqëndrueshmëri të rendit juridik. Prandaj, duhet bërë përpjekje që rregullat aktuale ligjore të ndryshohen sa më pak dhe sa më rrallë, në mënyrë që të sigurohet një rend juridik i qëndrueshëm.

1.2. VLEFSHMËRIA E NORMAVE JURIDIKE

Normat juridike dhe aktet juridike vlejnë në një territor të caktuar në një kohë të caktuar. Prandaj dallojmë vlefshmërinë hapësinore (territoriale) dhe kohore të normave juridike.

Vlefshmëria hapësinore (territoriale) e normave të përgjithshme juridike, dhe me këtë edhe e akteve të përgjithshme juridike, bazohet në parimin se ato zbatohen në të gjithë territorin shtetëror. Siç e kemi theksuar tashmë, ato kanë një karakter të përgjithshëm të detyrueshëm për të gjithë ata që jetojnë dhe ndodhen në atë territor shtetëror.

Vlefshmëria kohore e normave juridike dhe e akteve juridike tregon faktin se çdo normë juridike dhe akt juridik kanë një periudhë të caktuar kohore në të cilën prodhojnë efekt juridik. Për shembull, ligji si akt i përgjithshëm juridik e merr efektin juridik nga momenti i hyrjes në fuqi dhe për një periudhë të pacaktuar në të ardhmen. Nga ky rregull ka një përjashtim që quhet prapaveprues, pra efekt prapaveprues i ligjit. Ky rregull zbatohet për të parashikuar një dënim më të butë në interes të kryesit. Prapaveprimi nuk vlen për të gjithë ligjin, por vetëm për disa dispozita që janë në interes të palës së prekur.

Shembull:

Nëse një person është dënuar për një krim sipas një norme penale-juridike të mëparshme të një ligji përkatës, dhe e njëjta normë penale-juridike tani ka pësuar ndryshime që janë në interes të palës së interesuar që është dënuar sipas normës së mëparshme të ligjit, norma e ndryshuar penale-juridike mund të vlejë në mënyrë prapavepruese (retroaktive) dhe personi mund të lirohet. Kjo vlen sepse vepra për të cilën personi është dënuar në ndryshimet e reja nuk parashikohet si e dënueshme, ose amendamenti i ri mund të parashikojë një sanksion më të butë për të njëjtën vepër, kështu që ligji do të zbatohet në mënyrë retroaktive për uljen e masës së dënimit.

Retroaktivitetin, si institucion juridik, shteti duhet të përpiqet ta zbatojë sa më rrallë duke rritur sigurinë e qytetarëve dhe stabilitetin e të gjithë rendit juridik.

? PYETJE:

1. Çfarë është e drejta pozitive?
2. Shpjegoni vlefshmërinë hapësinore (territoriale) dhe kohore të normave juridike.
3. Shpjegoni parimin e ndalimit të efektit prapaveprues të ligjeve dhe vlerësoni rëndësinë e këtij parimi.

1.3. FORCA JURIDIKE

Aktet juridike janë të rregulluara në mënyrë hierarkike. Ajo nënrenditje varet nga forca juridike e aktit juridik.

Forca juridike e aktit juridik është masë e ndikimit të një akti juridik në tjetrin, pra masë që përcakton se cili akt juridik është më i lartë e cili më i ulët.

Një akt që ndodhet në një vend më të lartë në hierarkinë e akteve juridike ka forcë juridike më të madhe sepse vendi në të cilin ndodhet në atë hierarki, në fakt tregon forcën juridike të tij. Shtrohet pyetja se nga varet forca juridike, respektivisht vendi ku ndodhet akti.

Forca juridike e një akti juridik varet nga dy faktorë, përkatësisht:


- **Nga organi shtetëror që e ka sjellë atë**, pra nga pozita e organit në hierarkinë e organeve shtetërore.

Nëse organi shtetëror që miraton aktin juridik është në një vend më të lartë në hierarkinë e organeve shtetërore, atëherë akti i miratuar nga ai organ do të zërë një vend më të lartë në hierarkinë e akteve juridike. Organet e vendosura në një vend më të ulët miratojnë akte me më pak forcë juridike. E gjithë kjo tregon për marrëdhënien që ekziston midis ligjit, nga njëra anë, dhe shtetit nga ana tjetër, e cila është paraqitur në diagramin e mëposhtëm.

Shembull i hierarkisë së organeve shtetërore



Shembull i hierarkisë së akteve juridike



● **Nga procedura me të cilën miratohet akti juridik.**

Në rast se një organ miraton disa lloje aktesh, si për shembull organi legjislativ që miraton kushtetutën, ligjin, rezolutat dhe aktet e tjera, forca juridike nuk mund të vlerësohet sipas organit kompetent, por sipas procedurës me të cilën është miratuar akti. Pra, edhe kushtetuta edhe ligji miratohen nga ligjvënësi, por ndryshe nga ligji, kushtetuta miratohet në një procedurë kushtetuese të përcaktuar posaçërisht dhe më komplekse, pra është një akt me forcë juridike më të madhe se ligji.

? PYETJE:

1. Çfarë është forca juridike e aktit juridik?
2. Nga kush varet forca juridike e aktit juridik?

 DETYRË:

1. Mendoni se cili akt ka forcë më të madhe juridike, aktgjykimi i Gjykatës Themelore Tetovë apo aktgjykimi i Gjykatës së Apelit Gostivar. Pse?

1.4. KUSHTETUTSHMËRIA DHE LIGJSHMËRIA

Aktet juridike janë të renditura në mënyrë hierarkike në një shkallë, me aktin më të lartë juridik në krye dhe më të ulët në fund. Kjo renditje hierarkike e akteve juridike kërkon përputhjen e akteve më të ulëta juridike me ato më të lartat. Gjithmonë ka nënrenditje të aktit juridik më të ulët ndaj atij më të lartë dhe gjithmonë akti juridik më i ulët duhet të jetë në përputhje me aktin juridik më të lartë.

Kushtetuta është akti më i lartë juridik. Pasohet nga ligje, të cilat në fakt dalin nga kushtetuta dhe duhet të jenë në përputhje me të. Aktet nënligjore në hierarkinë e akteve juridike janë më të ulëta se ligji dhe duhet të jenë në përputhje me të, pra të mos jenë në kundërshtim me të, pra në përputhje me kushtetutën. **Pajtueshmëria ndërmjet akteve juridike më të larta dhe atyre më të ulëta quhet kushtetutshmëri.** Pajtueshmëria duhet të jetë nga kushtetuta si akti më i lartë, deri te vendimi, gjegjësisht aktgjykimi si akti më i ulët juridik.

Termi ligjshmëri nënkupton përputhjen e të gjitha akteve juridike dhe akteve materiale (sjelljes njerëzore) më të ulëta se ligji me ligjin në kuptimin formal të fjalës.

Kjo do të thotë se aktet më të ulëta se ligji duhet të jenë në përputhje me ligjin. Legjitimiteti siguron që të gjitha pjesët e rendit juridik të jenë të lidhura në një tërësi të vetme dhe jo kontradiktore. Elementet më të ulëta të rendit juridik të jenë në përputhje me ato më të lartat. Kushtetutshmëria dhe ligjshmëria janë parimi mbi të cilin bazohet sundimi i së drejtës.

Rëndësia e funksionimit të kushtetutshmërisë dhe ligjshmërisë duhet të jetë detyrë e të gjitha segmenteve të shoqërisë. Por duhet theksuar se mbrojtjen juridike të ligjshmërisë duhet ta bëjnë gjykatat, ndërsa mbrojtjen e kushtetutshmërisë gjykatat kushtetuese.

? PYETJE:

1. Çfarë është kushtetutshmëria?
2. Çfarë është ligjshmëria?

1.5. PALIGJSHMËRIA

Siç e kemi theksuar tashmë, aktet juridike janë të vendosura në mënyrë hierarkike dhe të ndërvarrura. Funksionimi i akteve juridike ka rëndësi të veçantë për rendin juridik. Në rast të kundërshtimit, gjegjësisht mospërputhjes së aktit juridik më të lartë dhe atij më të ulët, kemi të bëjmë me paligjshmëri. Nëse akti më i ulët juridik bie ndesh me atë më të lartin, themi se është i paligjshëm.

Termi paligjshmëri nënkupton mosrespektim, d.m.th. kundërshtim i akteve më të ulëta juridike në raport me ato më të lartat. Paligjshmëria përmban antikushtetutshmërinë, kundërligjshmërinë dhe kontradiktën ndërmjet dy akteve juridike të çdo lloji.

- **Antikushtetutshmëria** nënkupton mospërputhje të akteve të përgjithshme dhe individuale me kushtetutën.
- **Kundërligjshmëria** nënkupton mospërputhje të akteve nënligjore të përgjithshme dhe individuale me ligjin.
- **Kontradikta** nënkupton mospërputhje midis dy aktesh të çfarëdoshme, pra kundërshtim të përmbajtjes së aktit në raport me një akt tjetër nga i cili rrjedh, p.sh. vendimi si akt i veçantë nuk është në përputhje me urdhrin si akt nënligjor të përgjithshëm.

Paligjshmëria paraqitet në dy lloje, edhe atë:

Paligjshmëri formale-juridike

Kjo paligjshmëri shfaqet kur:

1. Nuk është respektuar procedura për miratimin e aktit (p.sh. pala nuk është dëgjuar gjatë procedurës).
2. Kur akti nuk është miratuar nga organi kompetent (p.sh. aktin e ka miratuar Gjykata Themelore Gjevgjeli ndërsa është dashur të miratohet nga Gjykata Themelore Manastir).

Paligjshmëri materiale-juridike

ose paligjshmëri materiale e aktit juridik.

Kjo paligjshmëri ekziston kur një akt juridik bie ndesh thelbësisht me atë që përcaktohet nga akti më i lartë juridik (p.sh., lidhja e martesës ndërmjet vëllait dhe motrës, e cila është e ndaluar nga ligji për familjen; ose lidhja e kontratës së shitjes së Liqenit të Ohrit, që është

3. Kur nuk respektohet forma e jashtme e nxjerrjes së aktit, gjegjësisht forma e aktit juridik (p.sh. aktgjykimi duhet të jepet me shkrim, ndërsa shqiptohet vetëm gojarisht). që është një e mirë me interes të përgjithshëm dhe nuk duhet të tregtohet; ose një kontratë për shitblerjen e drogës, ndërsa me ligj ndalohet shitblerja e drogës).

Nëse bëhet fjalë për një veprim individual të kundërligjshëm, personi mund të paraqesë ankesë si mjet i rregullt juridik. Për shembull, nëse një person konsideron se aktgjykimi i dhënë nga Gjykata Themelore nuk është në përputhje me ligjin, ai/ajo do të paraqesë ankesë, për të cilën do të vendosë një organ më i lartë, përkatësisht në këtë rast Gjykata e Apelit. Gjykata Kushtetuese është kompetente për të vlerësuar përputhshmërinë e ligjit me Kushtetutën, si dhe aktet nënligjore me Kushtetutën dhe ligjin.

? PYETJE:

1. Çfarë është paligjshmëria?
2. Sqaroheni paligjshmërinë formale-juridike.
3. Sqaroheni paligjshmërinë materiale-juridike.

1.6. PLOTFUQISHMËRIA, FINALITETI, EKZEKUTUESHMËRIA

Plotfuqishmëria është një veti e tillë e një akti juridik, që konsiston në faktin se akti juridik nuk mund të rrëzohet apo ndryshohet me zbatimin e mjeteve të rregullta juridike (ankesës).

Plotfuqishmëria si veti e aktit juridik lidhet me vlerësimin e ligjshmërisë së aktit. Ligjshmëria ka një rëndësi të madhe për ligjin dhe për këtë arsye çdo paligjshmëri duhet të zbulohet dhe të merren masa për eliminimin e saj. Prandaj jepet mundësia që çdo akt të shqyrtohet për të konstatuar paligjshmërinë e mundshme të tij. Megjithatë, ligjshmëria nuk duhet të jetë në dëm të vetë ushtrimit të së drejtës. Nëse gjatë shqyrtimit të paligjshmërisë do të shkohej deri në ekstrem, pra nëse akti do të shqyrtohej vazhdimisht dhe pafundësisht, ai akt do të rrezikohej deri në atë masë sa për të mos u zbatuar fare. Njerëzit nuk mund të lejohen të jenë në pasiguri të vazhdueshme nëse një akt apo veprim është i ligjshëm apo jo. Shqyrtimi i ligjshmërisë, përkatësisht i paligjshmërisë së akteve juridike lidhet me realizimin e një procedure të përcaktuar saktësisht me ligj dhe me një afat në të cilin mund të kërkohet përcaktimi i ligjshmërisë.

Nëse personi juridik nuk është i kënaqur me një akt juridik dhe dyshon në korrektesinë e vendimeve të marra nga organet shtetërore të shkallës së parë, ka të drejtën e mjetit juridik - ankesës. Ankesa është mjet i rregullt juridik dhe mundëson shqyrtimin e lëndës në shkallë të dytë. Sot në shumicën e sistemeve juridike respektohet parimi i dy niveleve, që do të thotë se ndaj çdo vendimi të marrë nga një organ i shkallës së parë brenda një afati të caktuar dhe tek organi më i lartë i drejtpërdrejtë, lejohet e drejta e ankesës. Ankesa i paraqitet organit që ka marrë vendim në shkallë të parë dhe të gjithë dosjen nga lënda ia përcjell organit të shkallës së dytë që duhet të vendosë për të. Ankesa është vendosur për të garantuar plotësisht sigurinë në realizimin e drejtësisë, e me këtë edhe sigurinë në realizimin e ligjshmërisë.

Plotfuqishmëria ndodh në dy mënyra:

- Me skadimin e periudhës së caktuar (afatit), e cila përcaktohet për shkak të përdorimit të ankesës, ndërsa ajo nuk përdoret. Shembull, afati është 15 ditë, ndërsa nëse personi nuk parashtron ankesë brenda asaj kohe, atëherë akti bëhet i plotfuqishëm.

- **Kur ankesa është përdorur nga ana e subjektit** për të kundërshtuar ligjshmërinë dhe pas ankimimit është marrë vendim nga instancat më të larta. Për shembull, nëse Gjykata Themelore është kompetente për zgjidhjen e një çështjeje në shkallë të parë, kundër aktgjykimit të kësaj gjykate paraqitet ankesë, e cila vendoset nga Gjykata e Apelit si gjykatë e shkallës së dytë. Me vendim të organit të shkallës së dytë akti është i plotfuqishëm.

Akti i plotfuqishëm juridik nuk mund të kundërshtohet më për paligjshmëri para një organi më të lartë me ankesë, por mund të kundërshtohet me mjete të jashtëzakonshme juridike, të cilat mund të përdoren vetëm në raste rreptësisht të kufizuara. Si rregull, akti i plotfuqishëm është akti për të cilin organi i shkallës së dytë është deklaruar përfundimisht. Ky akt, si rregull, duhet të ekzekutohet.

Finaliteti është tipar karakteristik i akteve administrative. Vendimi i marrë në procedurën administrative merr formë të prerë kur përdoret ankesa ose kur skadon afati për ankesë ndërsa e njëjta nuk është deklaruar. Nëse ankesa përdoret, por pa sukses, finaliteti do të thotë se mund të iniciohet një kontest administrativ me ngritjen e padisë. Nëse ankesa nuk është deklaruar, ndërsa ka mundur të deklarohet, finaliteti është arsyeja pse nuk mund të iniciohet një kontest administrativ.

Ekzekutueshmëria nënkupton që akti juridik hyn në fuqi, dhe subjektet janë të detyruara të veprojnë sipas tij.

Rregulli është që akti së pari të bëhet i plotfuqishëm, pastaj të ekzekutohet dhe ankesa të shtyjë ekzekutimin e aktit. Por ka edhe raste kur akti ekzekutohet fillimisht para se të bëhet i plotfuqishëm. Për shembull, akti i paraburgimit. Ky akt fillimisht bëhet i ekzekutueshëm dhe më pas i plotfuqishëm. Kjo ka për qëllim sigurimin e provave ose në rast dyshimi se personi i dyshuar për përgjegjësi mund të arratiset. Për këtë arsye personi ndalohet fillimisht dhe nga ndalimi i lejohet të përdorë mjetet e rregullta ligjore. Në këtë rast ankesa nuk e vonon ekzekutimin e vendimit.

? PYETJE:

1. Çfarë është plotfuqishmëria e aktit juridik?
2. Çfarë është ekzekutueshmëria e aktit juridik?

2. SHTETI LIGJOR DHE SUNDIMI I LIGJIT

2.1. NOCIONI I SHTETIT LIGJOR DHE SUNDIMIT TË LIGJIT

Koncepti i **shtetit ligjor dhe parimit të sundimit të ligjit** janë përparësi të qytetërimit modern. Duke folur për shtetin ligjor, është e pashmangshme të përmendet demokracia, sepse shteti ligjor në një shoqëri jodemokratike nuk mund të ekzistojë. Pra, demokracia dhe shteti ligjor janë në një marrëdhënie të pandashme reciproke dhe të ndërvuarur me njëri-tjetrin.

Në shtetin ligjor, individit është një hallkë e rëndësishme në shoqëri. **Garantimi i të drejtave dhe lirive themelore të njeriut** është një element i pashmangshëm në shtetin ligjor, i cili perceptohet si në aspektin e garancisë kushtetuese ashtu edhe në aspektin e zbatimit praktik në vend. Kjo pasohet nga roli veçanërisht i rëndësishëm i **gjykatave**, të cilat janë promotore të mbrojtjes nga cenimi i të drejtave dhe lirive të qytetarit. Në kryerjen e veprimtarisë së saj, gjyqësia duhet të jetë e pavarur, objektive, e paanshme ndaj palës në procedurën konkrete.

Një element kyç që shënon shtetin ligjor është **sistemi i ndarjes së pushtetit** në legjislativ, ekzekutiv dhe gjyqësor. Ky sistem është i njohur në vendet moderne sepse mundëson parimin e kontrollit dhe balancimit (*check and balance*) nga aspekti i kontrollit të ndërsjellë ndërmjet bartësve të pushtetit, për ta mbrojtur atë nga abuzimi. Por, gjithashtu, ky parim e bën të pamundur përqendrimin e pushtetit në një organ (qendër, institucion) pa mekanizma kontrolli, sepse ai mund të abuzojë me të gjatë ekzistencës së tij. Koncepti i shtetit ligjor lidhet drejtpërdrejt edhe me ligjet, të cilat duhet të jenë publike, të qarta, të sakta, të drejta, të miratuara nga organi përkatës në një procedurë të përshtatshme, në përputhje me kushtetutën dhe nuk duhet të kenë efekt prapaveprues, përveç rasteve të jashtëzakonshme që i kemi shpjeguar dhe përmendur tashmë.

Sot, ekzistenca e një shteti ligjor pa parimin e sundimit të ligjit është e paimagjinueshme. Shteti ligjor lidhet drejtpërdrejt me kontrollin e pushtetarëve, të cilët duhet të mbajnë përgjegjësi dhe çdo shkelje e ligjit nga ana e tyre duhet të sanksionohet në mënyrë të pashmangshme.

Sundimi i ligjit do të thotë barazi e të gjithëve para ligjit, d.m.th. askush nuk është mbi ta, për interesin dhe përfitimin e askujt. Gjykatat punojnë në favor të mbrojtjes ligjore për të gjithë dhe kudo. Kjo që u tha më sipër, është themeli mbi të cilin duhet të bazohet shteti ligjor dhe sundimi i ligjit.

? PYETJE:

1. Shpjegoni konceptin e shtetit ligjor.
2. Shpjegoni konceptin e sundimit të ligjit.

DETYRË:

1. Hartoni listën tuaj të renditjes së kriterëve për funksionimin e shtetit ligjor dhe sundimit të ligjit dhe diskutoni mbi të.
 - ☞ Të drejtat themelore të njeriut
 - ☞ Mungesa e korrupsionit
 - ☞ Përgjegjësia e atyre që janë në pushtet
 - ☞ Kufizimi i pushtetit
 - ☞ Qeveri transparente
 - ☞ Rendi dhe siguria
 - ☞ Drejtësia penale
 - ☞ Drejtësia Civile
 - ☞ Zbatimi i ligjeve

PROJEKT:

1. Në ueb faqen në vijim <https://worldjusticeproject.org/our-work/wjp-rule-law-index> eksploroni vendet sipas indeksit të sundimit të ligjit.

MBANI MEND !!!

- ✚ E drejta pozitive është një e drejtë që vlen dhe zbatohet në një vend të caktuar. Ekziston një vlefshmëri hapësinore (territoriale) dhe vlefshmëri kohore e normave juridike dhe akteve juridike.
- ✚ Forca juridike e aktit juridik është masë e ndikimit të një akti juridik në tjetrin, pra masë që përcakton se cili akt juridik është më i lartë e cili më i ulët.
- ✚ Termi ligjshmëri nënkupton përputhjen e të gjitha akteve juridike dhe akteve materiale (sjelljes njerëzore) më të ulëta se ligji me ligjin në kuptimin formal të fjalës.
- ✚ Termi paligjshmëri nënkupton mosrespektim, d.m.th. kundërshtim i akteve më të ulëta juridike në raport me ato më të lartat.
- ✚ Antikushtetutshmëria nënkupton mospërputhje të akteve të përgjithshme dhe individuale me kushtetutën.
- ✚ Kundërligjshmëria nënkupton mospërputhje të akteve nënligjore të përgjithshme dhe individuale me ligjin.
- ✚ Kontradikta nënkupton mospërputhjen ndërmjet dy akteve të ndryshme, d.m.th. kundërthënie e përmbajtjes së aktit në raport me një akt tjetër nga i cili rrjedh.
- ✚ Plotfuqishmëria është një veti e tillë e aktit juridik, që konsiston në faktin se akti juridik nuk mund të rrëzohet dhe as të ndryshohet me zbatimin e mjeteve të rregullta juridike (ankesës).
- ✚ Ekzekutueshmëria nënkupton që akti juridik hyn në fuqi, dhe subjektet janë të detyruara të veprojnë sipas tij.
- ✚ Demokracia dhe shteti ligjor janë në një marrëdhënie të pandashme reciproke dhe të ndërruar nga njëri-tjetri.
- ✚ Sundimi i ligjit do të thotë që askush nuk është mbi ligjin.

FJALORTH

A

Aftësia afariste është aftësia e një personi fizik (njeriu) që të mundet në mënyrë të pavarur, me veprimet e tij personale, të krijojë marrëdhënie juridike, ose t'i ndryshojë apo t'i përfundojë marrëdhëniet juridike ekzistuese.

Aftësia juridike është mundësia e çdo personi për të qenë subjekt i të drejtave dhe detyrimeve, d.m.th. të fitojë të drejta dhe detyrime.

Akti juridik është mjet për krijimin dhe zbatimin e ligjit.

Apatrid është personi pa shtetësi.

Autorizimi është vullnet i shprehur me shkrim i një subjekti, i cili autorizon një subjekt tjetër në emër të dhe për llogari të tij për të ndërmarrë të drejta dhe detyrime në raportet juridike.

Autorizimi juridik është një mundësi për sjellje të caktuar të subjektit të së drejtës në raport me një subjekt tjetër, në bazë të rregullimeve juridike, në bazë të të cilave subjekti i autorizimit juridik mund të kërkojë diçka nga dikush.

B

Bipatrid është personi me dy shtetësi.

Burimi i së drejtës është vendi nga ku tërhiqet e drejta.

D

Delikti është një sjellje e caktuar e kundërligjshme e një personi që cenon dispozitën e normës juridike.

Demokracia e drejtpërdrejtë është sistem politik në të cilin nuk ka organe të veçanta të zgjedhura dhe përfaqësues të popullit në ushtrimin e pushtetit, por populli vendos vetë.

Demokracia është sundimi i popullit.

Demokracia jo e drejtpërdrejtë (përfaqësuese) është të ushtruarit e pushtetit nëpërmjet një përfaqësuesi të zgjedhur nga populli.

Detyrimi ligjor është detyrimi me të cilin një person juridik detyrohet me dispozita juridike të japë diçka, të pësojë ose të bëjë diçka në interes të një personi tjetër juridik.

Dispozita është ajo pjesë e normës juridike në të cilën jepet vetë rregulla e sjelljes.

E

E drejta është një grup rregullash juridike të miratuara nga shteti dhe shërbejnë për të rregulluar sjelljen, marrëdhëniet dhe lidhjet e ndërsjella të njerëzve në një shoqëri. Respektimi i tyre sigurohet nga shteti me sanksion të detyruar.

E drejta pozitive është një e drejtë që vlen dhe zbatohet në një vend të caktuar.

Ekstraterritorialiteti është përjashtimi i një pjese të territorit të një shteti nga juridiksioni (kompetenca) e autoritetit publik të atij shteti dhe për atë pjesë zbatohet ligji i një shteti tjetër.

Ekzekutueshmëria është kur akti juridik hyn në fuqi, dhe subjektet detyrohen të veprojnë sipas tij.

Emancipimi është fitimi i aftësisë juridike para moshës 18 vjeçare.

F

Faktet juridike janë situata në jetën e njerëzve nën ndikimin e drejtpërdrejtë të të cilave krijohen marrëdhënie të reja juridike, ose ndryshohen apo shfuqizohen marrëdhëniet juridike ekzistuese.

Federata nënkupton një shtet federal që lind mbi baza vullnetare midis njësive federale, të cilat mund të shfaqen si republika, krahina, rajone, etj.

Fiksioni juridik është një situatë juridike kur diçka e pavërtetë, e pasaktë ose joekzistente konsiderohet e vërtetë, e saktë ose ekzistente dhe anasjelltas.

Forca ligjore e një akti juridik është masë e ndikimit të një akti juridik në një tjetër.

H

Hipoteza është pjesë e normës juridike e cila parashikon kushtet dhe rrethanat që duhet të plotësohen për të zbatuar dispozitën ose sanksionin e normës juridike.

K

Konfederata nënkupton bashkim shtetesh.

Kreu i shtetit është individ ose organ që përfaqëson shtetin brenda dhe jashtë vendit.

Kuorumi është numri minimal i anëtarëve të një organi kolektiv që duhet të jenë të pranishëm dhe të marrin pjesë në punën e tij në mënyrë që ai organ të marrë vendime.

Kushtetuta është akti juridik më i rëndësishëm dhe më i lartë që ka forcën më të madhe juridike.

L

Ligji është një akt i përgjithshëm juridik që bie nën kushtetutën në shkallën hierarkike të akteve juridike. Ligji shtjellon dispozitat kushtetuese dhe është forma më e zakonshme në të cilën shfaqen rregullat.

Ligjshmëria është përputhja e të gjitha akteve juridike dhe materiale më të ulëta se ligji me ligjin në kuptimin formal të fjalës.

M

Marrëdhënia juridike është një marrëdhënie shoqërore e rregulluar me një normë juridike.

Metoda është mënyra se si studiohet lënda, më saktë mënyrë ose grup procedurash dhe mjetesh me të cilat merren njohuri për qëllimin e caktuar.

Monarkia është një formë qeverisjeje në të cilën kreu i shtetit vjen në pushtet me trashëgimi.

Morali është një rregull i pashkruar sjelljeje, një gjykim i brendshëm i së mirës dhe së keqes.

N

Norma juridike është një rregull i shkruar i sjelljes i miratuar dhe sanksionuar nga shteti.

Norma shoqërore është një rregull që rregullon sjelljen e njerëzve në marrëdhëniet e tyre të ndërsjella.

O

Objekt i së drejtës është një objekt (send), veprimtari njerëzor (punë, veprimtari) ose pasivitet, cilësi dhe veti në lidhje me të cilën vendoset marrëdhënia juridike.

Organi shtetëror është pjesë e organizatës shtetërore, themelimi dhe kompetenca e të cilit janë të përcaktuara me ligj dhe që mund të marrë vendime juridikisht relevante nën kompetencën e tij.

Organizata shtetërore është një grup organesh të shumta dhe të larmishme që janë të specializuara për kryerjen e detyrave nga më të ndryshmet.

P

Paligjshmëria është mospërputhje, respektivisht kundërshtim i akteve më të ulëta juridike në raport me ato më të lartat.

Person fizik është njeriu që bëhet subjekt që nga lindja dhe i tillë mbetet deri në vdekje.

Personi juridik është një shoqatë e personave fizikë në bazë të rregulloreve juridike për qëllime të ushtrimit të interesave të përbashkëta të lejuara me ligj.

Përfaqësimi është marrja e të drejtave dhe detyrimeve në emër të dhe për llogari të një personi tjetër.

Plotfuqishmëria është një veti e aktit juridik, që konsiston në faktin se akti juridik nuk mund të rrëzohet dhe as të ndryshohet me zbatimin e mjeteve të rregullta juridike (ankesës).

Polipatrid është personi me më shumë shtetësi.

Popullata e një shteti përfshin njerëzit që jetojnë në një territor të caktuar shtetëror dhe janë nën sundimin e atij shteti.

Pushteti është një marrëdhënie ndërmjet dy subjekteve, nga të cilat njëri urdhëron dhe tjetri është i detyruar të dëgjojë.

Pushteti publik është një marrëdhënie shoqërore midis dy subjekteve (të cilat janë në gjendje të pabarabartë), nga të cilat njëra palë ka të drejtë të urdhërojë, dhe tjetra është gjithmonë në një gjendje të varur dhe është e detyruar të dëgjojë dhe zbatojë urdhrat.

R

Referendumi është deklarimi i popullit me votë të përgjithshme nëse është "PËR" ose "KUNDËR", për një masë që është marrë ose duhet të merret nga shteti.

Rendi juridik është një rend i organizuar i marrëdhënieve shoqërore i rregulluar me norma juridike.

Republika është një formë qeverisjeje në të cilën kreu i shtetit vjen në pushtet përmes zgjedhjeve.

Rregullimi shtetëror është një mënyrë e rregullimit të marrëdhënieve ndërmjet organeve të qeverisjes qendrore dhe jo-qendrore (lokale) në shtet.

S

Sanksioni është pjesë e normës juridike i cili përcakton pasojat (sanksionet) që do të ndodhnin për subjektin për shkak të shkeljes së normës juridike.

Sistemi politik është një mënyrë sipas së cilës organizohet pushteti më i lartë në vend, gjegjësisht përcakton raportin ndërmjet aparatit shtetëror dhe popullit.

Subjekt i së drejtës është personi (person fizik) dhe personi juridik, të cilët ligjërisht janë të autorizuar të jenë bartës të autorizimeve juridike dhe detyrimeve ligjore.

Shkencat juridike janë një sistem njohurish për shtetin dhe ligjin si dy kategori të rëndësishme dhe të ndërlidhura shoqërore.

Shtetas është një individ i cili si person (subjekt) hyn në një grup të caktuar të drejtash dhe detyrimesh me një shtet të caktuar.

Shtetësia është një marrëdhënie juridike ndërmjet shtetit dhe individit anëtar të një bashkësie të caktuar shtetërore, nga e cila lindin të drejta dhe detyrime si për shtetin ashtu edhe për individin.

Shteti është një kategori klasore dhe shoqërore, i cili ka një mjet shtrëngimi fizik.

Shteti unitar është ai në të cilin i gjithë pushteti është në duart e organeve shtetërore qendrore, të cilat kanë statusin e organeve sovrane në të gjithë territorin.

T

Të huajt janë personat që banojnë në territorin e një shteti të caktuar por nuk kanë shtetësinë e tij.

V

Vepra juridike është një deklaratë vullneti që synon shfaqjen, ndryshimin ose përfundimin e një marrëdhënieje juridike.

Z

Zakoni është një rregull i pashkruar që ndodh me përsëritjen e përditshme të së njëjtës sjellje.

LITERATURA E SHFRYTËZUAR

1. Асен Групче, Граѓанско право (општ дел), Скопје, 1986.
2. Бајалџиев Д., Вовед во право – Право, Скопје, 2007.
3. Бајалџиев Д., Вовед во право – Држава, Скопје, 1999.
4. Бајалџиев Д., Мицајков М., Ичокаев Б., Увод во правото, Скопје, 1988.
5. Бајалџиев Д., Мицајков М., Тасковска Д., Вовед во правото, Скопје, 2004.
6. Габер С., Теорија на државата и правото, Скопје, 1986.
7. Габер С., Увод во државата и правото, Скопје, 1980.
8. Грегов Р., Пеган В., Увод у државу и право, Загреб, 2016.
9. Гризо Н., Гелевски С., Давитковски Б., Павловска Данева А., Административно право, Скопје, 2008.
10. Грнчаревски В., Куцуловска Р., Миланова В., Основи на правото, Скопје, 2010.
11. Живковска Р., Општ дел на граѓанското право, Скопје, 2006.
12. Живковска Р., Практикум, Општ дел на граѓанското право, Скопје, 2005.
13. Живковска Р., Стварно право, книга прва, Скопје, 2005.
14. Институт отворено општество, Учиме право, Скопје, 2015.
15. Институт отворено општество, Учиме право, Скопје, 2006.
16. Институт отворено општество, Учиме право, Скопје, 2002.
17. Климовски С., Каракамишева Т., Дескоска Р., Конституционо уредување на Република Македонија, Скопје, 2006.
18. Климовски С., Дескоска Р., Каракамишева Т., Уставно право, Скопје, 2009.
19. Климовски С., Митков В., Дескоска Р., Каракамишева Т., Уставно право и политички систем, Скопје, 2003.
20. Лилиќ С., Драшкиќ М., Основи права, Београд, 2006.
21. Лукиќ Д. Р., Кошутиќ Б., Увод у право, Београд, 1988.
22. Македониум – антологија на македонската национално-политичка мисла (сто години од Илинденското востание), Скопје, 2003.

23. Македонска академија на науките и уметностите, Прилози за обичајното право на македонскиот народ, Том 1, Скопје, 2000.
24. Макијавели Н., Владетел, Силсонс, Скопје, 2004.
25. Митровиќ Д., Основи права, Београд, 2017.
26. Мишелин Р. Ишеј, Човекови права, зборник на основни политички есеи, говори и документи, МИ-АН, Скопје, 2002.
27. Мишулин. А. В, Историја на Стариот Свет, Силсонс, Скопје, 2002.
28. Младинска книга, Историја, Скопје, 2009.
29. Младинска книга, Фактопедија, Скопје, 2008.
30. Младинска книга, Човек, Скопје, 2008.
31. Младински опр.азовен форум, Мала судска тура, Скопје, 2005.
32. Mjeldheim L., Lillejord S., Solvberg E., Спектар, Феникс, Скопје, 2006.
33. Петровски Д., Демократија и граѓанско опр.азование, Битола, 2003.
34. Пижевски С., Николовски А., Извадоци од основи на правото книга I и II, Скопје 1981.
35. Савремена администрација, Енциклопедија политичке културе, Београд, 1993.
36. Спасов А., Државниот суверенитет и глобализацијата, Скопје, 2011.
37. Ташковски Д., Македонија низ вековите, Скопје, 1985.
38. Топер, Голем лексикон на странски зборови и изрази, Скопје, 2001.
39. Фрчкоски Љ., Тупурковски В., Ортаковски В., Меѓународно јавно право, Скопје, 1995.

LIGJET E SHFRYTËZUARA

1. Ligji për shtetësinë, „Gazeta Zyrtare e R. Maqedonisë“, nr.67/1992.
2. Ligji për Sigurinë dhe Shëndetin në Punë, „Gazeta Zyrtare e R. Maqedonisë “, nr.92/2007.
3. Ligji për pastërtinë publike, „Gazeta Zyrtare e R. Maqedonisë“, nr.130/2010.

4. Ligji për emrin personal, „Gazeta Zyrtare e R. Maqedonisë“, nr.8/1995.

5. Ligji për marrëdhëniet e detyrueshme, „Gazeta Zyrtare e R. Maqedonisë“, nr. 18/2001.

6. Ligji për organizimin dhe punën e organeve të administratës shtetërore, „Gazeta Zyrtare e R. Maqedonisë“, nr. 58/2000.

7. Ligji për të drejtat e fëmijëve, „Gazeta Zyrtare e R. Maqedonisë“, nr. 148/2013.

8. Ligji për veprat kundër rendit dhe qetësisë publike, „Gazeta Zyrtare e R. Maqedonisë“, nr. 66/2007. dhe nr.152/2015.

9. Ligji për mbrojtjen e konsumatorëve, „Gazeta Zyrtare e R. Maqedonisë“, nr. 38/2004.

10. Ligji për familjen, „Gazeta Zyrtare e R. Maqedonisë“, nr. 153/2014.

11. Ligji për kuvendin, „Gazeta Zyrtare e R. Maqedonisë“, nr. 04/2009.

12. Ligji për pronën dhe të drejtat e tjera sendore, „Gazeta Zyrtare e R. Maqedonisë“, nr. 18/2001.

13. Ligji për arsim të mesëm, „Gazeta Zyrtare e R. Maqedonisë“, nr. 44/1995.

14. Ligji për të huajt, „Gazeta Zyrtare e R. Maqedonisë“, nr. 35/2006.

15. Ligji për gjykatat, „Gazeta Zyrtare e R. Maqedonisë“, nr. 7/2006.

16. Kodi penal, „Gazeta Zyrtare e R. Maqedonisë“, nr. 37/1996.

17. Kushtetuta e Republikës së Maqedonisë së Veriut.

